RAPORT PËRFUNDIMTAR
Mbi
Auditimin Financiar

Tiranë, tetor 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	3-3
1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
II.	**HYRJA**	7
1	Objektivat dhe qëllimi	7
2	Identifikimi i çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	10
5	Kriteret e Vlerësimit	10-11
6	Standartet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	10
8	Dokumentimi i auditimit	11
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	12
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13-106
1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	13-24
2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	24-34
2.1	Auditim mbi të ardhurat vendore	34-54
3	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	54-104
IV.	**REKOMANDIME**	104-121

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin*:*

Bashkia Selenicë, si njësi e vetëqeverisjes vendore organizohet dhe funksioni sipas kuadrit legjislativ dhe operues, ku bazën e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligji nr.68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Selenicë për periudhën e aktivitetit 01.01.2025-31.12.2025 , krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, (pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi), qëndron në forcimin e transparencës së veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, si dhe në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Bashkia Selenicë është një njësi e vetëqeverisjes vendore, e vendosur në jugperëndim të Republikës së Shqipërisë, pjesë e Qarkut Vlorë. Ajo u krijua në kuadër të reformës administrative-territoriale të vitit 2015 dhe përfshin territorin e ish-bashkisë Selenicë dhe disa ish-komuna përreth. Bashkia e Selenicës kufizohet në veri me bashkinë Fier, në lindje me bashkinë Mallakastër, Tepelenë dhe Memaliaj, në jug me bashkinë Himarë dhe perëndim me bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës. Popullsia e saj është referuar dokumenteve të Bashkisë Selenicë, ku popullsia sipas Censusit 2023 paraqitet 9,580 banorë, ndërsa sipas regjistrit të Gjendjes Civile 33,771 banorë[1].

Bashkia e Selenicës shtrihet rrëzë kodrave në bregun e majtë të Vjosës, pikërisht në afërsi të fushës ku lumi i Vlorës (apo i Shushicës, si quhet në rrjedhën e sipërme të tij) derdhet në Vjosë, si një degë e rëndësishme e tij. Dëshmitë e para për emrin Selenicë datojnë në vitin 1700 dhe deri më sot vazhdon të njihet me këtë emër. Emri i këtij qyteti është i lidhur kryesisht me pasuritë e nëntokës së saj, nxjerrjen dhe shfrytëzimin e bitumit natyror, gjë që ka ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e qytezës. Në fillim të shekullit të kaluar ka dëshmi të shumta të shfrytëzimit çnjerëzor që u janë bërë burimeve natyrore të bitumit nga shoqëritë e huaja. Në fillim nga Perandoria Osmane, më pas nga shoqëritë angleze, franceze e më pas ato italiane para dhe gjatë Luftës II Botërore. Miniera e parë e organizuar si e tillë daton rreth vitit 1830 dhe është ngritur nga një shoqëri angleze. Gjatë kohës së mbretërimit të Zogut shfrytëzimi i bitumeve të Selenicës bëhej nga shoqëritë italiane, revolta e punëtorëve ndaj të cilave është e njohur nga ngjarjet e viteve 1937, 1940, 1941 dhe 1942. Zhvillimin më të madh Selenica e mori pas Luftës II Botërore, ku si rrjedhojë e shfrytëzimit të bitumeve të saj u hapën shumë vende pune dhe numri i banorëve u rrit ndjeshëm.

Bashkia Selenicë ushtron funksionet e saj në fushat e shërbimeve publike vendore, menaxhimit financiar, planifikimit dhe zhvillimit të territorit, arsimit parashkollor, mbrojtjes sociale dhe administrimit të pasurive publike, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*.

Buxheti i Bashkisë Selenicë për vitin 2025 është planifikuar në shumën 792,155,447 lekë. Nga këto shpenzime faktike për vitin 2025 janë realizuar 509,300,878 lekë ose në masën 64%. Të ardhurat e veta janë realizuar në shumën 177,070,000 lekë ndërsa realizimi 121,856,333 lek, ose në nivelin 68.8%, ku ka rezultuar diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën - 55,213,667 lekë.

[1]-https://www.selenica.gov.al/wp-content/uploads/2025/09/Draft-PVMIM-Bashkia-Selenice.pdf?utm_source=chatgpt.com

b. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij*:*
Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi veprimtarinë financiare të Bashkisë Selenicë me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Selenicë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:
- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.*
- *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.*
-Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave.
-Auditim mbi kontabilitetin dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025.

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.
Auditimi është kryer me zgjedhje dhe mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe postet e llogarive të bilancit vjetor..

d. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:
Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 26 gjetje (Nga këto 24 të karakterit organizativ dhe 2 për efektivitetin) dhe ka dhënë 30 rekomandime.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.
Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me proceduat e mbajtjes së sistemit të kontabilitetit, mbledhjen e të ardhurave dhe sistemin e kontrollit të brendshëm. *Kështu,*

- Nga auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Selenicë, për vitin 2025, ky sistem vlerësohet pjesërisht efektiv dhe se komponentët e menaxhimit financiar nuk kanë funksionuar në mënyrë të plotë.
- Nga auditimi mbi vlerësimin e procesit të rakordimit dhe përputhjes së të dhënave të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënës Vjetore (PFV) të Bashkisë Selenicë të dorëzuara në Degën e Thesarit, me të dhënat e Pasqyrave Financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave (SIFQ), kanë rezultuar disa mospërputhje, në shumën 138,987,992 lekë.
- Nga auditimi i të ardhurave tatimore deri më datë 31.12.2025, konstatohet se nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë marrë masat për mbledhjen e borxhit tatimor të prapambetur, që në mënyrë progresive në fund të viti 2023 është regjistruar në shumën 438,105 mijë lekë, në fund të vitit 2024 për 446,068 mijë lekë dhe për vitin 2025 janë 443,382 mijë lekë. Nuk janë llogaritur kamatëvonesat për detyrimet tatimore të papaguara në afat për çdo ditë vonesë, si dhe nuk rezulton të jetë regjistruar si një zë me vete pagesa për detyrimet e viteve të mëparshme. Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë mbajtur akt-rakordime periodike për identifikimin e nivelit të të ardhurave të arkëtuara për llogari të kësaj Bashkie me Drejtorinë Vendore të ASHK-së, Drejtorinë Rajonale të Doganave dhe AKBN-në.
- Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit rezulton një nivel i lartë detyrimeve debitorë *(llogaria 468)* në Bashkinë Selenicë në fund të vitit 2025, prej 236,324,467 lekë, me të njëjtën vlerë si viti 2024. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronës Publike, Lejeve e Licencave, vlera totale e detyrimeve debitorë në fund të vitit 22025 është në shumën prej 443,382,935 lekë. Për rrjedhojë, rezultoi se nuk janë njohur dhe kontabilizuar detyrime

debitorë në shumën 207,058,468 lekë, duke sjellë nënvlerësimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe të të ardhurave përkatëse të evidentuara në llogaritë e klasës 7-të.

- *Llogaria 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)",* më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë. Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 janë në shumën prej 306,329,835 lekë, ku përfshihet vlerat e llogarisë 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" dhe llog. 468 "Debitorë të ndryshëm", dhe nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë 4341, veprime në kundërshtim me trajtimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018.
- Nga auditimi i llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" gjatë vitit 2025 rezultoi se janë kontabilizuar në llogari tre zëra shpenzimesh për investime nga ana e Bashkisë Selenicë në shumën 132,718,570 lekë, për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilat nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie.
- Nga auditimi i llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezulton së nuk janë transferuar për llogari të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Vlorë nga ana e Bashkisë Selenicë, 17 zëra të lidhura me ujësjellës-kanalizimet, (që i përkasin lëvizjeve të v.2025) që janë regjistruar në kontabilitet me dt. 31.12.2025 në llogarinë 213, me koston historike prej 181,680,672 lekë.
- Deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është bërë çlirimi i garancive për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Selenicë në vlerën 28,978,678 lekë për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës**.** nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Vlorë.
- Bashkia Selenicë ka ulur stokun e detyrimeve të prapambetura nga 21,805,931 lekë në fillim të vitit 2025 në 18,649,124 lekë në fund të vitit, megjithatë vijojnë të mbeten të papaguara detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 4,933,760 lekë, për investime në vlerën 8,882,897 lekë dhe për mallra e shërbime në vlerën 4,309,794 lekë. etj.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore*:*

-Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm, në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e miratimin e pasqyrave financiare si dhe realizmin e të ardhurave vendore.

-Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të marrin masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

- Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave Bashkia Selenicë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2025, në vlerën totale 443,382 mijë lekë.

- Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në bashki të marrin masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar e zbatuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive sipas komponentëve të MFK për plotësimin e mangësive të konstatuara.
- Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të marrë masa për pasqyrimin e plotë, të saktë dhe të dokumentuar të detyrimeve debitore në kontabilitet, përmes evidentimin analitik të çdo debitori të mbartur, sistemimin e diferencave të konstatuara prej **207,128,468 lekë** si dhe zbatimin korrekt të skemës kontabël për llogaritë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" dhe 470 "*Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë",* në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
-Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të marrë masa që të kryejë analizimin, sistemimin dhe rakordimin e tepricave të llogarive 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", me qëllim eliminimin e mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi, etj.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi auditimin financiar[2]: *i kualifikuar*
Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Selenicë, për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të fluksit të mjeteve monetare *(cash flow),* të ndryshimit të aktiveve neto/flukseve neto dhe shënimet shpjeguese.
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:
Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe d*ëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit,* nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Selenicë kemi arritur në përfundimin *pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin"*, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë *materiale, por jo të përhap*ura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të ***kualifikuar***[3], e shprehur kjo sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Baza për opinionin:
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI- P1, "Deklarata e Limës", INTOSAI -P10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130 – "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

2 - Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 "Për organizmin dhe funksionimin e KLSH-së".
3 - Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së miratuar me Vendimin nr. 246, datë 19.12.2022 të Kryetarit te KLSH-së, Kapitulli VII, pika 4.2, (fq. 54, 60-61): "*Opinioni i modifikuar" do të jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë".*

Gjithashtu, besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së që për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 për Bashkinë Selenicë është përcaktuar në shumën 12,036 mijë lekë për shpenzimet dhe 393 mijë lekë për të ardhurat, si dhe mangësitë/ anomalitë e mëposhtme:
-Në *llog. 210, llog. 211, llog. 212 dhe llog. 213* nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Selenicë pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie.
-Nga auditimi i llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*", rezultoi se janë kontabilizuar tre zëra shpenzimesh për investime në shumën 132,718,566 lekë, për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilat nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, por nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie.
- Nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale UK Vlorë Sha", në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022, në vlerën prej 181,680,672 lekë.
- Në llogarinë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalet e veta",* u konstatua se në pasqyrat financiare vjetore, vlera e kësaj llogarie, në fund të vitit 2025 është 0 lekë, e nënvlerësuar në shumën 305,000 lekë.
- Në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjetet në ruajtje",* rezultoi se nuk është bërë çlirimi i garancive për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim në vlerën 28,978,678 lekë.
- Mos pozicionim me korrektesë të llogarive kontabile sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në vitin 2025.
- Evidentohet një nivel i lartë i llog. 468 "*Debitorë të ndryshëm*", debitorë të pa arkëtuar, ku gjendja e mbartur e debitorëve në Bashkinë Selenicë në fund të vitit 2025, prej 236,324,467 lekë, me të njëjtën vlerë si vitin e mëparshëm. Në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" nuk është kontabilizuar detyrimi prej 207,058,468 lekë, duke sjellë nënvlerësimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe të të ardhurave përkatëse për këtë shumë.
- Vlera neto totale e aktiveve në dokumentin "Regjistri i Aktiveve" nuk përputhet me vlerën neto të aktiveve në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore (Formati 7/b) me datën 31.12.2025.
-Nga auditimi mbi rakordimin e të dhënave të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënës Vjetore të hartuara nga ana e njësisë shpenzuese Bashkia Selenicë e të dorëzuara në Degën e Thesarit, me të dhënat e Pasqyrave Financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), kanë rezultuar disa mospërputhje, në shumën 138,987,992 lekë.
-Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, ka evidentuar mangësi në zbatimin e procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim nr. 548/1prot., datë 22.05.2026 *"Mbi auditimin Financiar,* të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 22.05.2026 – 18.06.2026, në subjektin Bashkia Selenicë u krye "*Auditim Financiar*" për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 - 31.12.2025, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Q.C, *përgjegjës grupi*
2. E.S, *auditues*
3. J.P, *auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Selenicë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

2. Qëllimi i auditimit.

Është hartimi i Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale **(ISSAI 1315)**[4]**.**

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve dhe menaxhimit të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

3. Identifikimi i çështjes:

Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Selenicë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiare në fuqi.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Selenicë janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Kryetari i Bashkisë Selenicë *(Administratori i Përgjithshëm)*, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit në cilësisë *e Nëpunësit Zbatues* (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Selenicë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",

[4]-Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3. *Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kuadrin rregullues mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiar* të llogaridhënies vjetore; ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të të ardhurave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Kuadrin e Praktikave Profesionale dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) sipas INTOSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

d) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

e) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

f) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Selenicë, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

6. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

- Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar*;*
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 *"Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"*

- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*;
-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike"*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar,
-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*,
-UMF nr. 2, datë 27.09.2019 "*Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*".
-Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", i ndryshuar;
-Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*";
-Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar;
-Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
-Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut, etj.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.
- INTOSAI P1- Deklarata e Limës me udhëzuesit për kryerjen e auditimit.
- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*" .
- ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- ISSAI 200 "*Parimet e auditimit financiar*" dhe
- ISSAI 2000-2200 "Aplikimi i standardeve te auditimit financiar"
- ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Rregullore e brendshme *"Mbi procedurat e auditimit në KLSH"*;
- Rregullore e brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së"*;

8. Metodat e auditimit*:*
Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me evidence dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat

materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Sa më sipër, audituesit kanë aplikuar auditim *i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, mbi bazën e riskut të vlerësuar.* Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, janë marrë në konsideratë dy elementë:
- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe - Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.
Nga ana e grupit të auditimit janë kryer vlerësimet mbi procedurat, mbi këto aspekte si më poshtë: *Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Kontrolli i vlerësimit. Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi.* Intervista *Raporte dhe Informacione, të trajtuara në aktin e konstatimit mbi auditimin e PFV.*
U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të 17 influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja . Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshimet. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: **ISSAI 1230** *"Dokumentimi i Auditimit"*, duka administruar dokumentacion të mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

- Sipas shkresës së KLSH-së me nr.**548/2 prot., datë 16.07.2026**, në subjektin e auditimit Bashkia Selenicë është dërguar Projekt Raporti i auditimit.
- Bashkia Selenicë nuk ka përcjellë pranë KLSH-së komente, shpjegime apo observacione *(në formë shkresore dhe elektronike)* mbi Projekt-Raportin e Auditimit brenda afatit 1-mujor nga data e marrjes në dorëzim nga personat përgjegjës, referuar parashikimeve të neneve 26 dhe 29, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".* Për rrjedhojë, në mungesë të reagimit zyrtar brenda afatit ligjor të përcaktuar, Projekt-Raporti i hartuar është konsideruar i mirëqenë dhe mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në subjektin "Bashkia Selenicë", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Selenicë është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*".

1. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik 2025.

✓ ***Mbi funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.***

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- *Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;*
- *Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;*
- *Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.*

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Selenicë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, të analizuara nga grupi i auditimit mbështetur në dokumentacionin e vlerësuar, në vijim evidentohet puna e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit u konstatua se:

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

Në lidhje me zbatimin e parimit nr. 1 "*Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".*

- Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, Bashkia Selenicë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Selenicë miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 5, datë 15.05.2020 *"Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Selenicë".*
- Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se Kryetari i Bashkisë Selenicë ka miratuar Kodin e sjelljes dhe të parandalimit të konfliktit të interesave të këshilltarit bashkiak Selenicë, në vitin 2020.
- Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve të Bashkisë Selenicë rezultoi se për vitin 2025 nuk është kryer vlerësimi 6 mujor i punonjësve për periudhën janar-qershor dhe korrik –dhjetor 2025, vlerësim i cili duhet të nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar, por ky vlerësim nuk është bërë brenda afateve ligjore të përcaktuara. Janë kryer vlerësimet për periudhën Tetor 2025 - Mars 2026. *Sa më sipër*, në kundërshtim me Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, *"Për nëpunësin civil"* i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, *"Për vlerësimin e rezultateve në punë"* si dhe Ligjin nr. 7961, datë, 12.07.1995, *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"* i ndryshuar.

Grupi të auditimit ju vendosën në dispozicion dhe u testuan 7 praktika vlerësimi pune të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Shëndetësore, Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Rinisë.

Në lidhje me parimin 2 "*Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".*

- Për vitin 2025 nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk rezultojnë të jenë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me paragrafin 3.1 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Në lidhje me parimin 3 "Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë"

- Për vitin 2025, Bashkia Selenicë ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhër nr. 6, datë 17.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë *"Për strukturën për vitin 2025 dhe nivelin e pagave të punonjësve*" si dhe me Rregulloren e brendshme të vitit 2020 "*Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Selenicë".*
- Për vitin ushtrimor 2025 ishin rekrutuar 13 punonjës (5 nëpunës civil dhe 8 me kod pune) dhe 8 punonjës janë larguar (3 për shkak pensioni, 3 përfundim kontrate dhe 2 me dorëheqje).
- Nga auditimi i 10 dosjeve të punonjësve konstatohet se dosjet nuk përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me Lidhjen 1 *"Të dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit*" të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtj*en, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", ku në asnjë rast nuk rezulton të jenë: a) Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar sipas lidhjes nr. 2; b) Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes, sipas lidhjes nr. 2; c) libreza e punës.

Në lidhje me parimin 4 "Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave".

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Selenicë nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit, për vitin 2025 në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, viti 2024, paragrafi 3.1.

Në lidhje me parimin 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

- Nga auditimi i kryer rezultoi se bashkia ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme. Njësia publike nuk ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë dhe nuk ka autorizime për delegimin e detyrave.
- Për periudhën objekt auditimi, Titullari i Bashkisë Selenicë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik për veprimtarinë e Bashkisë Selenicë, sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pasi referuar Urdhrit Nr. 168/2023, me Nr. 2861 Prot., datë 28.12.2023 është ngritur GMS vetëm për aspektet e lidhura me hartimin e buxhetit afatmesëm 2025-2027, i ndryshuar me Urdhër nr. 138, datë 31.12.2024 *"Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik për buxhetin afatmesëm 2026-2028".*

-Krijimi i ekipit të menaxhimit të programeve (EMP).

Për vitin 2025, Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk rezulton të ketë ngritur Ekipin për Menaxhimin e Programeve, në kundërshtim me pikën 29 të Udhëzimit MF Nr. 23, datë 30.7.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm Të Njësive Të Vetëqeverisjes Vendore"* ku citohet se: "Grupi për Menaxhimin Strategjik ngrihet me vendim të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kryetari i GMS-së, me propozim të anëtarëve të GMS-së, miraton anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Programeve" si dhe me pikën 2.5 dhe 2.6 të Udhëzimit të MF Nr. 7, datë 28.02.2018 *"Për Procedurat Standarde Të Përgatitjes Së Programit Buxhetor Afatmesëm".*

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut"

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut për vitin 2025.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut.

Veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 11, pika 2; nenin 8, pika 8, germa a; nenin 21 të Ligjit nr. 10296 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", si dhe Udhëzimin e MF nr. 16, datë 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike",* Kreu IV, neni 11. *Në lidhje me parimin 7: "Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave*".

- Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit të Riskut për vitin 2025, në kundërshtim me pikën 2.4.4 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

-Në Bashkinë Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Protokoll Arkivit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin *Microsoft Excel* dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes së të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

-Nga auditimi rezultoi se Bashkia Selenicë nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, si dokument i unifikuar për të gjitha proceset e auditimit, siç përcaktohet në pikat nr. 2 dhe 3, të nenit 16, "Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit" të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 8: "Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime".

- Kryetari i Bashkisë Selenicë ka hartuar Rregullore me Nr. 185, datë 28.0.2023 "*Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen, konfidencialitetin në Bashkinë Selenicë"*, në përputhje me ligjin nr. 60/2016 *"Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit"*.

Në lidhje me parimin 9: "Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm".

- Bashkia Selenicë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni. Bashkia Selenicë ka miratuar sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 6, datë 17.01.2025, strukturën për vitin 2025 dhe nivelin e pagave të punonjësve.
- Nga auditimi konstatohet se Bashkia Selenicë nuk ka rishikuar dhe përditësuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore, e për rrjedhojë nuk është miratuar një rregullore e re për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës, ku të jenë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etj. procedurat e rekrutimit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës dhe vlerësimin vjetor i punës për çdo punonjës, veprim ky në kundërshtim me Manualin e MFK-së, pika 3.3.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit *Excel ose Word.*
- Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua se nga titullari i Bashkia Selenicë nuk është miratuar plani vjetor i punës me kundërshtim me aneksin nr. 1 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar Plani i Përgjithshëm Strategjik i Zhvillimit (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Selenicë sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".*

III. Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli".
- Bashkia Selenicë disponon regjistër prokurimesh për vitin 2025. Ky regjistër është elektronik dhe përditësohet sipas ndryshimeve që ndodhin gjatë vitit.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, por Bashkia Selenicë nuk disponon një regjistër të konsoliduar për aktivet e njësisë.
- Bashkia Selenicë ka ngritur komisionet e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimit, por në këto procedura të zbatuara rezultuan mangësi.
- Bashkia Selenicë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

*Në lidhje me parimin 11: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë***".**
- Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë *(back-up).* Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Selenicë, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.

Në lidhje me parimin 12: "Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave".
- Bazuar në nenin 44, 44/1, 44/2 të rregullores së brendshme, çdo menaxher kryen detyrat, që janë të ndara për çdo fazë. Procedurat e brendshme janë të bazuara në kriteret rregullatorë në fuqi për funksionimin e MFK-së dhe AB. Për çdo rast që del e nevojshme, hartohet një plan veprimi operativ për menaxhimin e risqeve të dala gjatë vitit ushtrimor. Auditi i brendshëm vepron i

pavarur nga menaxhimi duke kryer aktivitetin në mënyrë të planifikuar. Të gjitha auditimet janë të planifikuara në bazë risku.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: "Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor".

- Bashkia Selenicë ka faqen e saj zyrtare në web me adresë https: www.BashkiaSelenicë. gov.al/. Bashkia ngarkon PF në sistemin informatik SIFQ. Bashkia ka të azhurnuar faqen e web-it, ku ka hedhur konsultimet me publikun, bazën ligjore, etj.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

- Drejtuesit e institucionit kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

- Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/e-mail. Bashkia Selenicë kryen konsultime me publikun sipas programit të PBA. Mbahen protokolle sipas njësive të Bashkisë.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Në lidhje me parimin 16: "Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme".

- Nuk ka gjurmë auditimi të miratuar në Bashkinë Selenicë për procedurat e brendshme periodike të raportimit që rregullon zbatimin dhe monitorimin e objektivave.
- Bashkia Selenicë lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MF për vlerësimin e sistemeve për vitin 2025 sipas shkresës me nr. 592/1prot., datë 26.02.2026.
- Kryetari i Bashkisë ka miratuar plan veprimi për të gjitha rekomandimet e hartuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe Auditimi i Jashtëm (KLSH). Plani i veprimit hartohet sipas afateve të përcaktuara mbas pranimi të rekomandimeve.

Në lidhje me parimin 17:"Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë". "Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë".

- Në rastet e konstatimit të parregullsive dhe funksionimit me mangësi të KBFP nga auditi i jashtëm dhe i brendshëm dhe lënies së rekomandimeve për përmirësimin e parregullsive apo marrjen e masave disiplinore ndaj administratës, Kryetari i Bashkisë kërkon dhe miraton hartimin e planit të veprimit për rregullimin e situatës.
- Ecuria e veprimeve korrigjuese monitorohet nga Titullari i Bashkisë, i cili informohet me shkrim nga Auditi i Brendshëm për ecurinë e rekomandimeve në mënyrë periodike dhe vjetore. Raporti i AB për ecurinë e rekomandimeve Nr. 823/1 prot., datë 27.04.2025. Janë hartuar plane veprimi nga menaxherët përkatës, të cilët raportojnë me shkrim te Kryetari i Bashkisë.

Sa më sipër, arrihet në konkluzion se**:** Bashkia Selenicë ka një ***sistem të vlerësuar pjesërisht efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm***, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Konkluzion: - Nga auditimi i dosjeve të punonjësve të Bashkisë Selenicë rezultoi se për vitin 2025 nuk është kryer vlerësimi 6 mujor i punonjësve për periudhën janar-qershor dhe korrik-dhjetor 2025, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar, sipas afateve ligjore të përcaktuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë

17.10.2013, "*Për nëpunësin civil"* i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi. - Dosjet e personelit nuk përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me Lidhjen *1 "Të dhënat dhe dokumentacioni i dosjes së personelit"* të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit",* ku në asnjë rast nuk rezulton të jenë: a) Fleta prezantuese e dosjes së të punësuarit, e plotësuar sipas lidhjes nr. 2; b) Fletë inventari i dosjes së të punësuarit, që përmban listën e dokumenteve pjesë të dosjes, sipas lidhjes nr. 2; c) libreza e punës.
Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Selenicë nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit.
-Titullari i Bashkisë Selenicë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik për gjithë veprimtaritë kryesore financiare e jo financiare, si dhe mungon dokumentacioni i aktivitetit të tij për këtë periudhë.
-Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk rezulton të ketë ngritur Ekipin për Menaxhimin e Programeve,
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut për vitin 2025.
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut. Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit të Riskut për vitin 2025.
-Bashkia Selenicë nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, si dokument i unifikuar për të gjitha proceset e auditimit.
-Në Bashkinë Selenicë Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin *Microsoft Office Excel* dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes së të dhënave, niveli i riskut të gabimeve është i lartë.
-Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistemin HRMIS, por me hedhje manualisht në programin *Microsoft Office Excel*.
-Bashkia Selenicë nuk ka rishikuar rregulloren e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk është miratuar një rregullore e re për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës, ku të jenë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etj. procedurat e rekrutimit, trajnimet, shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës dhe vlerësimin vjetor i punës për çdo punonjës.
- Bashkia Selenicë nuk ka miratuar planin vjetor të punës me kundërshtim me aneksin nr. 1 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është hartuar dhe miratuar plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Selenicë sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 *"Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore".*
-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë *(back-up).* Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Selenicë, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Z. N.B, me detyrë Kryetar i Bashkisë Selenicë; Znj. S.I, me detyrë Nënkryetare e Bashkisë Selenicë*;* Znj. J.N, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore.

1.2. Organizimi dhe funksionimi i NJAB.

Në zbatim të Ligjit nr.114/2015, datë 20.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*",* i ndryshuar, neni 10, pika 1, ku në mënyrë eksplicite përcaktohet se:
"*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm, sipas formave të përcaktuara në germat a-c të kësaj pike"*, është ngritur dhe funksionon Sektori i Auditit të Brendshëm në varësi funksionale nga Titullari i Bashkisë Selenicë, duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardet Globale të Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm.
Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkia Selenicë, rezultoi se:

Organizimi dhe Funksionimi : Në bazë të VKM nr. 83, datë 03.02.2016*, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik",* është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB), e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Kapaciteti audites i strukturës së NJAB të Bashkisë Selenicë është bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 i ndryshuar. Sektori e Auditit të Brendshëm funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Urdhrin nr. 6, datë 17.01.2025, të Kryetarit të Bashkisë Selenicë. Njësia e AB e Bashkisë Selenicë përgjatë vitit 2025 ka funksionuar me 3 nëpunës konkretisht me Drejtuesin e Auditit *z.A.S (i certifikuar)* specialist auditit *zj.P,C (e pa certifikuar)*, specialist auditit *zj.A. Q (e pa certifikuar)*.

Tabela nr 1 *Struktura e njësisë AB për vitin 2025*

Nr.	Viti 2025	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	A .S	Drejtues NJAB	Ekonomist	37	9	2016	Po
2	P. C	Audituese	Financë	7	2	E pa certifikuar	Po
3	A. Q	Audituese	Financë	6	1	E pa certifikuar	Po

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Njësia e auditit të brendshëm në Bashkinë Selenicë ka funksionuar me dy punonjës për gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2025, dhe nga muaj Tetor 2025 e në vazhdim struktura është plotësuar me 3 punonjës. Për strukturën e Njësisë së AB të merren masa për certifikimin e specialistëve të auditimit të brendshëm, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe garantimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi.

Trajnimet e NjAB dhe certifikimet

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se i është kushtuar rëndësi trajnimeve të audituesve të NJAB sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Po kështu është planifikuar trajnimi i detyrueshëm prej 40 orësh në vit, për dy audites.
Për vitin 2025 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Selenicë pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2, Trajnimet e njësisë AB për vitin 2025

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni i Punës /Drejtoria	Tema e trajnimit te ndjekur	Pjesëmarrës në trajnim	Kohëzgjatja e trajnimin (në ditë)
1.	A.S P.C	Përgjegjës Audituese	Mënyra e identifikimit të risqeve, identifikimin, vlerësim dhe menaxhim	2	2 ditë
2.	A.S P. C	Përgjegjës Audituese	Auditimi i sistemeve të prokurimeve publike, planifikim dhe zbatim i buxhetit	2	2 ditë
3.	A.S P. C	Përgjegjës Audituese	Auditim i sistemeve të ardhurave në Bashki	2	2 ditë

Burimi: NJAB Selenicë përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi i Planit Vjetor të Angazhimeve:

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, nga sektori i auditit të brendshëm pranë Bashkisë Selenicë, është planifikuar të kryen 7 misione auditimit, konkretisht një auditim financiar dhe 5 auditime përputhshmërie dhe 1 i kombinuar. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Periudha	Të dhëna sipas raportimit						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh.	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
1	2025	7	7	5	1	1	0	0

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

Lista e auditimeve të realizuara nga NJAB gjatë vitit 2025:
1.Realizimi i ecurisë së realizimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme
2.Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit.
3.Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave
4.Inspektoriati i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi,
5.Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit,
6.Sektori i Policisë Bashkiake,
7.Njësia Administrative Armen.

Konstatim*:* Në lidhje me planet strategjike dhe planifikimin vjetor për vitin 2025, edhe pse auditimet janë realizuar 100% të numrit të angazhimeve të planifikuara konstatohet se, për auditimin e Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore, fushat e parashikuara për t'u audituar janë:

- Detyrimet e prapambetura;
- Prokurimet publike;
- Menaxhimi i realizimit të të ardhurave
- Menaxhimi i emergjencave civile dhe MZHSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit nga grupi i auditimit të KLSH rezultoi se nuk është kryer auditimi i "Prokurimeve Publike", në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.134, datë 17.10.2025 të Ministrit të Financave, Kreu VII.3.1, paragrafi 11, ku përcaktohet se "*Drejtuesi i auditimit të brendshëm përzgjedh aktivitetet dhe proceset me risk të lartë dhe ndikim të madh në arritjen e objektivave institucionale, të cilat konsiderohen prioritare për përfshirje në Planin Vjetor të Auditimit, si më poshtë: • Rëndësi strategjike për institucionin, • Ndikim të lartë në objektivat dhe burimet publike, • Mungesë ose dobësi të kontrolleve të brendshme."*, krahas parashikimit se: *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".*

Raportimi : Për veprimtarinë e NJAB në Bashkinë Selenicë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB të Ministrisë së Financave raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, *përkatësisht:* Me shkresën nr.445/1 prot, datë 13.02.2026, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Selenicë për vitin 2025.

Tabela nr.3, Realizimi i planit vjetor të angazhimeve audituese

Nr.	Subjektet e Audituara	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre								Statusi i Angazhimit	
			Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shër bime Këshi llimi	Angazh ime me kërkes ë të titullari		
		Gjit hsej	*A. të përputh shmërisë*	*A. të perfor mancë*	*A. finan ciare*	*A. tek. Inform acionit*	*A. të kombi nuara*			Angazhi me të përfund uara	Angazh ime në proces
1	Realizimi i ecurisë së realizimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e brendshme	1	1								
2	Drejtoria e shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit. (Detyrimet e prapambetura)	1			1						
3	Drejtoria e të ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave	1					1				
4	Inspektorati i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1	1								
5	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit	1	1								
6	Sektori i Policisë Bashkiake	1	1								
7	Njësia Administrative Armen	1	1								
	Totali	**7**	**5**		**1**		**1**			**7**	

Burimi: Bashkia Selenicë, NJAB, përpunoi grupi i auditimit

Karta e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.134, datë 17.10.2025 të Ministrisë së Financave *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik",* NJAB e Bashkisë Selenicë ka hartuar "Kartën e Auditimit të Brendshëm", e cila është miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.328, datë 04.02.2026.

Planet Strategjike dhe Vjetore.

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:
Për vitin 2025 me shkresën nr.2111 prot., datë 14.10.2024 është miratuar plani strategjik për vitet në rrugë elektronike) në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr.134, datë 17.10.2025 *"Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik".*

Gjetje-Rekomandimet.

Një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku *për vitin 2025* nga auditimet janë dhënë 37 rekomandime të ndara sipas prioriteteve: rekomandime me prioritet të lartë 10; rekomandime me prioritet të mesëm 25 dhe rekomandime me prioritet të ulët 2.
Rekomandime të ndara sipas kategorive janë: Rekomandime për arkëtim 5, rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrolli të brendshëm 19 dhe rekomandime të tjera 13.

Tabela nr.4, Niveli i zbatimit të rekomandimeve

Periudha	Të dhëna sipas raportimit			
	Rekomandime te shprehura ne numër			
	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
Viti 2025	37	7	25	5
TOTALI	**37**	**7**	**25**	**5**

Burimi: Bashkia Selenicë, përpunoi grupi i auditimit

-Rekomandimet e dhëna në vitin 2025 ne total janë 37 dhe konkretisht:
-Rekomandime me nivel të lartë risku janë 10
-Rekomandime me nivel të mesëm risku janë 25
-Rekomandime me nivel të ulët të riskut janë 2

Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të AB. NJAB u ka dërguar shkresa njësive të audituara për informim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore.

Komiteti i Auditit të Brendshëm
Komiteti i Auditimit të Brendshëm, si organ i pavarur që duhet të monitorojë, ofrojë këshilla dhe rekomandime objektive për titullarin e njësisë publike lidhur me funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të mbështesë njësinë e auditimit të brendshëm në përmbushjen e përgjegjësive të saj, nuk është krijuar nga Bashkia Selenicë.
Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se nuk ka urdhër të titullarit për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar, neni 12, pika b, i cili përcakton se titullari i njësisë publike është përgjegjës për: "*Krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike përkatëse sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave,* sipas shkronjës "b" të nenit 23 të këtij ligji" dhe VKM nr.160, datë 2.3.2016 "*Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike".*

Konstatim: Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 *"Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"* i ndryshuar dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 *"Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit.".*

Auditimi i dosjeve të auditimit kryer nga DAB

Grupi auditimit duke patur në fokus gjetjet e konstatuara në subjektet e audituara në periudhën objekt auditimi 2025, përzgjodhi të auditojë dosjet si me poshtë:
1.Drejtoria e shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit. (Detyrimet e prapambetura)
2.Drejtoria e të ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave
3.Inspektoriati i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
4.Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit
5.Njësia Administrative Armen.
- Gjetjet kryesore të Auditit të brendshëm:

-Mos-planifikim real, mungesë bashkëpunimi midis Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve e Licencave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare e Arkiv Protokollit në planifikimin e të ardhurave të veta, duke sjellë për pasojë mungesë fondesh financiare për likuidimin e detyrimeve te prapambetura.
-Mosrespektimi i afateve ne shlyerjen e detyrimeve duke zbatuar radhën kohore të lindjes së detyrimit si dhe një shpërndarje të barabartë në % në likuidimin e detyrimeve të prapambetura për çdo subjekt, mungesa e një plani shlyerje të detajuar në analizë sipas llogarive përkatëse, mallra

dhe shërbime, investime dhe vendime gjyqi. Kjo praktike është e detyrueshme për planifikimin në çdo fillim viti kalendarik. Ky plan duhet te miratohet dhe arkivohet.
-Mungesë rakordimi midis strukturës së punonjësve të drejtorisë së të ardhurave me strukturat e bashkisë dhe agjentet tatimor të ngarkuar me ligj për menaxhimin dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore qe janë : renta minerare dhe taksa e qarkullimit te automjeteve nga agjentet tatimor si dhe taksave dhe tarfia te tjera te ngarkuara strukturave te bashkisë për menaxhimin dhe arkëtimin e tyre.
-Mungon një regjistër ku të evidentohen të dhënat e taksapaguesit, vendbanimi, lloji i taksës, vlera e taksës dhe dokumentacioni mbështetës i cili vërteton që taksapaguesi plotëson kriteret për lehtësirat tatimore të parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.
-Mangësi në sistemimin e dosjeve të punës, pasaktësi dhe shkrim të pakuptueshëm në dokumentimin e aktivitetit në librat e shërbimit, kryesisht në dokumentimin e ndërhyrjeve operacionale. Nuk ka një regjistër ku të jenë të regjistruara veprimet që gjenerojnë të ardhura. Nga arkëtimi i vlerës së shërbimit që jep MZSH kundrejt tarifave. Nuk ka rakordim midis MZSH dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Pronës Publike dhe Lejeve e Licencave..
-Dosja e punonjësve të strukturës së IMT dhe përshkrimi i punës për çdo punonjës nuk është realizuar. Gjithashtu mungon raportimi periodik dhe trajnimi profesional i punonjësve.

Konstatim: -Në raportet përfundimtare të auditimit, audituesit nuk kanë dhënë opinion të përgjithshëm mbi vlerësimin e sistemeve të audituara, nëse këto sisteme janë efektive dhe nëse funksionojnë në nivelin e duhur nga të gjitha strukturat apo punonjësit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve, e cila duhet të integrohet edhe në kapitullin e përmbledhjes ekzekutive (*e cila paraqet vetëm gjetjet dhe rekomandimet përkatëse pas sistemeve të vlerësuara)* dhe në vijim pas çdo sistemi apo fushe të audituar.
-Raportet e Auditimit nuk kanë në përmbledhjen ekzekutive të përfshirë një përshkrim të shkurtër të subjektit sipas kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ku përcaktohet se "*Përmbledhja Ekzekutive shpjegon qëllimin e raportit, prezanton në mënyrë sintetike aktivitetet më të rëndësishme të vitit, gjetjet dhe rekomandimet kryesore, si dhe jep një vlerësim të përgjithshëm mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut*", (Aneksi 3, Formati Standard nr 12).

<u>Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm.</u>

Programi i sigurimit të cilësisë është projektuar për të mundësuar vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me qëllimin e krijimit të shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe për të vlerësuar nëse audituesit e brendshëm e zbatojnë Kodin e Etikës dhe Standardet. Programi i sigurimit të cilësisë , vlerëson efikasitetin, efektivitetin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe identifikon mundësitë për përmirësim.
Njësia e Auditimit në Bashkinë Selenicë ka funksionuar me dy punonjës në dhjetëmujorin e parë të vitit 2025, njëkohësisht drejtuesi i NjAB ka marrë pjesë në grupin e Auditimit në çdo angazhim auditimi. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Selenicë ka hartuar *"Programin për sigurimin e brendshëm të cilësisë të drejtorisë së auditimit të brendshëm"* me shkresën nr.15 prot., datë 28.01.2025,sipas kërkesave të Kreut XI.3.2 "Vetëvlerësime ose vlerësime periodike", të MAB të vitit 2025.
Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e kofidencialitetit në Bashkinë Selenicë në përputhje me Ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit" e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr.15 prot., datë 28.01.2025.

Dosja e përhershme

Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit kjo në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhime auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.* Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo angazhim auditimi me qëllim që të sigurohen ndryshimet e ndodhura në përmbajtjen e saj. Dosja e përhershme mbahet në format elektronik ose të printuar, kjo në funksion të mundësive të NjAB.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b, e Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";

-Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull.

-Nuk janë audituar Sektorët dhe Drejtoritë që paraqesin risk të lartë për sa i përket gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve ligjore, si p.sh: nuk është kryer auditimi i "Prokurimeve Publike", në mospërputhje me përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm*,"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".*

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit , nuk janë te përditësuara kjo në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me nenin 12, pika b, e Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik";

-Karta e Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me formatin e paraqitur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me

-Plani strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm është hartuar në përputhje me standardet e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe aneksin me modelin përkatës në fundin e kapitullit III.

-Plani vjetor i auditimeve për vitin 2025 është përgatitur në mënyrë të rregullt, në përputhje me paragrafin 3.2 të Kapitullit III të MAB, si dhe me modelet përkatëse në po këtë kapitull.

-Nuk janë audituar Sektorët dhe Drejtoritë që paraqesin risk të lartë për sa i përket gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve ligjore, si p.sh: nuk është kryer auditimi i "Prokurimeve Publike", në mospërputhje me përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm*,"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit".*

-Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit , nuk janë te përditësuara kjo në mos përputhje me përcaktimet e bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm ku përcaktohet se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi publike ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi*:*
z.N.B me detyrë Kryetar i Bashkisë Selenicë,
z.A S me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Auditit të Brendshëm.

2. Planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, nga ana e Bashkisë Selenicë

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:

1.1.Programimi PBA-së 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025:

-Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se është ngritur Grupi Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr.168, datë 28.12.2024. Nuk janë hartuar EMP (Ekipi i Menaxhimit të Programit).
-Grupi i auditimit ka analizuar dokumentacionin e hartimit te PBA-se për tre fazat dhe dokumentimin e hartimit të kërkesave buxhetore nga çdo sektor apo zyrë:
-Sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me nr .129, datë 10.12.2024 është krijuar grupi i punës për hartimin e buxhetit të vitit 2025 ku përfshihen anëtarët e GMS dhe drejtues të NJA dhe institucioneve të varësisë së Bashkisë.
-Nuk janë miratuar "*Vlerësimet afatmesme të ardhurave të Bashkisë Selenicë për vitet 2025-2027".*
-Është miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimin nr.99, datë 18.12.2023 *"Kalendari i Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025*" si dhe janë miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027
-Kryetari i Bashkisë Selenicë ka dërguar pranë Ministrisë së Financave projekt-dokumentin e PBA 2025-2027 ***(Faza I)*** me shkresën Nr.24 prot., datë 30.05.2024. Pas dërgimit të komenteve nga Ministria e Financave mbi projekt-dokumentin e PBA është bërë miratimi i PBA 2025-2027 (Faza 1) me VKB nr. 24, datë 30.05.2024.
-Nuk janë miratuar tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm dhe nuk është bërë miratimi i PBA 2025-2027 ***(Faza II)***. Nga ana e Bashkisë nuk është dërguar në Ministrinë e Financave faza e dytë e PBA-së.
-Faza e III e Buxheti i Bashkisë Selenicë për vitin 2025 është miratuar me VKB nr.54 datë 26.12.2024 , aprovuar nga Prefektura nr.1097/1,date.08.01.2025 "Për Buxhetin 2025"

- ✓ Sipas VKB nr.54, datë 26.12.2024 është miratuar **Buxheti Vjetor 2025** (*me të ardhurat gjithsej dhe shpenzimet gjithsej në shumën* **702,990** mijë lekë *dhe të detajuara sipas natyrës, miratuar plani i të ardhurave për periudhën 3 vjeçare të PBA-së dhe detajimi i buxhetit 2025-2027 për grupin e shpenzimeve korente dhe kapitale sipas programit buxhetor afatmesëm 2025-2027).*

Buxheti i Bashkisë Selenicë për vitin 2025 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr.71 prot., datë 13.01.2025. . ***Faza e III*** e Buxhetit afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Selenicë është miratuar me VKB nr. 54, datë 26.12.2024.Shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr.10/1, datë 16.01.2025.
- Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, për vitin 2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik por nuk janë ngritur EMP sipas kërkesave të Ligjit Nr.9936, datë

26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor"* i ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 27, pika 2, ku përcaktohet që:

Neni 27: "Takime periodike ndërmjet menaxherëve të njësisë së sektorit publik":
Pika 2. Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje.

pikën nr. 2.4.2, "*Grupi i Menaxhimit Strategjik*", të Manualit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024 ku përcaktohet që:

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë GMS me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike. GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

Paragrafin 13 të Udhëzimit të MF nr. 3, datë 28.02.2024*, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027",* ku përcaktohet që:

13,Kërkesat buxhetore të dorëzuara te koordinatori i GMS vlerësohen dhe miratohen nga Grupi për Menaxhim Strategjik i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.

pika 11 ku përcaktohet që:

Pika 11: Drejtuesit e EMP paraqesin kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit te Koordinatori i GMS, brenda muajit prill 2024.

si dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024

Tabela nr.5, *Burimet që përbejnë Buxhetin për vitin 2025:*

Nr	Burimet qe e përbejnë buxhetin 2025	Plan Buxhetit fillestar 2025	Shtesat	Total Planet e Buxhetit 2025	Fakti 2025	Mbetur	Në % te Planit dhe realizimit
1	Transferta e pakushtëzuar(granti) 2025	278,052,726	21432318	299,485,044	208,888,893	90,596,151	69.75%
2	Të trashëguarat viti 2024 nga granti	85,000,000	27,942,757	112,942,757	112,942,757	0	100.00%
3	Transferta specifike 2025	107,867,277	2604000	110,471,277	81,525,560	28,945,717	73.80%
4	Të trashëguarat viti 2024 nga transferta specifike	15,000,000		15,000,000	5,170,000	9,830,000	34.47%
5	Të ardhurat vendore 2025	177,070,000		177,070,000	24,603,021	152,466,979	13.89%
6	Te ardhura te trashëguara	50,000,000	21,977,120	71,977,120	71,977,120	0	100.00%
1	Shuma i Buxheti nga te ardhurat e veta	**712,990,003**	**73,956,195**	**786,946,198**	**505,107,351**	**281,838,847**	**64.19%**
	Financim i huaj		5,209,249	5,209,249	4,193,527	1,015,722	80.50%
1	Shuma i Buxheti nga te ardhurat e veta	**712,990,003**	**79,165,444**	**792,155,447**	**509,300,878**	**282,854,569**	**64.29%**
	Fondet e kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit	325,588,199		325,588,199	299,865,211	25,722,988	92.10%
	Shuma 2 Buxheti i Shtetit	325,588,199	0	325,588,199	299,865,211	25,722,988	92.10%
	TOTAL Shuma1+ Shuma 2	**1,038,578,202**	**79,165,444**	**1,117,743,646**	**809,166,089**	**308,577,557**	**72.39%**

Burimi*: Bashkia Selenicë , përpunoi grupi i auditimit*

Konstatim: Në pasqyrën e mësipërme evidentohet një shtesë e trashëguar nga transferta e pakushtëzuar në vlerën prej ***27,947,757 lekë*** , dhe një shtesë te të trashëguarat nga të ardhurat në vlerën ***21,977,120 lekë***, ku është bërë korrigjimi i të trashëguarave me Vendim të Këshillit të Bashkisë. Evidentohet një shtesë nga financimi i huaj i trashëguar në vlerën ***5,209,249 lekë***, dhe një shtesë nga transferta specifike për shpërblimin e punonjësve të zjarrfikëses në vlerën ***2,604,000 lekë***.

Buxheti i Bashkisë për vitit **2025** është realizuar në vlerën ***809,166,089 lekë*** ose ***72.39%*** kundrejt planit vjetor të vitit **2025**.Nga këto ***505,07,351 lekë*** nga të ardhurat e veta dhe ***299,865,211 lekë*** nga buxheti I shtetit dhe ***4,193,527 lekë*** nga financimi i huaj .

Takimet konsultative me grupet e interesit në komunitet:

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Selenicë për PBA 2025-2027 dhe Projekt buxhetin e vitit 2025, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I, neni 5 pika ç;

Tabela nr.6, Dëgjesa publike PBA 2025-2027

	PBA 2025-2027	
	Datat e mbajtjes së tyre	
Numri i takimeve	**6**	
NjA Administrative Armen	16.09.2024 ora 11:00	
NjA Administrative Vllahine	17.09.2024 ora 11:00	
NjA Administrative Kote	18.09.2024 ora 11:10	
NjA Administrative Sevaster	19.09.2024 ora 11:00	
NjA Administrative Brataj	20.09.2024 ora 11:00	
Qëndër Selenicë	23.09.2024 ora 11.:00	

Burimi: DFB/Bashkia Selenicë

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, neni 11-20; dhe pika 16 e Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

16.Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore organizon takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.

Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit Vjetor.

Bashkia Selenicë ka hartuar "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor" për Bashkinë dhe njësitë administrative për vitin 2025 dhe miratuar me VKB nr. *VKB nr54,datë 26.12.2024*,,në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.

Programi afatmesëm 2025-2027 është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 9652/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit", Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 *"Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027" dhe VKB për miratimin e taksave vendore për Bashkinë për vitin 2025. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura

financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*

Tabela nr 7, Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2025

Të dhënat në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2025
Të ardhurat faktike	121,856,334
Shpenzimet faktike	509.300.878

Burimi: Bashkia Selenicë. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

1.1. Programimi i PBA 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor 2025:

Tabela nr.8 *Të dhënat në mijë lekë*

		Buxheti Faktik 2024	**Faza e I PBA 2025**	**Faza e II PBA 2025**	**Projekt Buxhet 2025**
600	Paga	181582	227473	227473	236563
601	Sigurime Shoqërore	30011	25476	25476	40806
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	86048	177023	177023	201925
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	4423			
I	**Shpenzime Korrente**	**302064**	**429972**	**429972**	**479294**
230	Kapitale të Patrupëzuara	522			10000
231	Kapitale të Trupëzuara	56406	103857	103857	223696
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm				
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	**Shpenzime Kapitale**	**56928**	**103857**	**103857**	**223696**
III	**Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti**				
I+II +III Totali I Shpenzimeve		**358,992**	**533,829**	**533,829**	**702,990**

Burimi: Bashkia Selenicë

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2025

Të dhënat në mijë lekë

- Me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr.54, datë 26.12.2024, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi njësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2025.
- Me Vendimin nr. 54, datë 26.12.2024 është miratuar niveli i pagave të Bashkisë Selenicë.

Të dhëna në formë tabelore për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:


Tabela nr.9, *Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave buxhetore2024,2025*

Të dhënat në mijë lekë

Nr	**Llojet e të Ardhurave**	**Fakti 2024**	**Plani 2025**	**Fakti 2025**
1	Të ardhurat nga taksat	43,248,273	63,040,000	43,976,250
2	Të ardhurat nga tarifat	40,677,057	90,030,000	48,774,722
3	Taksa e ndarë	22,073,404	19,000,000	18,560,058
4	Të tjera taksa	11,195,197	5,000,000	10,545,304
	Totali	**117,193,931**	**177,070,000**	**121,856,334**

Burimi*: Bashkia Selenicë*

Në trajtë grafike niveli i realizmit të të ardhurave paraqitet si vijon:



Burimi: Bashkia Selenice, Raporti Monitorimit te Zbatimit te Buxhetit, $ mujori III, viti 2025

Konstatim: Për vitin 2025 totali i planifikuar për të ardhurat është në vlerën 177,070,000 lekë, dhe fakti në vlerën 121,856,334 lekë ose 68.8% e realizimit.

Buxheti i vitit 2025 është i detajuar në 15 programe buxhetore.
Më poshtë paraqitet tabela e realizimit të shpenzimeve për vitin 2025 për 15 programe buxhetore.
Tabela nr.10, realizimit të shpenzimeve për vitin *2025* *Të dhënat në lekë*

Programi		**2024**	**2025**			Ndryshimi (%)	
Kodi	Emërtimi	Fakti	Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Fakti	Fakti vs. Fillestar	Fakti vs. Rishikuar
1110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	141,391,504	227,889,565	242,051,691	199,305,877	87.46%	82.34%
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	5,617,480	7,500,000	7,500,000	6,254,047	83.39%	83.39%
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	15,954,104	21,797,495	24,401,495	18,869,525	86.57%	77.33%
4240	Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit	41,124,757	49,052,385	49,052,385	13,601,896	27.73%	27.73%
4260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave	9,496,603	24,279,575	24,279,575	11,462,375	47.21%	47.21%
4520	Rrjeti Rrugor Rural	31,653,449	165,658,222	200,548,222	112,692,141	68.03%	56.19%
4910	Fondi Rezerve	0	7,129,000	28,561,318	199,758	2.80%	0.70%
4940	Fondi Kontigjence	4,208,784	14,260,700	14,260,700	0	0.00%	0.00%
5100	Menaxhimi i mbetjeve	18,544,527	40,925,000	36,795,000	23,619,463	57.71%	64.19%
6260	Shërbimet Publike Vendore	20,548,871	33,294,300	33,694,300	22,731,835	68.28%	67.46%
6370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	3,138,204	6,948,118	6,948,118	448,118	6.45%	6.45%
8130	Sport dhe argëtim	752,906	1,950,000	6,440,000	3,600,267	184.63%	55.90%
8220	Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat	3,033,885	6,750,000	7,467,000	6,581,303	97.50%	88.14%
9120	Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor)	40,998,741	85,724,061	85,724,061	68,360,282	79.74%	79.74%
9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	18,644,356	13,231,582	14,331,582	12,605,678	95.27%	87.96%
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	3,883,739	6,600,000	10,100,000	8,968,313	135.88%	88.80%
Totali		**358,991,910**	**712,990,003**	**792,155,447**	**509,300,878**		**64%**

Burimi: Bashkia Selenicë

Konstatim*:* Nga auditimi rezultoi se totali i shpenzimeve faktike për vitin 2024 është 358,991 mijë lekë, kurse sipas buxhetit vjetor fillestar të miratuar nga KB është 712,990 mijë lekë. Totali i buxhetit të rishikuar i vitit 2025 është në vlerën 792,155 mijë lekë, kurse realizimi i buxhetit faktik 2025 prej 509,300 mijë lekë. Konstatohet një rritje prej 79,165 mijë lekë ndërmjet planit fillestar

dhe buxhetit të rishikuar. Programimi është kryer në përputhje me procedurat ligjore, por janë konstatuar devijime të konsiderueshme ndërmjet planifikimit fillestar dhe buxhetit përfundimtar, veçanërisht në zërat e investimeve. Niveli i realizmit të zërave buxhetor në fund të vitit 2025 është 71.4 % kundrejt planit vjetor dhe 64.2% ndaj buxhetit të rishikuar.
Sa më sipër mosrealizimet nuk janë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", pika 114:

Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në Këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga Këshilli, dërgohet në Ministrinë përgjegjëse për financat në rrugë elektronike dhe me shkresë zyrtare, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"

1.2.Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;

Tabela nr.11,, *Ndryshimet e buxheteve periudha 01.01.2025-31.12.2025:*

Periudha buxhetore		Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve			
		Nr/ datë	Vlera	Buxheti fillestar	shtesa	pakesime	Buxheti total
Viti 2025	VKB Nr 54 datë 26.12.2024	712990	VKM nr 54datë 26.12.2024				
			600	236562556	10887000		236562556
			601	40806000	907000	200000	40806000
			602	199925702	29619877	17523697	199925702
			230	10000000			10000000
			231	223695745	30056941	1223244	223695745
			604	2000000	2604000	2604000	2000000
			Investimi huaj		5209249		5209249
			Grant i pakushtezuar i papaerdorur		19185127		19185127
			Grant performance i paperdorur		2247191		2247191
				712990003	**100716385**	**21550941**	**792119129**

***Burimi**:Bashkia Selenicë*

Konstatim: Buxheti fillestar ishte në vlerë 712,990,003 lekë, ndërsa buxheti i rishikuar: 792,155,447 lekë. Realizimi faktik në vlerën 509,300,878 lekë dhe niveli i niveli i realizimit: 64%. Konstatohen nivele të ulëta realizimi në disa programe si Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit 27.73%, Furnizimi me ujë dhe kanalizime 6.45% ; Fondi rezervë 2.8% ;Ndërsa realizim i lartë në Arsimi i mesëm 95.27%, Trashëgimia kulturore 97.5%, etj. Nga auditimi u konstatua se realizimi i buxhetit në masën 64% tregon se ne Bashkinë Selenicë ka pasur vështirësi në përdorimin e plotë të fondeve dhe se planifikimi i buxhetit nuk ka qenë plotësisht në përputhje me mundësitë reale për zbatimin e aktiviteteve.

Auditimi mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencës
Për vitin 2025, vlerat e llogaritura për këtë qëllim janë ***21,389,700 lekë.***
Fondet e shpenzuara

Në VKB nr. 54, datë 26.12.2024 është miratuar për vitin 2025, fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total 21,389,700 lekë, si vijon:

- ✓ fondi rezervë nga granti në vlerën 11.000.000 lekë;
- ✓ fondi rezervë nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- ✓ fondi kontigjencës nga granti në vlerën 10,389,700 lekë;
- ✓ fondi kontigjencës nga të ardhurat në vlerën 0 lekë;
- ✓ fondi i emergjencës civile në vlerën 0 lekë.

Konstatim: Totali i miratuar sipas VKB nr. 54, datë 26.12.2024 për zërat fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës është në vlerën 21,389,700 lekë. Nga këto janë përdorur 2,604,000 lekë për shpërblimin e punonjësve të MZSH. Konstatohet se pjesa më e madhe e fondeve rezervë /kontigjencë ka mbetur e papërdorur. Planifikimi është bërë në përputhje me kërkesën ligjore 3% sipas ligjit për mbrojtjen civile, por përdorimi ka qenë minimal. Mbështetur në nenin 65, të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej *3 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre*, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e veta vendore etj.
Me shkresën nr.483 prot., datë 02.09.2025 është bërë alokimi i transfertës specifike *"Për mbrojtjen civile", "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet e shuarjes së zjarrit gjatë vitit 2025 si dhe në zbatim të shkresës së ardhur nga MF nr. 14505/11 datë 24.10.2025"Mbi zbatimin e aktit normativ nr. 10, datë 08.10.2025","Për disa shtesa në ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025" të ndryshuar, për dhënie shpërblimi për punonjësit e MZSH të angazhuar në shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025*,Vendimi i KM nr. 414, datë 08.07.2021 pika 2(b) dhe VKB nr. 58, datë 26.11.2025, në vlerën 2,604,000 lekë, e cila është shpenzuar për shpërblimin e punonjësve të zjarrfikëses.
Si përfundim, vlera e këtyre fondeve të miratuara dhe të shpenzuara paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lek

Nr.	Burimi i financimit	Vlera e planifikuar	Vlera e shpenzuar	Vlera e pa shpenzuar
1	Fonde rezerve	7,129,000	199,758	6,929,242
2	Fondet e kontrigjences	14,260,700	0	14,260,700
3				
	Total	21,389,700	199,758	21,189,942

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Selenicë
Për vitin 2025 nuk ka subvencione dhe nuk është marrë kredi nga Bashkia Selenicë.

Fondet e trashëguara nga ana e Bashkisë Selenicë nga vitet e mëparshme janë:

Fondet e trashëguara në 31.12.2024 për përdorim në vitin 2025 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)	Fondet e trashëguara në 31.12.2025 për përdorim në vitin 2026 sipas rakordimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)
155,128,126	155,128,126

1.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Raportimi i detyrimeve të prapambetura

Të dhënat përkatëse sipas formatit të raportuar në MFE për vitin 2025:

Tabela nr 12, .Të dhënat në lekë

Nr	Emërtimi detyrimit	Gjendja 31 dhjetor 2024	Shtesat	Pakësimet	Gjendja 31 dhjetor 2025
1	Mallra e shërbime	9,059,106	11,080,893	10,794,429	9,345,570
2	Vendime gjyqi	5,391,654	2,591,628	2,989,522	4,993,760
3	Investime	7,355,171	63,774,806	66,820,183	4,309,794
	Totali	**21,805,931**	**77,447,327**	**80,604,134**	**18,649,124**

Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare

Tabela nr.13

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	**Borxhe (a+b)**	**0**		
a	**Hua afatgjatë**	**0**		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	**Hua afatshkurtër**	**0**		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**18,531,476**		**3.64%**
Llogaria ekonomike	**Emërtimi**			
4864100	Vendime Gjyqesore	4,993,760		
4864200	Det.Prap. Sherbime	5,023,952		
4864201	D.P.Energji Elektirke	171,579		
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	4,192,146		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	3,799,738		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	299,262		
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	51,039		
4864901	Paga			
4864902	Shpronesime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet	0		
III	**Totali (I+II)**	**18,531,476**	**509,300,879**	**3.64%**

Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet 2026-208:

			Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve				
Nr.	Bashkia/Këshilli i Qarkut	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2025	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028	Diferencë (Fakt-Plan)	Shënime


	Bashkia Selenicë	18,649,124	15,149,124	3,500,000		0	

Burimi: Bashkia Selenicë, Raportimi në MF (Drejtorisë së Financave Vendore)

Bashkia Selenicë në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor **detyrime të prapambetura** progresive në shumën prej **21,805,931 lekë** dhe detyrimet progresive në fund të vitit 2025 janë **18,649,124 lekë** (si në tabelën e skanuar më poshtë). Bazuar në evidencat e audituara konstatohet se detyrimi i mësipërm nuk është likuiduar për arsyet e mëposhtme dhe i përbërë nga sa vijon:

- Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore ne vlerën 4,933,760 lekë,
- Detyrime të prapambetura për investime në vlerën 8,882,897 lekë
- Detyrime të prapambetura për mallra e shërbime ne vlerën 4,309,794 lekë.

Shuma 18,649,124 lekë.



Permbledhese e detyrimeve te prapambetura viti 2025

Emertimi detyrimit	Gjendja 31 dhjetor 2024	Shtesat	Pakesimet	Gjendja 31 dhjetor 2025
Mallra e sherbime	9,059,106	11,080,893	10,794,429	9,345,570
Vendime gjyqi	5,391,654	2,591,628	2,989,522	4,993,760
Investiume	7,355,171	63,774,806	66,820,183	4,309,794
Totali	**21,805,931**	**77,447,327**	**80,604,134**	**18,649,124**

Drejtori

Detyrimet e prapambetura 2025.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, vlera e raportuar nga Bashkia Selenicë në MF për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2025, (shkresa nr.492 date 18.02.2026), është 18,649,124 lekë, dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtorisë së Financave Vendore) në kuadër të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë Shtator - Dhjetor 2025. Referuar përcaktimeve të Kreut II, pikat nr. 6 dhe 13, të Udhëzimit nr.35, dt. 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të":*

6."Detyrime financiare të prapambetura (të konstatuara dhe të papaguara)" konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, si edhe ato pas afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshjen apo legjislacionin përkatës. (p.sh marrëdhëniet e punës dhe kontributeve, vendimet gjyqësore, për rimbursimin e TVSH-së etj.).

13. "Gjendje normale financiare", *në kuptimin e këtij udhëzimi quhet rasti kur detyrimi financiar i prapambetur është nën 15% të shpenzimeve vjetore faktike, dhe që është në një afat nën 60 ditë kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).*

Konstatim: Nga auditimi rezultoi se gjendja e stokut të detyrimeve të prapambetura më datën 31.12.2025 për Bashkinë Selenicë në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor *detyrime të prapambetura* progresive në shumën prej 21,805,931 lekë dhe detyrimet progresive në fund të vitit 2025 janë ulur, duke rezultuar në shumën prej 18,649,124 lekë Bazuar në evidencat e audituara

konstatohet se detyrimi i mësipërm nuk është likuiduar për arsyet e mëposhtme dhe i përbërë nga sa vijon:

- Detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore ne vlerën 4,933,760 lekë,
- Detyrime të prapambetura për investime në vlerën 8,882,897 lekë
- Detyrime të prapambetura për mallra e shërbime ne vlerën 4,309,794 lekë.

Pesha e detyrimeve kundrejt shpenzimeve vjetore faktike është 3.64%,
Sipas Udhëzimit nr. 35/2023 të MFE, niveli nën 15% konsiderohet *"gjendje normale financiare".* Bashkia rezulton në gjendje normale financiare, megjithatë ekziston risku i rritjes së detyrimeve nga niveli i ulët i realizimit të të ardhurave.

Në fund të vitit 2024, institucioni paraqiste detyrime të papaguara nga vendime gjyqësore, mallra e investime në vlerën 21,805,931 lekë. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar detyrime të reja në shumën 77,447,327 lekë, të krijuara nga dy vendime gjyqësore të reja për largim nga puna dhe nga faturat e pa likuiduara në afat.
Gjatë vitit 2025 janë kryer pagesa në shumën totale 80,604,134 lekë. Si rezultat i këtyre pagesave, në datën 31.12.2025 detyrimet e mbetura gjithsej paraqiten në vlerën 18,649,124 lekë.
Nga analiza e të dhënave rezultoi se gjatë vitit 2025 është bërë progres në shlyerjen e një pjese të detyrimeve gjyqësore, duke mbyllur plotësisht disa çështje të mbartura dhe duke reduktuar stokun e detyrimeve të trashëguara. Megjithatë, niveli i detyrimeve të mbetura vijon të mbetet i konsiderueshëm. Nga analiza e listës së detyrimeve për vendimet gjyqësore rezultoi se Bashkia Selenicë ka vijuar procesin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2025, duke likuiduar plotësisht disa vendime gjyqësore dhe duke ulur pjesërisht stokun e detyrimeve. Megjithatë, pavarësisht pagesave të kryera gjatë vitit, në fund të vitit mbeten ende detyrime të konsiderueshme për këtë zë në vlerën 4,993,760 lekë. Gjithashtu, gjatë vitit janë krijuar detyrime të reja nga vendime gjyqësore në shumën 2,591,628 lekë, çka ka ndikuar në ruajtjen e një niveli të lartë të detyrimeve në fund të periudhës raportuese. Për rrjedhojë, mbetet e nevojshme planifikimi i fondeve dhe ndjekja e vazhdueshme e procesit të likuidimit të këtyre detyrimeve, me qëllim reduktimin e stokut të detyrimeve gjyqësore dhe shmangien e kostove shtesë që mund të lindin nga vonesat në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Konstatim: Nga auditimi rezultoi se në Bashkinë Selenicë PBA 2025–2027 dhe buxheti vjetor 2025 janë miratuar në përputhje me kuadrin ligjor. Ka devijime të ndjeshme ndërmjet planifikimit fillestar dhe buxhetit përfundimtar. Realizimi i të ardhurave vendore është i ulët (68.8%). Realizimi i shpenzimeve është 64%, dhe raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve gjithsej është në 3.64 %. Fondet rezervë/kontigjencë janë përdorur minimalisht. Nuk janë hartuar EMP (Ekipi i Menaxhimit të Programit). Konstatohet se Bashkia Selenicë ka respektuar kuadrin ligjor në hartimin dhe miratimin e PBA dhe buxhetit 2025, por evidentohen dobësi në planifikimin e të ardhurave dhe në nivelin e realizimit të shpenzimeve, të cilat kërkojnë masa përmirësuese për rritjen e eficiencës financiare

2.1- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

1. <u>Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:</u>
Struktura organizative e Bashkisë Selenicë, e zbatuar për vitin 2025 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.06, datë 17.01.2025 "*Për strukturën e Bashkisë për vitin 2025 dhe nivelin*

e pagave" dhe urdhrin nr. 05, datë 17.01.2025 "Për organikën e vitit 2025 dhe nivelin e pagave të punonjësve", në të cilën përfshihet edhe Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave (shkurt në vijim DAPPL&L), e përbërë nga 9 pozicione pune në strukturë, më konkretisht:

- 1 drejtor,
- 1 specialist kontabilizimi dhe shërbimi ndaj tatimpaguesve,
- 1 specialist i statistikave dhe menaxhimit të borxhit
- Nga një Punonjës të taksave në NJA Armen, Vllahinë, Kotë, Brataj dhe Sevaster

Për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar ***Paketa Fiskale,*** e propozuar sipas Projekt Vendimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.43 Prot, datë 27.11.2024 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2025"* konfirmuar nga Prefektura Vlorë me nr.1087/1 prot., datë 16.12.2024.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2025, rezultoi se ajo ka përcaktuar rregullat mbi mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e kësaj NJVQV, për vendosjen e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre, duke strukturuar gjithë kategoritë e taksave që administrohen nga ky organ vendor, kategoritë dhe grupimet përgjegjëse të pagimit të taksave dhe strukturat përgjegjëse për mbledhjen e këtyre të ardhurave.

- Në Bashkinë Selenicë bëhet publikimi i VKB-ve në platformën online "Vendime.al". (Në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative është miratuar platforma online Vendime.al, e cila shërben për publikim të VKB-ve).
- Procesi për planifikimin, përllogaritjen e detyrimeve tatimore, ndjekjen e subjekteve debitore për taksa tarifa vendore ***nuk është bazuar në rakordimin e të dhënave vjetore midis DAPPL&L, Drejtorisë Rajonale të Tatime Taksave Vlorë, Qendrës Kombëtare të Biznesit***, lidhur me numrin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin që administron Bashkia Selenicë analizën e rezultatit historik, pritshmërinë e vitit korrent dhe koordinimit midis drejtorive/ sektorëve që mbulojnë realizimin e tyre.
- DAPPL&L përllogaritjen e njoftim detyrimeve e bën brenda afateve të përcaktuara në paketë fiskale, dhe bën njoftimin e të gjitha subjekteve në lidhje me detyrimet tatimore pasi mungon një adresar i plotë dhe i qartë për kategoritë Familjarë dhe *Biznes (**nuk përdoren metoda alternative "e-mail" për njoftimin e tatimpaguesve).***

A.Auditimi i "Regjistrit Elektronik" të Tatimeve dhe Taksave Vendore ndaj subjekteve tatim paguese, që ngarkohen dhe shlyhen nga subjektet:

- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj. është regjistri elektronik i DAPPLL.
- DAPPL&L çdo fillim viti krijon një regjistër të ri elektronik ***në format Microsoft Excel*** për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Bazuar në regjistrin elektronik që Bashkia Selenicë ka përgatitur, kryhet menaxhimi i informacionit mbi të dhënat sa i përket regjistrimit /ç'regjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimit dhe regjistrimit të arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për kategori të caktuara taksapaguesish

-Për periudhën në auditim është hartuar Regjistri për dokumentimin e nivelit të Taksave dhe Tarifave për çdo NJA dhe fshat, duke përfshirë listat e tatimpaguesve dhe detyrimet sipas kategorive të tatimeve e taksave apo detyrimeve për pagesë, kryesisht për detyrimet tatimore për tokat bujqësore mbajtur sipas Njësive Administrative dhe fshatrave. Në këtë regjistër është shënuar shuma e pagesave të kryera për vitin por pa referuar dokumentin financiar (nr dhe datat e dokumentit)**.**

Konstatim: Regjistrat për Taksat dhe Tarifat për çdo NJA dhe fshat, ku janë përfshirë listat e tatimpaguesve dhe detyrimet sipas kategorive të tatimeve nuk janë protokolluar dhe arkivuar në momentin e mbylljes së regjistrit elektronik vjetor. Regjistrat e debitorëve nuk janë nënshkruar nga Drejtori i Të Ardhurave, Pronave Publik, Lejeve dhe Licencave dhe nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk janë të protokolluar e arkivuar si dokumente financiare në kuadër të gjurmës së auditimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike.
Për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit mbylljes së regjistrit vjetor ekzistues e depozitim të tij në Zyrën e Protokoll- Arkivës *(version hard copy dhe CD)* dhe krijimit të regjistrit të ri vjetor.
Dorëzimi me procesverbal dhe arkivimi i kopjes së printuar dhe elektronike (CD), përpara krijimit të regjistrit elektronik të vitit pasardhës siguron gjurmën e auditimit për proceset vijuese dhe garanton saktësinë e të dhënave. Të dhënat që administrohen nga regjistrin elektronik (informacioni mbi subjektet tatimpagues që popullohen në regjistrin elektronik), shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat e nivelit të dytë apo QKB), përgatitjen e pasqyrave financiare apo gjenerimin e raporteve për Kryetarin e Bashkisë dhe Këshillin e Bashkisë Selenicë.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Neni 42 Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare
1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjëse për arkivimin, ruajtjen e administrimin e dokumenteve financiare dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat.

- Auditimi i "Regjistrit Elektronik" për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", vlerësohet i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky regjistër administron të dhëna për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", në nivel lokal. Siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë të dhëna, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.
Siguria e informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Bazuar për sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e

programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: "*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria".*

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve dhe mos zbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që i shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin, për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010*, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të këtij ligji përcaktojnë kuadrin rregullator që shërben për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet e njësive publike, janë të përshtatshme dhe efektive, për të ofruar shërbime publike dhe për të adresuar risqet me efikasitet dhe efektshmëri. Objektivat e auditimit janë të sigurohet se njësia publike:

- Funksionon në përputhje me legjislacionin dhe aktet e brendshme;
- Siguron informacione operative dhe financiare të besueshme dhe të plota;
- Mbron informacionin dhe aktivet e saj.

Konstatim:

- Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk është miratuar Rregullorja e brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Selenicë, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 13, datë 25.06.2025 *"Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së regjistrit të personave fizik dhe juridik që kanë detyrimi për të paguar taksat dhe tarifat vendore ..."* , dhe rrjedhimisht nuk janë parashikuar aspektet e gjenerimit /printimit dhe arkivimit të të dhënave periodike e vjetore mbi tatimpaguesit e Bashkisë.

-Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në DAPPLL dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues dhe nuk ka një dokumentim të veçantë (procesverbal) për kryerjen e këtij procesi për ndarjen e aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, si dhe mbikëqyrjen për saktësinë e hedhjes së të dhënave në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar dhe Manualit të MFK.

- Nuk ka përcaktime në rregulloren e brendshme të organizimit të Bashkisë apo në rregullore specifike mënyra e krijimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së regjistrit elektronik mbi afatet dhe mënyrën e rakordimit të të dhënave të këtij regjistri me strukturat e brendshme dhe të jashtme dhe si dokumentohet çdo përditësim i tij, në funksion të saktësisë dhe ruajtjes së gjurmës së auditimit të këtij procesi.

Sa më sipër, në mospërputhje me përcaktimet e nenin 5 pika "iv", të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar përcaktohet se

"Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak përcakton: iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore."

- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e saktësisë së procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat

format *Microsoft Excel* dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.

-Në lidhje me hartimin dhe miratimin e Paketës Fiskale.

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Selenicë për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr**.** 43, date 27.11.2024 "*Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2025"*, konfirmuar nga Prefektura Vlorë me nr. 1087/1 prot, datë 16.122024.

Në këtë dokument janë përcaktuar afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës është pjesë integrale e paketës fiskale, si një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Bashkiak. Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Sa më sipër, në pajtueshmëri me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, germa "c", ku përcaktohet që: *"Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".*

Konstatim: Mungon hartimi dhe miratimi nga Kryetari i Bashkisë i gjurmës së auditimit ku përcaktohen qartë hapat qe ndiqen në veprimtarinë menaxheriale të Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, ku të përfshihen aspektet e hartimit të paketës fiskale, ndjekja dhe arkëtimi i detyrimeve vjetore dhe borxheve tatimore vendore të mbartura, procedurat e rakordimit të brendshëm midis DTAPPLL dhe NJA-ve, rakordimi periodik e vjetor me agjentët tatimorë, monitorimi i indikatorëve fiskalë dhe raportimi periodik në strukturat e vetëqeverisjes vendore (raportimi tek Kryetari i Bashkisë dhe në Këshillin Bashkiak).

Sa më sipër, rezultoi se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë publike, si një dokument *i unifikuar* për të gjitha proceset e kësaj Drejtorie, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit" i ndryshuar, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.4, dt. 26.01.2024 (Kapitulli III, paragrafi 3.3.2); Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar, neni 121 e 122.

B. Rakordimi midis DAPPLL dhe DSHFAP të Bashkisë Selenicë

Rakordimi analitik vjetor, i dokumentuar i të ardhurave të periudhës 1 Janar -31 Dhjetor 2025 është bërë duke nënshkruar NZ për vitin 2025 znj. S.D, Kryetari i Bashkisë z.N.B, si dhe konfirmuar nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit Vlorë, specialistja e të ardhurave zj.M.B; *(mungon në akt rakordim nënshkrimi i përfaqësuesit të Sektorit të të Ardhurave, Pronave, Lejeve dhe Licencave).*

Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit përdor për veprimtarinë e saj evidencën e vënë në dispozicion nga DAPPL&L, e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin *Excel* i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor (me të dhëna mbi informacionin historik të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese) si dhe nga informacionet që paraqesin drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit kryhet manualisht.

Konstatim:
-Mungon rakordimi me kundërfirmmim i të ardhurave midis DSHFAP dhe DAPPLL apo dërgimi shkresor i të ardhurave vjetore nga kjo e fundit tek drejtoria përgjegjëse për financat vendore në këtë bashki.
-Nuk ka një proces rakordimi të mbajtur nga DAPPLL me NJA mbi të dhënat e ngarkuar nga ana e NJA-të për ngarkesën tatimore dhe likuidimet e kryera (shiko NJA Vllahinë).
Këto veprime ***janë në mospërputhje*** me përcaktimet e dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika "ç"; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, *"Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar etj.

2.Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Selenicë janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjithë njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat e regjistrave të taksapaguesve, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
Nga të dhënat e paraqitura rezultoi se për periudhën objekt auditimi, 319 subjekte biznesi që kanë ushtruar aktivitet në fillim të vitit dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, siç paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.15: Evidenca e *subjekteve që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore* *Në numër*

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël					
		2024	262	14	-	276
		2025	276	34	16	294
2	Biznesi Madh					
		2024	43	-	-	43
		2025	43	3	-	46
(1+2)	Gjithsej					
		2024	305	14		319
		2025	319	37	16	324

Burimi: Bashkia Selenicë, DAPPLL

- ***A. Analiza e realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore), Plan-Fakt për periudhën objekt auditimi, 01.01.2025 deri më 31.12.2025 konfirmuar nga Dega e Thesarit Vlorë, sipas pasqyrës:***

Tabela nr.16: Realizimi dhe planifikimi i të ardhurave vjetore 2025 *Në lekë*

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	b	4	5	6			9
I	**Te ardhura nga Tatimet**				**50,000**	**51,087**	102%
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin		210.000		50,000	51,087	

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	b	4	5	6			9
II	**Te ardhura nga Taksat**				**71,935,000**	**52,087,065**	**72.4%**
2	Taksa mbi B. Vogël (hoteli)				40,000	57,760	
3	Taksa e Pasurisë, ndërtese	7.260.900	3.483.636	48%	*7,400,000*	*3,215,441*	
4	Taksa mbi token Bujqësore	42.241.000	28.223.442	66%	43,000,000	28,495,750	
5	Takse mbi regj e Automjete	5.500.000	6.778.208	115%	7,000,000	7,994,833	
6	Taksa e ndiko infr nga ndërtimet e reja dhe mjetet.	2450000	2728091	110%	8,960,000	7,275,285	
7	Takse Tabele (reklame)	130000	42100	32%	140,000	77,825	
8	Takse e ndik ne infr. nga mjetet	5.000.000	8.942.183		-	-	
9	Takse Parkimi	380.000	93.800	25%	380,000	23,000	
10	Takse për hapësira publike	115.000	142.980	120%	115,000	130,570	
11	Takse Trualli	4.858.000	3.646.237	75%	4,900,000	4,816,601	
III	**Te ardhura nga Tarifat**				**55,428,560**	**39,219,360**	**70.7%**
12	Tarife Pastrimi	13.750.000	10.663.655	76%	14,000,000	7,585,801	
13	Tarifë gjelbërimi	3.989.000	3.192.400	80%	4,000,000	2,824,896	
14	Tarife leje transport.	145.000	320.100	220%	300,000	355,830	
15	Tarife ndotje përmirësim mjedisi	33.898.560	19.164.787	57%	33,898,560	26,117,400	
16	Tarife bashkie	98.000			800,000	8,158	
17	Tarife regj biznes i Ri						
18	Tarife ndriçimi rrugor	312.000	77.100	25%	330,000	104,400	
19	Te ardhura te tjera		35.530		800,000	518,385	
20	Tarife leje për ushtrimi akt ekonomik	1.300.000	748.271	58%	1,300,000	1,704,490	
IV	**Te ardhura te tjera**				**49,656,440**	**30,498,821**	**61.4%**
21	Linjat tokësore		206.750		-	-	
22	Taksa e Pullës		328.000				
23	Qira kullote	4.890.000	4.748.686	97%	4,890,000	4,582,838	
24	Tarifë vaditje	5.750.000	4.322.830	75%	5,750,000	3,972,570	
25	Renta Minerare	6.000.000	8.392.627	115%	6,000,000	3,676,005	
26	Gjoba.	50.000	19.500	39%	50,000	286,370	
27	Autorizime	50.000	400.000		-		
28	TAP	6.0000..00	6902.569	140%	6,000,000	6,889,220	
29	Kamatëvonesat		109.674			3,290	
30	Te ardhura nga Debitorët	19.574.540	4.270..774	22%	25,838,440	10,630,028	
31	ALUIZNI	600.000			600,000	-	
32	Tarife Leje Ndërtimi				500,000	452,500	
33	**Tarife Zjarrfikëse**					6,000	
34	Tarifë therje bagëtie	28.000			28,000	-	
	GJITHSEJ (I+II+II+ IV)	**164,370,000**	**118,193,930**		**177,070,000**	**121,856,333**	**68.8 %**

Burimi: DTAPPLL Bashkia Selenicë

Për vitin 2025, kanë ushtruar aktivitet mesatarisht 324 subjekte *(294 subjekte të biznesit të vogël, 46 subjekte të BM).*

- Sipas Vendimit KB Selenicë nr. 54, datë 26/12/2024 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe buxhetit dhe nr. e punonjësve dhe dokumentin përfundimtar të BA 2025-2027", plani i të ardhurave totale nga burimet e veta vendore* për vitin 2025 është *parashikuar* në shumën plan 249,047 mijë.
- Referuar VKB nr.22, datë 31.3.2026 "Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2025", të ardhurat e veta nga 249,047,120 lekë të programuara , *janë realizuar vetëm për* 96,580 mijë lekë ose 39% tyre.

Struktura e të ardhurave faktike: Në të ardhurat nga burimet e veta vendor**e** përfshihen 1.të *ardhurat nga taksat vendore, 2.nga taksat e ndara, 3.të ardhurat nga tarifat vendore dhe 4.të ardhurat nga burime të tjera.*

Në strukturë, të ardhurat e veta të realizuara gjatë vitit 2025, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat vendore me 42.7 %; të ardhurat nga tarifat vendore me 32.%; dhe të ardhurat e tjera me 25% të totalit

Niveli i realizimit vjetor të të ardhurave: Për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 177,070 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 121,856 mijë lekë, ose 68.8 % e planit vjetor. Mosrealizimi kundrejt planifikimit të të ardhurave buxhetore vendore rezulton në vlerën -55,214 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2024, kur të ardhurat e realizuara ishin 118,194 mijë lekë, realizimi i vitit 2025 rezulton me një rritje prej 3,662 mijë lekësh, ose 3.1 % më shumë.

Në formë të përmbledhur, të ardhurat gjithsej janë realizuar 68.8 %, nga këto: të ardhurat nga taksat realizuar 72.4%, të ardhurat nga tarifat janë realizuar **70.7%** dhe të ardhurat e tjera **61.4%**:

Tabela nr.17, Tregues të performancës së të ardhurave vendore

Treguesi	Fakt 2024 (lekë)	Plan 2025 (lekë)	Fakt 2025 (lekë)	Fakt 2025 / Plan 2025 (në %)	Fakt 2025 / Fakt 2024 (në %)
Gjithsej të ardhura	118,193,930	177,070,000	121,856,333	68.8%	103.1%

Burimi: DTAPPLL Bashkia Selenicë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi rezultoi se,

- ***për vitin 2024*** planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është: në masën 164,370,000 lekë ndërsa realizimi 118,193,930 lek, ose në nivelin 72%, ku ka rezultuar diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën - 46,176,070 lekë[5].
- ***Për vitin 2025,*** planifikimi i taksave dhe tarifave vendore është 177,070,000 lekë, ndërsa realizimi 121,856,333 lek, ose në nivelin 68.8%, ku ka rezultuar diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën - 55,213,667 lekë.

Konstatim*:*

a. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezultoi se, *niveli i realizimit të të ardhurave vjetore ka ardhur në rënie nga 72% në vitin 2024, në 68.8% në vitin 2025, ndërkohë që vlera e mosrealizimit është rritur me 9,037,597 lekë (nga 55,213,667 lekë në v.2025 – 46,176,070 lekë mosrealizim për vitin 2024).*

Planifikimi i të ardhurave duhet të mbështetet në analiza realiste të potencialit fiskal, të dhënat historike të arkëtimeve, bazën e tatimpaguesve dhe faktorët ekonomikë që ndikojnë në mbledhjen e të ardhurave, me qëllim sigurimin e një planifikimi të saktë dhe të realizueshëm.

Si pasojë e mosrealizimit të të ardhurave krijohen devijime midis planifikimit dhe realizimit të buxhetit, ndikohet negativisht financimi i shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara dhe ulet besueshmëria e procesit të planifikimit buxhetor dhe e projeksioneve financiare të njësisë vendore. *Nga sa më sipër, del se për dy vite radhazi, planifikimi i të ardhurave rezulton i pa studiuar dhe i mbivlerësuar, pasi realizimi mbetet nën 73% të planit, ndërsa diferenca e mosrealizimit është në rritje nga një vit në tjetrin. Kjo tregon mangësi në procesin e planifikimit buxhetor dhe në administrimin e mbledhjes së të ardhurave.*

b. Për sa i përket planifikimit të të ardhurave, *nuk ka një analizë paraprake bazuar në paketën fiskale të miratuar dhe bazës së taksës për çdo tarifë dhe taksë duke i analizuar një për një dhe kryesisht taksën e tokës, banesës, truallit, tabelës, ndikimit në infrastrukturë,* etj.

[5] -Referuar Raporti i Auditimit të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.44, datë 05.03.2026 të Kryetarit të KLSH-së.

Në planifikim mungon një analize e hollësishme duke marrë për bazë realizimet e vitit paraardhës dhe politikat ekonomike për vitin që vjen në ulje apo rritje taksash dhe tarifash njëkohësisht në planifikim për vitin ushtrimor nuk janë me zëra të veçantë të ardhurat nga debitorët e viteve të mëparshme. Nga ana e strukturave të Bashkisë nuk është parë hartimi i paketës fiskale si një proces qe vazhdon gjatë gjithë vitit ushtrimor për të planifikuar të ardhurat për vitin pasardhës.
Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore rezultoi se, *niveli i realizimit* të të ardhurave *vjetore ka ardhur në rënie nga 72% në vitin 2024, në 68.8% në vitin 2025, ndërkohë që vlera e mosrealizimit është rritur me 9,037,597 lekë (nga 55,213,667 lekë në v.2025 – 46,176,070 lekë mosrealizim për vitin 2024).*

Grafiku nr. 2, Të ardhurat vjetore 2024 dhe 2025 (plan dhe realizim), Bashkia Selenicë



Burimi: Të dhënat Bashkia Selenicë.

Analiza e treguesve të performancës sipas tabelës së mësipërme evidenton se në Bashkinë Selenicë,

- ✓ Realizimi i planit të të *ardhurave vjetore gjithsej*, sipas treguesve të rakorduar me DTH Vlorë është 68.8% = (121,856,333 / 177,070,000 × 100);
- ✓ Diferenca ndaj planit ose mosrealizimi i të ardhurave të miratuara dhe programuara në kuadër të buxhetit vjetor dhe paketës fiskale është për -55,213,667 lekë =(121,856,333 − 177,070,000), ose 32 % e panit vjetor të miratuar për vitin 2025.
- ✓ Realizimi i vitit 2025 ndaj v.2024 është me një rritje prej + 3.1%, ose nivel realizimi 103.1 % = (121,856,333 / 118,193,930 × 100). Kjo rritja në vlerë ndërmjet faktit të dy viteve të analizuara nga grupi i auditimit është + 3,662,403 lekë.

Për vitin 2025, niveli i realizimit të të ardhurave në vlerën 121,856 mijë lekë është ndikuar nga rritja e arkëtimeve në disa zëra, si taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi regjistrimin e automjeteve, taksa për hapësirë publike, tarifat për ushtrimin e aktivitetit ekonomik , tatim mbi të ardhurat personale etj. Megjithatë, mosrealizimi i planit lidhet kryesisht me performancën më të ulët në disa tarifa dhe taksa vendore, duke bërë që realizimi total të mbetet nën nivelin e planifikuar.
Në përfundim, megjithëse të ardhurat e veta kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraardhës, niveli i realizimit prej 68.8% ndaj planit shpjegon nevojën për forcimin e masave administrative dhe përmirësimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në lidhje me mbledhjen e të ardhurave vendore, me qëllim rritjen e eficiencës fiskale dhe përmbushjen e objektivave buxhetore të Bashkisë Selenicë.
Sa më sipër, në kundërshtim me Nenin 42 Administrimi i mjeteve monetare *i ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" që përcakton se:*
1. Të ardhurat e miratuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për buxhetin vjetor përbëjnë kufirin minimal për t'u arkëtuar gjatë vitit buxhetor. 2. Kryetari i njësisë së

vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore. 3. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara në sistemin e thesarit në emër të njësisë së vetëqeverisjes vendore transferohen me bazë ditore në llogarinë unike të thesarit pranë Bankës së Shqipërisë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin nga sistemi i thesarit informacion bankar ditor dhe raport mujor për të gjitha të ardhurat e mbledhura, sipas klasifikimit buxhetor në fuqi. 4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësime sistematike për të identifikuar risqet dhe marrin masa për të shmangur evazionin fiskal.

Konstatim: Nuk janë llogaritur kamatëvonesat për detyrimet tatimore të papaguara në afat për çdo ditë vonesë, si dhe nuk rezulton të jetë regjistruar si një zë me vete pagesa për detyrimet e viteve të mëparshme, duke justifikuar me mungesën e një programi kompjuterik për administrimin e të ardhurave tatimore. Për të gjithë subjektet debitore nga ana e Bashkisë Selenicë **nuk janë zbatuar** përcaktimet e ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në R.SH"* neni 114 *"Mospagimi ne afat i detyrimit tatimor",* duke aplikuar gjobe te barabarte me 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës nuk është kryer pagesa, **por jo për një periudhë më të gjatë se 365 dite kalendarike.**

Në të gjitha rastet, arkëtimi i shumave të detyrimeve përtej afatit ligjor, nuk është shoqëruar me kamatë vonesë, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, që përcakton se,

Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj.

pikën 1, të nenit 114 ***"****Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit"*, sipas të cilit:

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Bazuar në të dhënat e administruara nga DAPPLL, janë aplikuar sanksione ndaj subjekteve të biznesit për mos pagimin e detyrimeve në afat *(sipas regjistrit themelor)*, ***vetëm në 6 raste dhe në vlerën 3,097,409 lekë dhe 8,300 Euro është pjesa e sanksioneve të aplikuara për vitin 2025,*** kurse për periudhën dy vjeçare 2024-2025 në shumën 16,701,124 lekë dhe 8,300 euro.

Tabela nr.18, Lista e subjekteve me sanksione e aplikuara për mos pagimin e detyrimeve në afat

Nr.	Subjekti tatimpagues	Nr. Prot	Data	Vlera (ne leke)	(EURO)
1.	B.c	1334	03/09/2024	2820000	
2.	Z.Shpk	1823	03/09/2024	2700000	
3.	A.I	1794	30/08/2024	172800	
4.	DnD I	1677	07/08/2024	370000	
5.	A.I	1733	18/08/2024	370000	
6.	E.Shpk	1862	10/09/2024	261415	
7.	S. B Sh.a	1820	03/09/2024	3783500	
8.	M.B	1824	03/09/2024	3126000	
9.	S.H	1783	21/7/2025	30740	
10.	M. H	1750	17.07.2025	282909	
11.	D.I	1751	17/07/2025	1143810	
12.	S. B Sh.a	1992/10	27/10/2025	1269950	
13.	S.B Sh.a	2326	02/10/2025		8300
14.	D&D I	170	22/01/2025	370000	
	Shuma			16,701,124	8,300

Burimi: Bashkia Selenicë, DAPPL&L

Analiza e të ardhurave sipas kategorive.

- ***I. Të ardhurat nga taksat vendore*** janë realizuar në masën 72.4 % kundrejt planit *(realizuar* 52,087 *mijë lekë nga* 71,935 *mijë lekë të planifikuar);* dhe 96%, në krahasim me vitin e mëparshëm. Mosrealizimi në krahasim me planin arsyetohet kryesisht, nga taksa e ndikimit ne infrastrukturë, (me nivel realizimi 66 % dhe mosrealizim në masë absolute prej 14,504 mijë lekë); taksa e pasurisë realizuar 43 % me nivel mosrealizimi prej -4,184 mijë lekë; taksa e tokës bujqësore (me nivel realizimi 66 % dhe mosrealizim në masë absolute prej -14,504 mijë lekë); dhe taksa e tabelës (me nivel realizimi 66 % dhe mosrealizim në masë absolute prej 14,504 mijë lekë); taksa e parkimit realizuar 6 %, etj.. Krahasuar me vitin 2024 ku realizimi nga të ardhurat nga taksat lokale ishte 54,080 mijë lekë, rezultojnë -1,993 mijë lekë më pak të realizuara, si vijon:

Tabela nr.19, Të ardhurat nga taksat vendore 2024-2025

	Lloji i Taksës	**Plan 2024**	**Realizim 2024**	**%**	**Plan 2025**	**Realizim 2025**	**%**
II	**Te ardhura nga Taksat**		**54,080,677**		**71,935,000**	**52,087,065**	**72.4%**
2	Taksa mbi B. Vogël (hoteli)				40,000	57,760	
3	Taksa e Pasurisë, ndërtese	7,260,900	3,483,636	48%	*7,400,000*	*3,215,441*	***43***
4	Taksa mbi token Bujqësore	42,241,000	28,223,442	66%	43,000,000	28,495,750	66%
5	Takse mbi regj e Automjete	5,500,000	6,778,208	115%	7,000,000	7,994,833	
6	Taksa e ndiko infr nga ndërtimet e reja dhe mjetet.	2450000	2,728,091	110%	8,960,000	7,275,285	81
7	Takse Tabele (reklame)	130000	42,100	32%	140,000	77,825	
8	Takse e ndik ne infr. nga mjetet	5.000.000	8,942,183		-	-	
9	Takse Parkimi	380.000	93,800	25%	380,000	23,000	6%
10	Takse për hapësira publike	115.000	142,980	120%	115,000	130,570	
11	Takse Trualli	4.858.000	3,646,237	75%	4,900,000	4,816,601	

Burimi: DTAPPLL Bashkia Selenicë

- ***II. Të ardhurat nga tarifat vendore***, rezulton një mosrealizim në krahasim me planin vjetor të miratuar, realizuar 70.7 % e planit vjetor *(realizuar 39,219 mijë lekë nga 55,428 mijë lekë të planifikuar)*. Me konkretisht, evidentohet se plani për këtë kategori është me mos realizim në shumën -16,209 mijë lekë, ndonëse niveli i realizimit është në masën +5.2% më shumë se viti paraardhës 2024. Mosrealizimi vjen nga mos vjelja e tarifave si p.sh. për tarifat e pastrimit (me mosrealizim 45% ose - -6,414 mijë lekë). Gjithashtu mosrealizimi ka në lidhje me tarifën e ndotjes dhe përmirësimit të mjedisit me mosrealizim 23 %; Gjithashtu, mosrealizim ka edhe tek tarifat e gjelbërimit dhe ndriçimit rrugor, të cilat janë realizuar 70% dhe 31.6 %. Në krahasim me vitin 2024 realizimi i kësaj kategorie të të ardhurave nga tarifat vendore është + 5,017 mijë lekë më tepër.

Tabela nr.20, Lista e subjekteve me sanksione e aplikuara

	Lloji i Taksës	**Plan 2024**	**Realizim 2024**	**%**	**Plan 2025**	**Realizim 2025**	**%**
III	**Te ardhura nga Tarifat**	**52,192,560**	**34,201,843**	65.5%	**55,428,560**	**39,219,360**	70.7%
12	Tarife Pastrimi	13,750,000	10,663,655	76%	14,000,000	7,585,801	
13	Tarifë gjelbërimi	3,989,000	3,192,400	80%	4,000,000	2,824,896	
14	Tarife leje transport.	145,000	320,100	220%	300,000	355,830	
15	Tarife ndotje përmirësim mjedisi	33,898,560	19,164,787	57%	33,898,560	26,117,400	
16	Tarife bashkie	98,000			800,000	8,158	
17	Tarife regj biznes i Ri						
18	Tarife ndriçimi rrugor	312,000	77,100	25%	330,000	104,400	
19	Te ardhura te tjera		35,530		800,000	518,385	
20	Tarife leje për ushtrimi akt ekonomik	1,300,000	748,271	58%	1,300,000	1,704,490	

Burimi: DTAPPLL Bashkia Selenicë

- ***III. Të ardhurat e tjera*** në viti 2025 kanë mosrealizim për rreth 38.6 %, *(realizuar 30,498 mijë lekë nga 49,656 mijë lekë të planifikuar).*Në krahasim me vitin 2024 ku realizimi ishte 29,701 mije leke, evidentohet të jenë arkëtuar + 797 mijë lekë më tepër për këtë grup të të ardhurave.

Tabela nr.21, Të ardhurat e tjera vendore 2024-2025

	Lloji i Taksës	**Plan 2024**	**Realizim 2024**	**%**	**Plan 2025**	**Realizim 2025**	**%**
IV	**Te ardhura te tjera**		**29,701,410**		**49,656,440**	**30,498,821**	61.4%
21	Linjat tokësore		206,750		-	-	
22	Taksa e Pullës		328,000				
23	Qira kullote	4,890,000	4,748,686	97%	4,890,000	4,582,838	
24	Tarifë vaditje	5.750.000	4,322,830	75%	5,750,000	3,972,570	
25	Renta Minerare	6.000.000	8,392,627	115%	6,000,000	3,676,005	
26	Gjoba.	50.000	19,500	39%	50,000	286,370	
27	Autorizime	50.000	400,000		-		
28	TAP	6.0000..00	6,902,569	140%	6,000,000	6,889,220	
29	Kamatëvonesat		109,674			3,290	
30	Te ardhura nga Debitorët	19.574.540	4,270,774	22%	25,838,440	10,630,028	
31	ALUIZNI	600.000			600,000	-	
32	Tarife Leje Ndërtimi				500,000	452,500	
33	**Tarife Zjarrfikëse**					6,000	
34	Tarifë therje bagëtie	28.000			28,000	-	

Burimi: DTAPPLL Bashkia Selenicë.

4. Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit në fuqi për vitin 2025 nga Bashkia Selenicë miratuar me Vendimin nr. 5, datë 15.05.2020, të Këshillit të Bashkisë ndër të tjera janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së të Ardhurave (Kreu VIII, në nenin 39), ku rregullohet dhe vjelja e të ardhura dhe rakordimet e tyre.

Të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugor), Drejtoria e Doganave, Drejtoria e Doganave Vlorë, Drejtori Rajonale e Tatimeve Vlorë, nuk janë kundërfirrmuar duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor.

Tabela nr.22, *Shkresa mbi informimin e pjesës takuese të Bashkisë,Selenicë sipas agjenteve tatimore*

Agjenti Tatimor	Lloji I Taksës	31.12.2024	31.12.2025
DRSHTRR	Taksa vjetore e mjeteve te përdorura	04.12.2024	12.09.2025
Drejtoria e përgjithshme te Doganave	Taksa e rentës minerare	04.12.2024	12.09.2025
Dogana Vlore-Fier		04.12.2024	12.09.2025
Drejtoria rajonale e tatimpaguesve te mëdhenj	-	18.04.2024	12.09.2025

Burimi: DAPPL&L, Bashkia Selenicë

-Mungon rakordimi me strukturat e Bashkisë dhe agjentet tatimore te ngarkuar me ligj për arkëtimin e detyrimeve tatimore.

-Drejtoria e te Ardhurave Pronave Publike Lejeve dhe Licencave *nuk ka formalizuar dhe miratuar te Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak një model akt-marrëveshje për abonentët familjar, biznesin e vogël, biznesin e madh duke përcaktuar shumen e detyrimit qe duhet te paguaj për marrjen e shërbimit*, njëkohësisht formalizimin dhe miratimin e vërtetimit ne rastin e pagesave te pjesshme duke shmangur keqinterpretimet dhe abuzimet e mundshme.

-Konstatohet se mungon një akt që ngarkon një person në strukturën e DAPPL&L mbi caktimin e një personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen

e akt-rakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët. Kjo detyrë në përshkrimet e punës është caktuar për z.E.F, parashikuar në pikën nr. 6, të Kreut III të përshkrimit të punës.

- *Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura*, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Vlorë, për llogari të Bashkisë Selenicë. Sipas shkresën me nr. 204, datë 09.06.2026 "Relacion shpjegues për rentë minerare dhe KSHA" del se nga procesi i rakordimit për vitin 2025 janë arkëtuar 7,994,833 lekë nga KSHA, në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", të ndryshuar dhe në mbështetje të germës "b", të pikës 2, në nenin 25 "*Të ardhurat nga taksat e ndara*" të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura, si vijon:
Neni 25/2: Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e vetëqeverisjes vendore janë:
a) 97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë;
b) 25 për qind e të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura;
c) 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare;
ç) 2 për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.
3. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës.

- Për vitin 2025 ndërmjet DAPPLL-së Bashkisë Selenicë dhe ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë dhe DR Doganave nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore. Me Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Vlorë është mbajtur vetëm një procedurë e mbledhjes sete dhënave për pjesën e taksave të Bashkisë Selenicë. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë Bashkia Selenicë duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për aplikimin e gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë, me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", neni 117 "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave".


- ***Të ardhurat nga renta minerare*** mblidhet nga Agjenti Tatimor DP Doganave dhe DP Tatimeve, referuar përcaktimeve të ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" i ndryshuar:

Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Grupi i auditimit verifikoi në Regjistrin e Lejeve Minerare të Shfrytëzimit (aktive) të administruara nga AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore)[6], dhe *rezultoi se* janë dhënë leje shfrytëzimi minerar në territorin e Bashkisë Selenicë.
- *Nga Bashkia Selenicë rezultoi se nuk bëhen rakordimet mujore për vjeljen e rentës minerare me DPD dhe DPT, por informacioni mbi arkëtimet e saj merret nëpërmjet Degës së Thesarit.*
-Për vitin 2025 Bashkia Selenicë nuk ka përfituar pjesën takuese të të ardhura nga renta minerare dhe sipas shkresën me nr. 204, datë 09.06.2026 "Relacion shpjegues për rentë minerare dhe KSHA" pjesa takuese e rentës minerare të përfituar është 3,676,005 lekë.
Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e truallit, të ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksa e tarifa vendore për NJA-të sipas Paketës Fiskale) konstatohet se Bashkia Selenicë nuk ka lidhur marrëveshje me P Sh-sha dhe OSHEE për të luajtur rolin e agjentit tatimor, në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar .

<u>Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2025</u>
Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave dhe detyrimet, viti 2025
Në fillim të vitit 2025 kanë ushtruar aktivitetin e tyre gjithsej 5042 subjekte tatimore, të cilat kategorizohen sipas tabelës së mëposhtme në Biznes i vogël, i vogël me TVSh, i madhe dhe institucionet. Situata e vjeljes së të ardhurave dhe krijimi i borxhit tatimor për vitin 2025 paraqitet si me poshtë;
Konstatim:
Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë marrë masat për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, që në fund të viti 2023 në mënyrë progresive janë në shumën 438,105 mijë lekë, në fund të vitit 2024 janë 446,068 mijë lekë dhe për vitin 2025 progresivisht janë 443,382 mijë lekë. Referuar raportit të auditimit financiar të KLSH-së 452 milionë lekë, si vijon:

Grafik nr.3. Dinamika e të ardhurave, Bashkia Selenicë 2023-2025



Burimi: Bashkia Selenicë, përgatitur nga grupi i auditimit të KLSh-së.

Tabela nr.23, Detyrimet tatimore sipas kategorisë së debitorëve referuar raportit të NJAB i vitit 2025 "Për auditimin në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike Lejeve dhe Licencave vitin ushtrimor 2024".
Në lekë

6http://www.akbn.gov.al

Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit+ndricim+truall+gjlberim	Debitor Biz Vogel	Debitor Biz Madhe	Debitor Aluzni	Totali
1	Qytet Selenice	6,960,495	2,350,463	6,069,483	10,728,102	68,983,784	6,938,019	102,030,346
2	Njësia adminitrative Sevaster	31,593,132	1,124,456	5,202,380	871,323	0		38,791,291
3	Njësia adminitrative Brataj	22,312,551	2,052,870	4,185,305	3,889,882	0		32,440,608
4	Njësia adminitrative Kote	32,220,025	2,773,210	3,109,378	6,905,924	0		45,008,537
5	Njësia Administrative Armen	80,992,209	2,908,339	8,581,300	5,276,798	0		97,758,646
6	Njesia administrative Vllahine	91,542,587	11,178,499	5,421,288	13,936,792	0		122,079,166
								0
								0
Totali		265,620,999	22,387,837	32,569,134	41,608,821	68,983,784	6,938,019	438,108,594

Burimi: Bashkia Selenicë, Raporti NJAB

Për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024, DTAPPLL ka regjistruar në evidencat e saj në Excel treguesin e detyrimeve progresive deri me dt. 31.12.2024 në shumë prej 446,068 mijë lekë, i cili analitikisht sipas NJA-ve dhe kategorive të taksave e tatimeve detajohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.24: Detyrimet tatimore sipas kategorisë së debitorëve sipas të dhënave të DTAPPLL, Bashkia Selenicë,
Në lekë

Detyrimet deri më 31.12.2024								
Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit ndriçim +truall+ gjelbërim	Debitor Biz Vogël	Debitor Biz Madhe	Debitor Aluzni	Totali
1	Qytet Selenice	7,249,815	3,092,171	6,872,880	11,002,122	75,571,361	5,863,955	109,652,304
2	Njësia administrative Sevaster	30,664,240	1,513,259	5,901,120	931,633	0		39,010,252
3	Njësia administrative Brataj	22,205,583	2,662,559	4,326,827	4,049,367	0		33,244,336
4	Njësia administrative Kote	30,783,452	3,670,830	3,459,178	7,130,064	0		45,043,524
5	Njësia Administrative Armen	78,112,907	3,716,731	9,148,080	5,478,748	0		96,456,466
6	Njësia administrative Vllahine	91,470,821	11,367,882	5,647,579	14,175,727	0		122,662,009
Totali		**260,486,818**	**26,023,432**	**35,355,664**	**42,767,661**	**75,571,361**	**5,863,955**	**446,068,891**

Burimi: Bashkia Selenicë, DTAPPLL

Referuar Raportit të "Auditimit Financiar" për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, *(publikuar në Shkurt 2026 në faqen zyrtare të KLSH-së),* treguesi i detyrimeve progresive deri me dt. 31.12.2024 paraqitet 451,852 mijë lekë, (nga 446,068 mijë lekë, përcjellë nga DTAPPLL grupit të auditimit të KLSH-së në këtë angazhim auditimi), me në diferencë prej 5,783,827, me ndikim në bilancin e

çeljes së detyrimeve tatimore për të ardhurat të njësive administrative dhe drejtorisë së të ardhurave në Bashkinë Selenicë për v.2025:

Tabela nr.25, Detyrimet deri më datë 31.12.2024 sipas Drejtorisë së Tatim Taksave *Në lekë*

Detyrimet deri më datë 31.12.2024 sipas Drejtorisë së Tatim Taksave							
Njësitë Administrative	Taksë bujqësore	Taksës ndërtese	Taksë pastrim, ndriçim, truall dhe gjelbërim	Debitorë biznes i vogël	Debitorë biznes i madh	Debitorë ALUIZNI	Totali
Qytet Selenicë	7,261,247	3,109,926	6,892,387	11,002,122	77,921,361	5,863,955	112,050,998
Njësia Administrative Sevaster	30,870,662	1,513,259	6,026,120	931,633	-	-	39,341,674
Njësia Administrative Brataj	22,250,420	4,725,748	4,324,027	4,049,367	-	-	35,349,562
Njësia Administrative Kote	30,959,552	3,675,730	3,456,078	7,130,064	-	-	45,221,424
Njësia Administrative Armen	78,112,907	3,725,619	9,151,780	5,478,748	-	-	96,469,054
Njësia Administrative Vllahine	92,617,566	11,369,632	5,257,081	14,175,727	-	-	123,420,006
Totali	262,072,354	28,119,914	35,107,473	42,767,661	77,921,361	5,863,955	**451,852,718**

Burimi: Raporti KLSH për auditimin financiar, dt. publikimit Shkurt 2026, faqe 38-39

Detyrimet e mbartura dhe progresive për taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë deri në datën 31.12.2025 jepen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 26. Detyrimet e mbartura dhe progresive për taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë deri në datën 31.12.2025 *Të dhënat në lekë*

	Detyrimet	**Me Dt.**		**31.12.2025**				
Nr.	Njësitë Administrative	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e ndërtesës	Taksa e pastrimit, ndriçimit, truallit, gjelbërim	Debitor Biznesi Vogël	Debitor Biznesi Madh	Debitor ALUZNI	Totali
1.	Qytet Selenice	7,633,561	3,680,710	7,724,143	10,730,948	75,243,082	5,709,055	110,721,499
2.	Njësia administrative Sevaster	30,511,750	1,883,577	6,582,920	923,163	-		39,901,410
3.	Njësia administrative Brataj	21,267,417	3,367,313	4,295,377	4,118,567	-		33,048,674
4.	Njësia administrative Kote	27,169,040	4,349,290	3,714,616	7,167,334	-		42,400,280
5.	Njësia Administrative Armen	76,301,991	4,562,725	9,682,743	5,445,448	-		95,992,907

6.	Njësia administrative Vllahine	89,820,533	11,536,971	5,809,330	14,151,331	-		121,318,165
	Totali	**252,704,292**	**29,380,586**	**37,809,129**	**42,536,791**	**75,243,082**	**5,709,055**	**443,382,935**

Burimi: Bashkia Selenicë, DTAPPLL

Gjendja debitore progresive më datë 31.12.2025, është në vlerën 443,382 mijë lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë, ndonëse niveli i këtyre detyrimeve në fund të v.2025 është -2,685 mijë lekë më i ulët se niveli i detyrimeve se data 31.12.2024, ose (443,382,935 - 446,068,891 lekë).

Konstatim:
Referuar relacionit me nr.1623 prot., datë 12.06.2026 të hartuar nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të Bashkisë Selenicë, kanë rezultuar parregullsi në llogaritjen e debisë progresive nga shqyrtimi i debisë së subjekteve të biznesit të madh (karburantet), sa përfshirë dy herë në debinë progresive shuma prej 2,850 mijë lekë e raportuar në vitin 2023 . *Më konkretisht,*

- Debia progresive e raportuar : 68,983,785 lekë;
- Vlera e debisë së dubluar të subjekteve të tregtimit të karburanteve: 2,850,000 lekë;
- Debia progresive reale pas korrigjimit: 66,133,784 lekë.

Rezultoi se kjo parregullsi nuk i është raportuar dhe bërë me dijeni Kryetarit të Bashkisë Selenicë dhe Këshillit Bashkiak për analizimin e këtyre të dhënave dhe marrjen e masave të nevojshme.

Detyrimet e kategorisë "Popullata" për vitin 2025.
- Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve:

- *Tarifa e pastrimit* parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të Bashkisë. Për këtë, nga DTAPPLL përdoren kontratat e popullatës për furnizimin me energji elektrike sipas OSHEE me përditësimet përkatëse.
- *Taksa e ndërtesës* parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.
- *Tarifa mirëmbajtje vaditje + kullim* aplikohet në qendrën e Bashkisë dhe NJA-të dhe parashikimi bëhet në bazë të sipërfaqes së tokës brenda zonës ku ofrohet ky shërbim.

Në lidhje me kategorinë e *debitorëve familjarë të regjistruara si tatimpagues* në territorin e Bashkisë Selenicë për vitin 2025 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme dhe ka këtë trend pagesash dhe detyrimesh për taksat dhe tarifat vendore, si në tabelën e më poshtme:
Sa më sipër, vlera e detyrimeve të *debitorëve familjarë për vitin 2025* së bashku me borxhin e trashëguar paraqitet në vijim:
Për të gjithë subjektet debitore nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në R.SH"* neni 114 *"Mospagimi ne afat i detyrimit tatimor",* duke aplikuar gjobe te barabarte me 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës nuk është kryer pagesa, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 dite kalendarike.

Konstatim: Nga auditimi i borxheve dhe detyrimeve vjetore për taksat dhe tatimet vjetore në Bashkinë Selenicë për vitin 2025 rezultoi se: Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronës Publike,

Lejeve e Licencave nuk janë dërguar me shkresë zyrtare tek Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit detyrimet debitorë vjetore dhe progresive me qëllim kontabilizimin dhe njohjen e tyre në kontabilitet në llog. 468 dhe në llogarit1 e klasën e 7-të.
Bazuar nëtë dhënat e Drejtorisë së Të Ardhurave, Vlera totale e detyrimeve debitorë për të tokës bujqësore dhe debitorëve të biznesit dhe familjarë janë kontabilizuar në shumën prej **443,382,935 lekë** kurse në llogaridhënie vjetore te vitit 2025 detyrimet e popullatës në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm'" totali është **236,324,467 lek**ë, ose rezulton të **mos jenë kontabilizuar si detyrime shuma prej -207,058,468 lekë**, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 27: *Llog 468 "Debitorë te ndryshëm" në PFV 2025:*

468	*Debitorë te ndryshëm*	236,324,467	236,324,467

Burimi Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Arkivë Protokollit

Veprimet dhe mosveprimet mbi mosarkërtimin e plotë të të ardhurave janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Kreu VII "Kontabiliteti i sistemit buxhetor"); Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*, si dhe dispozita të tjera rregulluese e urdhëruese të lëshuara nga ana e Ministrisë së Financave.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:
Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për bashkinë Selenicë nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore. Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.
Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nëpërmjet kryepleqve dhe pleqësive të fshatrave.
Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashkinë Selenicë kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare.
Drejtoria e të Ardhurave nuk ka kryer analiza periodike e vjetore (të dokumentuar), nuk ka kryer analizën e te Ardhurave për vitin 2025 ne total dhe analitike për çdo zë taks /tarife, analizën e taksave dhe taksave ndonëse sipas shkresës me nr.2301 prot, datë 01.10.2025 të nënshkruar nga Zv/kryetari i Bashkisë Selenicë zj. S.I është kërkuar raportimi periodik (mujor) mbi ecurinë e njoftimit të subjekteve tatimpaguese dhe arkëtimit të detyrimeve tatimore tek Kryetari.

Konstatim: Në lidhje me këtë situatë DAPPLL-ja për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, *por nuk është ngritur padi gjyqësore dhe nuk është kërkuar në rrugë ligjore,* në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve**".**

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që:
"Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit",
Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

- ***Legalizimi dhe taksa e ndikimit ne infrastrukture***

Nga auditimi rezultoi se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Selenicë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatësisht nuk kanë paguar ende detyrimin 219 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara për periudhën 2019-2025 (të dhënat deri më 31.12.2024), me vlerë totale 5,709,055 lekë. *Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në* 5,709,055 *lekë për objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Selenicë.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5 si dhe VKB-së nr. 43, datë 27.11.2024 *"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Selenicë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2025".*

- ***Mbi pagesën e autorizimit nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse. Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.***

Grupi i auditimit të KLSH-së auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:
- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre",* neni 4, neni 20, pika 2.
- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", pika 2/9: "*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera*".
Referuar dokumentacionit të paraqitur rezultoi se, në territorin e Bashkisë Selenicë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 (gjashtë) subjekte, që kanë detyrimet vjetore dhe progresive të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.28. *Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë*

nr	Emri I subjekti	Aktivitet	Debia progresiv 24	Autorizim	Faturim 2025	Arkëtim 2025	Arkëtim debitor	Total I arkëtuar 25	Debia e 2025	Debi prog 2025
1	D.Gj.	Karb Vllahinë	400,000	400000	100,000	100,000		100000	0	300,000

2	P.Shpk	Karb Kote	400,000	400000	100,000	100,000		100000	0	300,000
3	X.G.	Karb/Vllahinë	500,000	500,000	200,000	100,000		100,000	100,000	400,000
4	T.O.	Karb Peshkëpi	400000	400000	200000	200000		200000	0	200,000
5	M.O.	Karb Selenicë	750000	750000	200000	50000		50,000	150,000	700,000
6	M shpk	Karburant/ Kotë	600000	600000	200000			0	200,000	600,000
			3,050,000	3,050,000	1,000,000	550,000	0	550,000	450,000	**2,500,000**

Burimi: Bashkia Selenicë, DTAPPLL

Nga auditimi rezultoi se, në Bashkinë Selenicë për vitin 2025 janë Subjektet "P SHPK", "D.G SHPK", "T.O" shpk, "M" shpk dhe "M" shpk janë pajisur me autorizim/licencë dhe me ato është lidhur akt marrëveshje për pagesën e detyrimit për autorizimin me këste. *Në fund të vitit 2025 debia progresive e pa arkëtuar për 6 subjektet e pajisura me autorizim dhe që ushtrojnë aktivitet në tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse/në fushën e hidrokarbureve është 2,500 mijë lekë.*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi,

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 4:

"*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*", neni 15 *"…Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji…",* neni 20-Autorizimet pika 2, "*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[7]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*";

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", Kreu II, pika 3 "*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*".

Kjo ka sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Selenicë dhe ka ardhur nga puna e pamjaftueshme e DAPPLL në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

-Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për taksat e tokës bujqësore:

Nga auditimi konstatohet se baza e taksës kryesisht për tokën bujqësore, banesën dhe truallin nuk vërtetohet me dokumentacion ligjor. Të dhënat që administrohen për taksat e familjarëve në NJA-të e Bashkisë janë të mbartura nga ish Komunat para reformës territoriale sot Njësi Administrative në vartësi te Bashkisë Selenicë. Toka Bujqësore duhet të taksohet sipas *kategorisë së produktivitetit ose Bonitetit* [8] të saj. Njësitë administrative kane llogaritur taksen për token

[7]- Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, neni 11- Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".

[8] - ***Boniteti i tokës bujqësore*** *është një tregues që përdoret për të vlerësuar cilësinë dhe pjellorinë e tokës, pra sa e përshtatshme është ajo për prodhim bujqësor. Në vlerësimin e klasave të bonitetit të tokës merren parasysh faktorë të tillë si: Pjelloria natyrore e tokës, Përmbajtja e lëndëve ushqyese., Thellësia e shtresës së punueshme, Struktura dhe tekstura e tokës, Mundësia e ujitjes dhe kullimit, Pjerrësia e terrenit, Kushtet klimatike të zonës. Në praktikë, tokat tokë me bonitet të lartë jep rendimente më të mira dhe zakonisht ka vlerë ekonomike më të madhe .*

bujqësore për kategori të ndryshme kryesisht sipas fshatrave dhe në përgjithësi sipas pjellorisë e cila konstatohet edhe nga ana vizuale por nga auditimi i kryer nuk ekziston një dokument ligjor apo studim i kryer mbi nivelin e bonitetit, i miratuar nga Këshilli Bashkiak për përcaktimin e kategorisë së tokës për efekt të përllogaritjes së nivelit të taksës. Gjithashtu të dhënat e taksës së tokës sipas regjistrave në formatin Excel janë të mbartura nga ish komunat dhe nuk janë vërtetuar faktikisht. Inspektorët tatimorë në Njësitë Administrative nuk disponojnë të dhëna statistikore sa sipërfaqe toke taksohet për çdo kategori te parashikuar, etj. Konstatohet se Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka marrë masa për përditësim të plotë të të dhënave.

- ***Komisioni i Apelimit Administrativ të Taksave dhe Tatimeve Vendore (KATTV):***

Nga ana e Bashkisë Selenicë është ngritur Komisioni i Apelimit Tatimor që nuk është përfshirë si pjesë e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Bashkisë, e cila shërben për apelim të akteve vendore që lidhen me taksat dhe tarifat vendore.
Bashkia Selenicë ka ngritur Komisionin e Apelimit Administrativ Tatimor për vitin 2025" me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.12, datë 29.01.2025, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 7 i tij, që përcakton se:
"Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor, kundër vendimit apo veprimit të zyrës së taksave, bëhet te struktura vendore e apelimit tatimor, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të strukturës së apelimit tatimor në bashki"
si dhe në Nenin 22/5 "Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore" të po këtij ligji:
Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme: *d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve."*

Tabela nr.29 : KAT për periudhën 01.01.2025 - 31.12.2025 është i përbërë si më poshtë vijon:

Nr	Emri	Mbiemri	Formimi profesional/arsimor
1	A	S	Kryetar Komisioni/
2	E	F	anëtar
3	K	Xh	anëtar

Burimi: Bashkia Selenicë

Nga auditimi *rezultoi se* gjatë vitit 2025, nuk ka patur raste të ankimeve nga subjekte apo familjarë, lidhur me detyrimet tatimore ndaj Bashkisë Selenicë.
Konstatim: Përfshirja e Drejtorit të Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë në drejtimin e Komisionit të Apelimit Tatimor është veprim në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V "Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm", Neni 17 "Kufizimet në veprimtarinë e audituesve të brendshëm" dhe Neni 14 "Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm " të ligjit nr. 114/2015, datë22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm" i ndryshuar:
Audituesve të brendshëm u ndalohet: a) të përfshihen në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarive të tjera të njësisë publike, përveç veprimtarisë audituese; b) të mbajnë një mandat politik apo të jenë zgjedhur në funksione drejtuese në strukturat e partive politike; c) të ushtrojnë çdo veprimtari ose punë tjetër me pagesë apo të kenë përfitime të tjera të natyrave dhe formave, që krijojnë gjendje konflikti interesash me ushtrimin e auditimit, me përjashtim të mësimdhënies dhe publikimit, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

Dhe Neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm “
Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për: a) organizimin e angazhimeve të auditimit të brendshëm, hartimin e Kartës së Auditimit sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me nenin 8 të këtij ligji; b) shfuqizohet; c) hartimin dhe zbatimin e planit strategjik e vjetor për veprimtarinë e auditimit të brendshëm dhe dërgimin për informacion në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, pas miratimit nga titullari i njësisë publike; c/1) miratimin e raporteve të angazhimeve të auditimit të brendshëm, pas konsultimit me njësinë publike të audituar për gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat i dorëzohen për përdorim të brendshëm titullarit të njësisë publike. ç) përgatitjen e raportit vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm dhe përmban të dhënat e mëposhtme, por nuk kufizohet vetëm në to: i) angazhimet e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar; ii) shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse; iii) vlerësimin e sistemeve të kontrollit brenda njësisë publike dhe për rekomandimet për përmirësim; iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar; d) shfuqizohet.
Kryetari i Komisionit të Apelimit Tatimor ka për detyrë të shqyrtojë ankesat mbi vendosjen e tatimeve apo heqjen e tyre, të analizojë provat, të marrë vendime administrative si dhe të mbajë përgjegjësi mbi procesin e apelimit tatimor. Sa më sipër, ky nuk është një rol këshillimor apo teknik. Është një rol vendimmarrës**.**
Referuar Standardeve Globale të IIA, ky veprim konsiderohet si cenim i pavarësisë dhe objektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm**,** veçanërisht nëse drejtuesi i NJAB (Njësisë së Auditimit të Brendshëm) do të marrë një rol vendimmarrës në administrimin e një procesi që më vonë mund të jetë objekt auditimi. Caktimi nga titullari i Bashkisë i Drejtorit të DAB në drejtimin e KAT është përfshirje në funksione operative/vendimmarrëse, të cilat nuk janë në përputhje me rolin e shërbimit të auditimit të brendshëm. Kjo situatë mund të krijojë *Riskun e auditimit*, nëse NJAB duhet të auditojë më vonë procesin e administrimit të të ardhurave vendore, trajtimin e ankesave tatimore apo funksionimin e komisionit.
Caktimi i drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm si kryetar i Komisionit të Apelimit Tatimor nuk është në përputhje me parimet e pavarësisë, objektivitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit të parashikuara nga Standardet Globale të IIA dhe nga ligji nr. 114/2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* pasi ky funksion përbën një përgjegjësi operative dhe vendimmarrëse që mund të dëmtojë pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N.B, Kryetar i Bashkisë Selenicë, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe z. E.F me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Të Ardhurave, Pronave publike, lejeve e licencave.

3.Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.
Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare:
Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Kreu VII “Kontabiliteti i sistemit buxhetor”); Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 “*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore*

të buxhetit për vitin 2025", si dhe dispozita të tjera rregulluese e urdhëruese të lëshuara nga ana e Ministrisë së Financave.

Hartimi i pasqyrave financiare:
Për vitin 2025 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare si më poshtë:
- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar *(bilanci);*
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve *(Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);*
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare; *(Cash Flow).*
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata *(kosto historike).*Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata *(vlera neto).*
- Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:
Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Bashkisë Selenicë për vitin ushtrimor 2025 janë të nënshkruara nga znj. S.D me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Arkivë Protokollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe nga ana e të Kryetarit të Bashkisë z. N.B, si NA.
PFV janë depozituar pranë Degës së Thesarit Vlorë me shkresën nr.909 prot., datë 31.03.2026, dhe konfirmuar (nënshkruar e vulosur) nga kjo Degë me nr 491 prot, datë 31.03.2026. Pasqyrat Financiare të gjeneruara nga SIFQ janë konfirmuar zyrtarisht nga Dega e Thesarit Vlorë..
Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore janë të shoqëruara me inventarin e llogarive, me situacionin e shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe aktet e rakordimit, të hartuara mbi realizimin e buxhetit vjetor, dokumente këto të firmosura/konfirmuara nga Dega e Thesarit.
Sa më sipër, nga auditimi në lidhje me përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore për vitin kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor 2025, evidentohet se janë zbatuar afatet e detyrueshme nga ana e institucionit brenda 31 marsit të vitit pasardhës. *Sa më sipër,* vepruar në përputhje me kërkesat e Kreut V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi nr.118, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.
Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit.

Auditimi mbi pagesat e kryera për verifikim të dokumentacionit justifikues.
Nga dokumentet e pagesave të bankës u kërkuan dhe u verifikuan me zgjedhje disa pagesa të kryera gjatë vitit / Urdhër Shpenzime të kaluara në DTH Gjirokastër. Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni justifikues bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit, për praktikat e testuara nga auditimi ishte i plotë. Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së

Financave, të cilat referuar edhe të dhënave të MF, rubrika *"Detyrimet e prapambetura",* sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura.
U krye kontrolli me anë të pjesëve justifikuese në lidhje me ekzistencën e ndonjë gabimi aritmetik, apo regjistrimi kontabël, nëse regjistrimet e bëra korrespondojnë me llogaritë e duhura sipas Nomenklaturës së Planit të Llogarive. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) analizoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar për disa pagesa si:

Tabela nr. 30. Shpenzimet e testuara nga auditimi për plotësinë e dokumentacionit justifikues Në lekë

Ush nr.	Datë pagese	përshkrimi	Vlera në lekë
736	31.12.2025	Kolaudim përmirësim i shtresave te rrugëve te fshatrave	31,844
737	31.12.2025	Kolaudim përmirësim i shtresave te rrugëve te fshatrave FSHZH	33,781
738	31.12.2025	Mbikëqyrje përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetin e varfër	
739	31.12.2025	Kolaudim përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetin e varfër dhe te pa favorizuar	12,027
740	31.12.2025	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetin e varfër dhe te pa favorizuara	9,800,000
741	31.12.2025	Ndërtim terrene sportive Armen,Sevaster Vllahine	2,852,499
742	31.12.2025	Ndërtim terrene sportive Armen,Sevaster Vllahine	20,147,301
743	31.12.2025	Rikualifikim urban i pallateve ne hyrje	20,469,146
744	31.12.2025	Mbikëqyrje punimesh Kuz Mesarak	448,118
745	31.12.2025	Mbikëqyrje rehabilitim e mbrojtje nga përroi Otim	1,151,947
746	31.12.2025	Mbikëqyrje rehabilitim e mbrojtje nga përroi Otim	127,994
747	31.12.2025	Likuidim tatim fitimi 1%	19,229

Burimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkivë Protokollit , Ditari i Bankës 2025.

Bashkëlidhur urdhër-shpenzimit është fatura elektronike e OE; situacioni pjesor, urdhër shpenzimi me objekt "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara"* nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe Kryetari i Bashkisë. Në urdhër shpenzim fondet janë nga kodi 01, llogaria ekonomike 231, kodi programit 6190.

Tabela nr. 31.

572	20.10.2025	Mbikëqyrje rruge te brendshme Kocul	208,440
573	20.10.2025	Mbikëqyrje përmirësimi I shtresave te rrugëve te fshatrave	112,810
574	20.10.2025	Mbikëqyrje shkolla "T. K"	275,505
575	20.10.2025	Mbikëqyrje rruga Karbunarë	502,620
576	22.10.2025	Energji elektrike muaji Shtator	439,186
577	29.10.2025	Vendim gjyqi F.T	264,590
578	29.10.2025	Vendim gjyqi E.R	300,000
579	29.10.2025	Vendim gjyqi P.A	322,930
580	29.10.2025	Vendim gjyqi P.C	300,000
581	29.10.2025	Vendim gjyqi T.A	206,804
583	29.10.2025	Shpërblimi i kryepleqve muaji gusht- shtator 2025	938,400
584	29.10.2025	Shpërblimi i këshilltareve muaji shtator 2026	408,000
585	29.10.2025	Shpërblimi i këshilltareve muaji shtator 2026	20,400
586	29.10.2025	Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetin e varfër dhe te pa favorizuar	1,793,683
587	29.10.2025	Invalidët skema e re tetor 2025	4,057,871
588	29.10.2025	Invalidët skema e vjetër tetor 2025	4,908,363

Burimi: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit , Ditari i Bankës 2025.

Sa më sipër, urdhër shpenzimet kanë bashkëlidhur dokumentacionin justifikues të mjaftueshëm dokumentar sipas parashikimeve të Kreut II, pika 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar,

2.2.Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik

6.Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhër shpenzimi/urdhërpagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*
- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.*
- *Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme.*

dhe të Kreut III, paragrafi 54, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar:
54. Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinale ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si procesverbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, procesverbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj.

Ditarët e mbajtur për regjistrimin e veprimeve kontabile: Nga verifikimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore rezultoi se, janë mbajtur ditarët për regjistrimin e veprimeve kontabile të thesarit, ditari i magazinës, ditari i arkës dhe centralizatori për veprimet përmbledhëse. Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, kuadrojnë si shumë totale (Aktivet gjithsej = Pasivet + Fondet neto); llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, *trajtuar më hollësisht në vijim*. Veprimet kontabile janë azhurnuar periodikisht nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, janë pasqyruar veprimet në ditarë, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.
Sa më sipër, kanë gjetur zbatim përcaktimet e Kreut I, paragrafi 2.2.6, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.
Gjatë auditimit të kryer për periudhën objekt shqyrtimi, konstatohet se mbajtja e llogarive kontabile dhe nxjerrja e bilancit për vitin 2025, është realizuar në mënyrë manuale, duke përdorur programin *"Microsoft Excel".* Ky program i pa certifikuar për mbajtjen e regjistrave financiare, nuk mund të konsiderohet si *"bartës informatik*", sipas përkufizimit të dhënë nga dispozitat e akteve ligjore e nënligjore mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
"Bartës informatik" është çdo dokument kontabël i autorizuar nga organet përkatëse, i shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.
Sipas Kreut 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika nr. 6 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", njësitë e qeverisjes vendore kanë për detyrë të evidentojnë në mënyrë kronologjike dhe të dokumentuar çdo transaksion ekonomik. <u>*Çdo transaksion duhet të mbështetet në bartësit e informacionit kontabël përkatës*</u> (mandate, fletë-hyrje/dalje, ditarë, libra kontabël etj.), në përputhje me sistemin e llogarive buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave.

Në këtë kuadër, Bashkia Selenicë duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, *që garantojnë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.*

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:
Për vitin 2025, nga verifikimi dhe testimi i transaksioneve për çdo muaj, të ditarit kontabël të bankës për shpenzimet sipas natyrës (Klasa 6 dhe Klasa 2) me akt-rakordimin e thesarit mbi bazën e dokumentit të nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj, për shumat në çdo llogari dhe në totalin mujor e vjetor, nuk konstatohen diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës së shpenzimeve, ku janë hedhur autorizimet buxhetore (çeljet) dhe destinacionet e përdorimit të fondeve sipas llojit të shpenzimeve dhe klasave të llogarive.
Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:

- Situacioni i Shpenzimeve Vjetore (me burim nga granti i pakushtëzuar dhe specifik, nga të ardhurat dhe nga granti i kushtëzuar) për vitin 2025, është hartuar dhe ngarkuar në sistem nga ana e Bashkisë Selenicë. Ky situacion është nënshkruar rregullisht nga NA Z.N.B, Kryetar i Bashkisë dhe NZ i njësisë shpenzuese znj. S.D dhe nga nëpunësi i Degës së Thesarit zj.E.K,
- Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Selenicë është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë (NA dh NZ) dhe Degës së Thesarit Vlorë, mbi rakordimin e nivelit të realizimit të ardhurave sipas kategorive vjetore 2025, ku janë evidentuar dhe shumat e të ardhurave që trashëgohen nga viti 2025 në vitin 2026 në PLTH konfirmuar nga specialisti i të ardhurave në DTH Vlorë M. B.
- Është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë Selenicë dhe Degës së Thesarit Vlorë nënshkruar nga Përgjegjëse e Degës së Thesarit Vlorë znj.V.A mbi rakordimin e mjeteve në ruajtje (llogaria 4662104 dhe llog.4660000, në trajtë progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Pra, rezultoi se, për periudhën e audituar, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e kësaj Bashkie janë mbajtur akt rakordimet periodike e vjetore, që janë kundër-firmuar rregullisht për të dhënat nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. *Për sa sipër,* është vepruar në përputhje me përcaktimet e:

- Ligjit nr.9936, date 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 3, pika 4 dhe 6, që parashikojnë se,

4. "Njësi të qeverisjes së përgjithshme" janë tërësia e njësive të qeverisjes qendrore, vetë qeverisjes vendore dhe të fondeve speciale.
6. "Njësi të qeverisjes vendore" janë njësitë e niveleve të ndryshme vendore, të krijuara me ligj, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes vendore, brenda një territori të caktuar.

- ✓ Paragrafit nr.88 dhe 221, të Kreut IV, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, që përcakton se:

88. Nëpunësi zbatues rakordon me strukturën përgjegjëse për thesarin deri në datën 5 të çdo muaji, mbi shpenzimet mujore /progresive që ka kryer njësia e qeverisjes së përgjithshme. Formati i raportit gjenerohet drejtpërdrejt nga SIFQ.

221.Nëpunësi zbatues rakordon çdo muaj me strukturën përgjegjëse të thesarit në degë për të ardhurat progresive që ka realizuar njësia shpenzuese e qeverisjes së përgjithshme.

- Paragrafit nr.12, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme", që përcakton se:

Sipas procedurave të sistemit të thesarit, ato rakordojnë të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës ushtrimore, duke nënshkruar në dokumentin e akt-rakordimit apo situacionin e të ardhurave, shpenzimeve dhe pagesave, për vitin që raportohet (sipas formatit të gjeneruar nga SIFQ). Rakordimi me sistemin e thesarit është i detyrueshëm për të dy palët.

U auditua zbatimi i kërkesave të nenit 44 "Raporti vjetor" të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", që parashikon se:
"Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një *raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore,* përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës", dhe rezultoi se është hartuar raporti vjetor i miratuar në Këshillin Bashkiak me nr. 22, datë 31.03.2026.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:
Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;
Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:
Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Selenicë për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.** Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve të transaksioneve, proceduara anlitike dhe teste thelbësore, ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, trajtuar hollësisht në vijim.

Tabela nr. 32. *Llogaritja e nivelit të materialitetit për vitin 2025: Treguesi i precizionit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet vjetore për bashkinë është* **12,430,332 lekë.**

Bashkia Selenice, 31.12.2025			
Emërtimi i Shpenzimeve 2024	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për tu shqyrtuar**
Paga (600)	233,127,307	*0.70*	*14*
Sigurime Shoqërore (601)	38,363,433	*0.70*	*2*
Mallra e Shërbime (602)	101,450,963	*0.70*	*6*
Investime të brend. (230-231)	217,926,232	*2.00*	*36*
Te tjera transfer. korrente (606)	152,140,945	*0.70*	*9*
Total	**743,008,880**		
Materialiteti në %	*2%*		
Materialiteti në vlerë	**14,860,178**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**14,860,178**		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	*1,486,018*		
Nëntotali	**13,374,160**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	*90%*		
Vlera e precizionit	**12,036,744**		

Emërtimi i të ardhurave të Bashkisë	**Vlera e Popullatës**	**Faktori i Riskut (0.7-2-3)**	**Çështje për tu shqyrtuar**
te ardhura buxheti		*0.70*	*0*
te ardhurat e veta	24,295,542	*0.70*	*43*
Total	**24,295,542**		
Materialiteti në %	*2%*		
Materialiteti në vlerë	**485,911**		
Kalkulimi i precizionit			
Materialiteti	**485,911**		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	*48,591*		
Nëntotali	**437,320**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	*90%*		
Vlera e precizionit	**393,588**		

Burimi: Bashkia Selenicë, përgatiti grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga procesi i auditimit dhe verifikimi i vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, treguesit e aktiveve dhe aktiveve neto paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 33, Aktivet neto dhe aktivet afatshkurtra

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**3,073,973,563**	**2,911,522,553**
Aktivet	3,492,168,774	3,321,260,795

Pasivet	418,195,211	409,738,242

Lekë

	31.12.2025	31.12.2024
Aktivet Afatshkurtra më datë 31/12	**667,261,110**	**643,915,138**
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	21,424,995	29,047,769
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	371,003,726	375,437,426
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	274,832,389	239,429,943

Burimi: Bashkia Selenicë PFV 2025.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:

Tabela nr. 34 Të dhënat në lekë .

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	274,751,789	239,349,343	35,402,446
50	Letra me vlerë	80,600	80,600	0
532	Vlera të tjera			
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)			
Totali		**274,832,389**	**239,429,943**	**35,402,446**

- Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" paraqitet më datë 01.01.2025, në vlerën 239,349,343 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 274,751,789 lekë.
Nga të dhënat analitike sipas pasqyrave të pozicionit financiare të njësisë shpenzuese Bashkia Selenicë kjo llogari paraqitet në vlerën 274,751,789 lekë që është shuma e gjendjeve analitike të kësaj llogarie. Nga auditimi i të dhënave sipas akt rakordimeve shkresore me thesarin për të ardhurat e trashëguara u konstatua se nuk ka mospërputhje midis të dhënave për të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 me llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar", me vlerën e tyre të regjistruar në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025.

Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" (TK) në vlerën 227,640,904 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" (TK) në vlerën 47,110,885 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" është në vlerën 274,751,789 lekë (TD).
Më hollësisht,

- ✓ ***Llogaria 85, "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur",*** është paraqitur në rubrikën C të Pasqyrës së Performancës Financiare 2025 (F2) që në fund të vitit 2025 është në shumën 227,640,904 lekë, e barabartë me zërin "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85)", që evidentohet në rubrikën C, të Aktiveve neto/ Fondeve neto në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1).

		Viti 2025	Viti 2024
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	227,640,904	205,129,127

- ✓ ***Totali i mjeteve në ruajtje***, sipas akt rakordimit të periudhës 01.01.2025- 31.12.2025 të mbajtur me Degën e Thesarit Vlorë, është 47,110,885 lekë dhe përputhet me shumat e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në pasqyrën F1 të Bilancit Kontabël, që është për të njëjtën vlerë.

		Viti 2025	Viti 2024
520	Disponibilitete në Thesar	274,751,789	239,349,343

466	Kreditore për mjete ne ruajtje	47,110,885	34,220,216
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	227,640,904	205,129,127
	Shuma (llog. 466 + 85):	274,751,789	239,349,343

Burimi: Bashkia Selenicë, DSHFAP.

Këto veprime janë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafët 49-50, ku përcaktohet që:

Paragrafi 49. Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitore të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Paragrafi 50. Tepricat e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me aktrakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në aktrakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues".

Aktivet qarkulluese përkufizohen si tërësia e aktiveve që i shërbejnë funksionimit të njësive të qeverisjes së përgjithshme, për një kohë relativisht të shkurtër, kryesisht për një vit ushtrimor dhe përbëhen nga:

Tabela nr. 35, Llogaritë e klasës së tretë Të dhënat në lekë

Llogaritë kontabël	**Emërtimi i llogarive**	**31.12.2025**	**31.12.2024**	**Diferenca/Ndryshimi 2025-2024**
31	Materiale	7,962,165	15,376,118	-7,413,953
32	Inventar i imët	13,462,830	13,671,651	-208,821
33	Prodhime, punime e shërbime në proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Kafshë në rritje e majmëri			
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)			
Totali		21,424,995	29,047,769	**-7,622,774**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2025, paraqitet në vlerën 21,424,995 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 7,962,165 lekë dhe llogaria 32 "Inventar i imët" 13,462,830 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -7,622,774 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit", e paraqitur në të njëjtën vlerë në Formatin F2 *"Pasqyra e Performancës Financiare",* (Grupi VIII, rreshti 120). Sa me sipër, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së

Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.1:
Llogaria 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë: a) Kur blihen, bëhen hyrje materialet: - Debitohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"; - Kreditohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". b) Kur bëhen dalje materialet: - Debitohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"; - Kreditohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"

- **Llogaria 31 "Materiale"**, ka vlerën 7,962,165 lekë me datën 01.01.2025 kurse Llogaria 32 "Inventarë i imët", ka vlerën 13,462,830 lekë në fund të vitit ushtrimor 2025 .
Gjendja e llogarive të mësipërme materiale është e kuadruar me tepricën e tabelave të inventarizimit fizik të pasurisë. Për kryerjen procedurave të inventarizimit të pasurisë është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit ku është përcaktuar grupi për inventarizimin e aktiveve. *Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*".

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:
Tabela nr. 36, *llogaritë e klasës së 4-rt* Të dhënat në lekë*:*

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	70,005,368	70,005,368	
431	Tatime e taksa			
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal			
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti			
435	Sigurime Shoqërore			
436	Sigurime Shëndetësore			
437,438	Organizma të tjerë shoqërore			
44	Institucione të tjera publike			
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes			
468	Debitorë te ndryshëm	236,324,467	236,324,467	
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	64,673,891	69,107,591	
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit			
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
Totali		**371,003,726**	**375,437,426**	**-4,433,700**
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme			
Totali		**0**	**0**	**0**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Llogaria 423,429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba":
Llogaritë e arkëtueshme përbëhet nga llogaria 423,429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* në shumën 70,005,368 lekë, llogaria 468 *"Debitorë të ndryshëm"* në shumën 236,324,467 lekë si dhe llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* në shumën 64,673,891 lekë.
Llogaria 423, 429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* mbyllet me tepricën e pasqyruar në pasqyrat financiare në shumën 70,005,368 lekë. Kjo tepricë përfaqëson:

- detyrime të lëna nga konkluzionet përfundimtare të auditimeve të ushtruara nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në shumën 34,787,268 lekë;
- detyrime të konstatuara nga vjedhjet e mjeteve monetare në shumën 1,207,510 lekë të mbartura nga vitet e mëparshme nga bilancet e ish- komunave;
- detyrime nga debitorët e ndihmës ekonomike në shumën 1,112,974 lekë dhe
- detyrime nga debitorë të ndryshëm, në shumën 32,897,616 lekë.

Konstatim: Detyrimet e lëna për zhdëmtim nga përfundimet e auditimeve të ushtruara nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në shumën 34,787,268 lekë, detyrimet nga debitorët e ndihmës ekonomike në shumën 1,112,974 si dhe detyrimet nga debitorë të ndryshëm në shumën 32,897,616 lekë janë keqklasifikuar në llogarinë 423, 429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba",* veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar. Kreu III, paragrafi 3.3 *"Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve" (klasa 4),* ku përcaktohet se në llog. 429 regjistrohen gjobat dhe deficitet e personelit.
Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është paraqitje jo e drejtë e pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5.
Për debitorët e lidhur me raportet e auditimit të KLSH-së nuk është proceduar duke depozituar padi dhe kërkuar në rrugë gjyqësore për mbledhjen e detyrimit, ndaj këto detyrime të keqkontabilizuara rezultojnë të paarkëtuara, dhe bazuar në periudhën e krijimit të detyrimeve, mos arkëtimi i tyre krijon riskun që subjekti vendor të humbasë fuqinë ligjore të kërkimit të kësaj të drejte. Kjo, bazuar në nenin 203, pika 1, të Kodit të Punës së RSH *"Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet",* si dhe neni 115 i Kodit Civil "*Parashkruhen brenda afateve prej:.... dh) tre vjetëve paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor dhe paditë për kthimin e përfitimit pasuror pa të drejtë"*. Në lidhje me detyrimet e debitorëve, të krijuar që nga viti 2019 dhe paraqitur në raportet e auditimit të KLSH-së), bazuar në Kodin Civil, neni 114 "Afatet e parashkrimit" ku shprehet se "*Kur në ligj nuk është parashikuar ndryshe, parashkruhen brenda dhjetë vjetëve të gjitha paditë midis personave juridikë, midis këtyre dhe personave fizikë, si dhe midis vetë personave fizikë"* , për këto detyrime debitore ekziston rreziku i parashkrimit të tyre.
Mosarkëtimi në afat i debitorëve sjell riskun e parashkrimit për arkëtimin e të drejtave dhe të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit dhe veprime në jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar*; nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 27 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, (Kreu II, paragrafët 2.4.4 dhe

2.4.6 dhe aneksi nr. 6); Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave "*Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve",* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 3.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike",* neni 7, pika 1/d.

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 236,324,467 lekë. Dhe nuk ka asnjë lëvizje të llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	236,324,467
Shtesa (D)	0
Pakësime (K)	0
Gjendja në 31.12.2025	236,324,467

- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2025, më datën 01.01.2025

Konstatim:

I. Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve debitore në Bashkinë Selenicë në fund të vitit 2025 prej 236,324,467 lekë**,** që gjatë vitit nuk ka asnjë shumë të arkëtuar. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet një nivel i lartë i detyrimeve të mbartura e të trashëguara të regjistruara në llog. 468. Ky problem është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër.

Sa më sipër, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar;

g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta

neni 42 pika 1-5 të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar;

1. Të ardhurat e miratuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për buxhetin vjetor përbëjnë kufirin minimal për t'u arkëtuar gjatë vitit buxhetor.

2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësime sistematike për të identifikuar risqet dhe marrin masa për të shmangur evazionin fiskal.

5. Niveli, kohëzgjatja dhe struktura e detyrimeve tatimore të evidentuara e të paarkëtuara në kohë evidentohen dhe raportohen si pjesë e raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Ligjin nr.9632, datë 30,10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kapitulli II, pika 6: *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues…".*

II.- Llogaria 468 ***"Debitorë të ndryshëm"*** përfaqëson detyrimet që kanë të tretët ndaj Bashkisë Selenicë e cila për periudhën e auditimit është mbyllur me tepricë në shumën **236,324,467 lekë**.

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Selenicë deri në datën 31.12.2025 gjendja e debitorëve është në shumën **448,544,679 lekë,** pasqyruar në tabelën e mëposhtme. *Konkretisht,* debitorë të taksës bujqësore janë në shumën 252,749 mijë lekë, debitorë të taksës së ndërtesës janë në shumën 32,111 mijë lekë, debitorë të taksës së pastrim, ndriçim, truall dhe gjelbërim janë në shumën 37,845 mijë lekë, debitorë të biznesit të vogël janë në shumën 42,536 mijë lekë, debitorë të biznesit të madh janë në shumën 77,593 mijë lekë si dhe debitorë aluizni janë në shumën 5,709 mijë lekë.

Tabela Nr.37, Gjendja e debitorëve për tatimet dhe taksat vendore (në formë progresive deri me dt. 31.12.2025) Në lekë

Emërtimi njësive	Gjendja fund 31.12.2024	Pakësime 2025	Shtesa gjatë vitit 2025	Gjendja në fund vitit 2025
BIZNESE	**120,689,022**	**8,846,420**	**8,286,971**	**120,129,573**
Detyrime te mbartura biz vogël	42,767,661	1,111,420	880,250	42,536,491
Detyrime te mbartura biz i madhe	77,921,361	7,735,000	7,406,721	77,593,082
FAMILJARE	**329,814,813**	**34,672,035**	**33,286,826**	**328,415,106**
Taksa e tokës bujqësore	260,486,818	29,872,650	22,135,779	252,749,947
Taksa pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi	35,355,664	2,136,635	4,625,900	37,844,929
Taks ndërtese (objekt banimi)	28,119,914	1,581,404	5,587,163	32,111,175
Taksa vaditje	-	-	-	-
ALUIZNI.	5,852,417	1,081,346	937,984	5,709,055
TOTALI				**448,544,679**

Burimi: Bashkia Selenice (viti 2025), Drejtoria e Të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave

Nga auditimi konstatohet një diferencë në shumën 212,220,212 lekë detyrime të pa konstatuara dhe të pa kontabilizuara, pasi teprica e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" me dt. 31.12.2025 paraqitet në bilanc në shumën 236,324,467 lekë, ndërkohë që debitorët e drejtorisë së të ardhurave, pronave publike, lejeve e licencave" janë 448,544,679 lekë.[9]

Në lidhje me këtë situatë nuk ka një korrespodencë ndërmjet Drejtorisë së Të Ardhurave Pronave dhe Lejeve e Licencave në Bashkinë Selenicë dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Arkivit dhe Protokollit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, kreu "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)".

Për vjeljen e detyrimeve nga ana e Drejtorisë së tatim Taksave nuk janë aplikuar masa shtrënguese, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93 dhe me dokumentin e paketës fiskale, të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

III. Nga ana e Bashkisë së Selenicës nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore, por llogaria "Debitorët e ndryshëm" (llog. 468) në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën prej 236,324,467 lekë. Për periudhën 1-vjeçare (1.1.2025 deri më 31.12.2025), niveli i arkëtimit të debitorëve është 0 lekë,

[9] -Nga analiza e auditimit rezulton se paraqitetn tregues te ndryshëm të detyrimeve progresive (shiko tabela nr 26 dhe nr 37) të vena në dispozicion nga Drejtoria e Të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave

IV. Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" nga ana e Bashkisë së Selenicës (DTAPPLL) nuk janë dërguar në DSHFAP dhe nuk janë pasqyruar në kontabilitet vlerat e gjobave të IMTV-së për ndërtime pa leje gjatë periudhës 2024 dhe 2025 që kanë2 (dy) subjekte, në vlerën **70,000 lekë.**
Konkretisht, rezultojnë të ardhura të munguara nga mos kontabilizimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë, të lindura gjatë vitit 2024 dhe 2025 për Vendimin e Kryeinspektorit vendor me nr. 65, datë 16.02.2024 për 20,000 lekë; vendimin nr. 67, dt. 23.12.2025 në shumën 50,000 lekë, duke nënvlerësuar llogarinë 486 "Debitorë të ndryshëm" dhe llogarinë 7115, e cila më dt. 31.12.2025 pasqyrohet për 70,000 lekë.
V. Nuk është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit dhe në centralizatorin përmbledhës të llogarive, ***llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë"*** që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.
Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"", ku përcaktohet që:

Pika 7. Në rubrikën 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik", paragrafi 21, shtohet pika c me këtë përmbajtje:
c) Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t'u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16 (e) administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë:

- ✓ *Për konstatimin paraprak të të drejtave për t'u arkëtuar* debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) "Debitorë të ndryshëm" dhe Kreditohet llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" në analiza shtatëshifrore sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar.
- ✓ *Për arkëtimin e të drejtave*, në të njëjtën kohë me veprimet sipas pikës 16 (e) dhe 22, kryhet veprimi i kundërt: debitohet llogaria 470 dhe kreditohet llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë (411/468).

Pika 16/e: Për të ardhurat e shfrytëzimit, në momentin e njohjes, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Debitohet llogaria përkatëse financiare (klasa 5); dhe Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7).
Pika 22: Llogaritë përkatëse financiare në klasën 5 funksionojnë si më poshtë vijon: Debitohet llogaria financiare përkatëse; Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7), "Të ardhurat sipas natyrës ekonomike

Pasqyrimi i llogarive 4342 *"Operacion me shtetin (të drejta)"* dhe 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore:
- Gjendja e llogarisë ***4342 "Operacion me shtetin (të drejta)***" *(financim i pritshëm nga buxheti),* sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit, paraqitet në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar më datën 01.01.2025 në vlerën 69,107,591 lekë, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 64,673,891 lekë, ose me një pakësim në vlerën -4,433,700 lekë ndaj vitit të mëparshëm.

4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	64,673,891	69,107,591

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Referuar Planit Kontabël dhe udhëzimeve të MF, kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401, 421, 431, 435, 436, 437 dhe 467 dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit të bashkisë për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara *(grantet korrente a kapitale që merren nga buxheti i shtetit).*

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, llogaria 4342, *"Operacione me shtetin (të drejta)"* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për ***shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara*** (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla janë zëra si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo detyrimet për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm, etj.

- Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, "Shpenzime sipas natyrës" dhe Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

- Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)", Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti".

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, përmbledhësja e llogarive 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llog. e tjera të klasës 4-rt, janë në vlerën 64,673,891 lekë:

Tabela nr.38, Kundërpartia llogarisë 4342 Në lekë

llogaria	**Emërtimi**	**31.12.2025**	**31.12.2024**
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	8,490,548	3,917,445
42	Detyrime ndaj personelit	17,482,096	15,092,574
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,178,867	1,498,845
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
435	Sigurime Shoqërore	4,974,682	4,550,068
436	Sigurime Shëndetësore	687,689	628,080
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		
44	Institucione te tjera publike		
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
464	Detyrime për tu paguar për blerje të letrave me vlere		
467	Kreditore te ndryshëm	30,860,009	43,420,579
	Shuma	**64,673,891**	**69,107,591**

Burimi: Bashkia Selenice

Nga auditimi i pasqyrave financiare në lidhje me saktësinë e tepricës së llogarisë 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në mbyllje të vitit 2024 dhe 2025 rezultoi se:

- **a.** Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 64,673,891 lekë, kuadron me shumën e vlerës së llogarive për detyrimet e konstatuara dhe të rezultuara më dt. 31.12.2025. Gjithashtu, edhe për vitin e mëparshëm 2024, shuma e llogarive të detyrimeve është 69,107,591 lekë, e cila është e rakorduar me tepricën e llogarisë 4342 është për të njëjtën vlerë për atë vit buxhetor prej 69,107,591 lekë.
- **b**. Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 64,673,891 lekë, kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", në Pasqyrën F2 të Pozicionit Financiar të kësaj Bashkie më dt. 31.12.2.2025 prej 64,673,89 lekë, mirëpo Llogaria 4342

"Operacione me shtetin (të drejta)" më dt. 31.12.2024 në vlerën 69,107,591 lekë nuk kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit" në atë datë, për tepricën e kësaj llogarie 52,222,372 lekë. Më hollësisht,

Pasqyra F1 e Pozicionit Financiar

llog	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
4342	*Operacione me shtetin (Të drejta*)	64,673,891	**69,107,591**

Pasqyra F2 e Performancës Financiare të Bashkisë

7206	*Financim i pritshëm nga buxheti*	64,673,891	**52,222,372**

Konstatim:

- Nga auditimi konstatohet se llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (Të drejta)"* kuadron për vitin 2025 me llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti"* me tepricë 64,673,891 lekë, por llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (Të drejta)"* me dt. 31.12.2024 nuk kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit" në atë datë që paraqitet në shumën prej 52,222,372 lekë në Pasqyrën e Performancës Financiare të vitit të mëparshëm, duke mos mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti"), të cilat evidentojnë të drejta të njësive të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, "Operacione me shtetin". Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është paraqitje jo e drejtë e pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*.

Sa më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2024 të kësaj llogarie me ndikim në bilancin e çeljes 2025, në mos përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)" si dhe paragrafi "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin", si dhe Aneksi 1 dhe me pikën 8, paragrafi 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i Llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar:

"Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme (si njësi shpenzuese me kontabilitet me vete), para evidentimit të dhënave ne pasqyrat financiare, duhet që të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore".

***

Referuar përcaktimeve të Kreut III, nënkreu 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)", pika 8/l, të UMF nr.8, datë 09.03.2018, Llogaria ***4341, "Operacione me shtetin (detyrime)"*** është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit

Financiar, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit ***<u>për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme</u>***.
Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes buxhet apo institucion) dhe Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.
E ardhura që në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi: Debitohet llogaria 8424, "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm", Kreditohet llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)".
Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

- **Llogaria 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)",** më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë. Teprica e llogarisë 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)" sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit për vitin 2025, paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar në fund të v.2025 në shumën 0 lekë (rreshti 83 në pasiv të bilancit, grupi i Pasiveve Afatshkurtra). Më datën 01.01.2025 në vlerën 0 lekë.

4341	Operacione me shtetin (detyrime)	<u>0</u>	0

Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 janë po në të njëjtën shumë, prej 306,329,835 lekë, ku përfshihet vlerat e llogarisë 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" dhe llog. 468 "Debitorë të ndryshëm".
Më hollësisht, në

Tabela nr.38, Kundërpartia llogarisë 4341 Në lekë

llog	**Emërtesa**	**31.12.2025**	**31.12.2024**
411	Klientë e llogari te ngjashme	0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	70,005,368	70,005,368
468	Debitorë të ndryshëm	236,324,467	236,324,467
	Shuma	**306,329,835**	**306,329,835**

Burimi: Bashkia Selenicë

Sa më sipër, rezultojnë mospërputhje dhe nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë 4341, në mos përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48 dhe Kreu III, paragrafi 32.
Detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare, duke mbajtur parasysh njohjen në çastin e ndodhjes si shpenzime, pavarësisht nga data e pagesës së tyre nga llogaritë financiare. Në këtë rast, duhet të mbahet nën kontroll evidentimi joreal i detyrimeve në marrëdhëniet e shtetit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme (llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)").

- **Llog.486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme"**, sipas PFV të Bashkisë Selenicë për vitin 2025 është evidentuar në vlerën zero lekë, kurse për vitin 2024 është pasqyruar në aktiv (zëri të tjera aktive afatshkurtra (rreshti 4), për tepricën 0 lekë . Llogaria 486 përfshihet në grupin e llogarive rregulluese dhe përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm *(shpenzime të parapaguara).*

486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	0	0

Sa më sipër, për vitin 2025 janë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me *llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të*

ardhshme", (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, Kreu III" Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme").

Mbi rakordimin e PFV të Bashkisë me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ;

Konstatim:

I. U auditua përputhja e të dhënave mbi totalin e aktiveve, pasiveve dhe aktiveve neto sipas **PFV** të hartuara nga ana e njësisë raportuese Bashkia Selenicë dhe të dorëzuara zyrtarisht në DTH dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në **SIFQ**.

Tabela nr.39, Rakordimi PFV të gjeneruara nga Bashkia dhe nga SIFQ Në lekë

Viti 2024

Grupi	Emërtimi	Pasqyrat Financiare 2024	SIFQ 2024
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,911,522,553	2,672,092,610
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,911,522,553	2,061,863,262

Viti 2025

Grupi	Emërtimi	Pasqyrat Financiare 2025	SIFQ 2025
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	3,073,973,563	2,938,129,166
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,073,973,563	2,230,949,999

Burimi: Bashkia Selenicë (PFV 2025), Dega e Thesarit Vlorë (PFV Bashkia Selenicë nga SIFQ), përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Shuma e aktiveve neto sipas PFV për vitin 2024 nga Bashkia Selenicë është 2,911,522,553 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 2,672,092,610 lekë. Diferenca prej 239,429,943 lekë, e cila është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2024, që në PF është 239,429,943 lekë.

-Shuma e aktiveve neto sipas PFV për vitin 2025 nga Bashkia Selenicë është 3,073,973,563 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 2,938,129,166 lekë. Diferenca prej 135,844,397 lekë , e cila nuk është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2025, që në PF është 274,832,389 lekë.

Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" është 138,987,992 lekë = (274,832,389 - 135,844,397).

II. Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të ngarkuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) rezultoi se, të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara me nr. me nr. 909, datë 31.03.2026 në një numër të këtyre llogarive të dhënat **nuk rakordojnë**, sa rezultuar nga testimet e kryera nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Konkretisht, janë **8 zëra e nënzëra** ***të llogarive kontabile, ku ekzistojnë mospërputhje të tepricës së llogarive pjesë e PFV të dorëzuara zyrtarisht nga ana e Bashkisë Selenicë në Degën e Thesarit Vlorë***, krahasuar me të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), *(në këto të fundit nuk përfshihet TD e llog. 520 "Disponibilitete në Thesar"),* **për një diferencë prej 134,193,125 lekë,** *në* sa vijon:

Tabela nr.40, *Analiza krahasuese e të dhënave të PF me SIFQ 2025* Të dhënat në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi i llogarisë	PFV sipas shkresës nr. 909, 31.03.2026	PFV sipas SIFQ	Diferenca
1.	Klasa 3-të	Gjendje Inventari qarkullues	21,424,995	28,630,127	-7,205,132
2.	31	Materiale	7,962,165	15,376,118	-7,413,953
3.	32	Inventar i imët	13,462,830	1,254,009	12,208,821

4.	Klasa 2-të	Aktivet Afat gjata materiale	2,606,054,197	2,735,999,195	-129,944,998
5.	20	Aktive Afatgjata jo materiale	927,235	2,765,098	-1,837,863
		Shuma			-134,193,125

Burimi: Bashkia Selenicë (PFV 2025), Dega e Thesarit Vlorë (PFV Bashkia Selenicë nga SIFQ), përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 10 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025":
*Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara të jenë **të njëjta** me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ.*
III. Nga auditimi mbi informacionin shpjegues pasqyruar ë Formatin nr. 5 të PF, "Pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, viti 2025", në rubrikën "*Diferenca midis pasqyrave financiare të njësisë raportuese dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në SIFQ",* nuk ka asnjë shënim mbi këto diferenca. Sa më sipër, nuk ka gjetur zbatim Pika 14, Seksioni 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Paragrafi 39 ndryshon përmbajtjen, si më poshtë:
Këto pasqyra iu dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit për krahasimin e bilancit vërtetues me informacionin financiar të SIFQ, rakorduar gjatë vitit sipas paragrafit 37. Qëllimi kryesor është përgatitja e pasqyrave financiare individuale për çdo njësi shpenzuese, përgatitja e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduara në nivel njësie publike qendrore ose vendore, së bashku me shënimet shpjeguese, *ku analizohet diferenca midis vlerave kontabël të njësive dhe vlerave kontabël të SIFQ, veçanërisht diferenca midis zërave të Pasqyrës së Flukseve Monetare prodhuar nga SIFQ dhe zërat e Pasqyrës së Performancës Financiare prodhuar nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.*

-Nga auditimi i **llog. 85 "Teprica ose dificiti i periudhës/ rezultati i veprimtarisë së periudhës**" rezultoi se, në fund të v.2024 dhe 2025 të dhënat e llogarisë në F1 dhe F2 përputhen për vlerat e tyre të regjistruara, (përkatësisht 205,129,127 lekë në F2 dhe lekë në F1 në fund të vitit 2024 dhe 227,640,904 lekë në F2 dhe lekë në F1 në fund të vitit 2025).
F1:

85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	227,640,904	205,129,127

F2:

85	Teprica ose deficiti i periudhës *(Rezultati i Veprimtarisë se vitit Ushtrimor)*	227,640,904	205,129,127

Sa më sipër, në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 57, pikës 3.4, "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të performancës financiare", Kreu III, të Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton se,
" Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës së mësipërme, *llogaria 85, "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" përfaqëson,* si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), për t'u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës**.** Ndërsa, si tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.

II. AKTIVET AFATGJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

Tabela nr.41, AAGJ në Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
	II. Aktivet Afat gjata	**2,824,907,664**	**2,677,345,657**	**147,562,007**
20	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**927,235**	**1,187,445**	**-260,210**
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	0		
202	Studime dhe kërkime	927,235	1,187,445	
203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme	0	0	
21	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**2,606,054,197**	**2,224,349,103**	**381,705,094**
210	Toka, Troje, Terrene	140,249,952	140,249,952	
211	Pyje, Plantacione	0	0	
212	Ndërtesa e Konstruksione	390,726,957	301,440,715	
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,012,342,110	1,717,432,478	
214	Instalime teknike, makineri e paisje	5,815,378	7,269,222	
215	Mjete Transporti	40,010,457	39,845,571	
216	Rezerva Shtetërore	0	0	
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	
218	Inventar ekonomik	16,909,343	18,111,165	
24	Aktive afatgjata te dëmtuara	0	0	
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	0	
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**	
25	Huadhënie e Nën huadhënie			
26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet			
	4.Investime	**217,926,232**	**451,809,109**	**-233,882,877**
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale			
231	Për Aktive Afatgjata materiale	217,926,232	451,809,109	-233,882,877

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** më datë 01.01.2025, ka qenë në vlerën neto 1,187,445.lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,577,653lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 261,715 lekë dhe pakësim në vlerën 9,672,782 lekë. Amortizimi i akumuluar është në vlerën 8,096,634 ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në kontabilitet me vlerën neto 927,235 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.42 Lëvizjet e llog.202 për vitin 2025 Në lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	14,211,822
	2	Amortizim i akumuluar	13,024,437
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**1,187,445**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	1,577,653
	5	Amortizim i shtesës	261,715
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	9,672,782
	7	Amortizim nga pakësimet	8,096,634
	4	Kosto historike	6,116,753
	5	Amortizim i akumuluar	5,189,518
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**927,235**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Tabela nr.43 Lëvizjet e llog.202 për vitin 2025 Në lekë

Studime-Projektime (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Projekt" Ura e Shullerit"		1,577,653		1,577,653
Studim projektim I mbrojtjes nga erozioni te qytetit nga përroi Otim ,rruga Shkoze Golimbas-Mesaplik	6,657,000		6,657,000	
Studim projektim	98,400		98,400	
Projekt preventiv i kanaleve te dyta Lubonjë, Picar, Armen	899,999		899,999	
Projekt ndërtimi I rrjetit te kanalizimeve te ujërave te zeza ne fshatin Mesaplik	270,000		270,000	
Projekt ndërtimi I rrjetit te ujërave të zeza Picar	240,000		240,000	
Ndërtimi I rrjetit te kanalizimeve të urave të zeza	283,276		283,276	
Projekt rikonstruksion kanale vaditëse te fshatit Kote	300,000		300,000	
Projekt preventiv dhe preventiv përfundimtar për objektin punime riparimi ne shkollat e bashkisë	494,525		494,525	
Projekt për objektin punime riparimi ne kanalet ujitëse	207,360		207,360	
Projekt me objekt :Rehabilitim dhe mbrojtje nga përroi Otim	222,222		222,222	
Harta e Urbanistikes	150000			150000
Projekt i zyrave te Bashkisë	2760100			2760100
Projekt për rikonstruksionin e shkollës 9-vjecare "Dëshmoret e Peshkëpisë"	249000			249000
Projekt rikonstruksion i shkollës 9vjecare "T.K".	144000			144000
Projekt Rehabilitim I rrugës Tubo Selenicë	300000			300000
Plane rilevimi	936,000			936000
Totali	**14,211,882**	**1,577,653**	**9,672,782**	**6,116,753**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice

Konstatim:

A. Nga inventarizimi i pasurisë i kryer për vitin 2025, sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me Urdhrit nr. 164 prot, datë 18.11.2025 nuk është përfshirë verifikimi i ekzistencës fizike të studimeve dhe projektimeve. Pra, nuk është testuar ekzistenca e dokumentuar të këtyre studime-projektimeve dhe mungon nënshkrimi nga personi përgjegjës që i ka në ngarkim/ arkivuar këto aktive afatgjata jomateriale,

B. Nga analiza e tepricës së llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* në fund të vitit 2025, konstatohet se në vlerën totale të llogarisë prej 6,116,753 lekë, është përfshirë shuma prej 3,947,625 lekë që i përket vlerës së disa projekt-studime për investime, e pa shpërndarë sipas llojit të aktiveve afatgjata materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

Tabela nr.44 *Përbërja e llog 202 "Studime dhe projektime", v.* 2025 të pa shpërndara sipas investimeve (Në lekë)

Emërtimi i studim-projektimit	***Vlera fillestare***
Projekt i zyrave te Bashkisë	2,760,100
Projekt për rikonstruksionin e shkollës 9-vjecare "D e P"	249,000
Projekt rikonstruksion i shkollës 9vjecare "T K".	144,000
Projekt Rehabilitim i rrugës T Selenicë	300,000
Projekt preventiv dhe preventiv përfundimtar për objektin punime riparimi ne shkollat e bashkisë	494,525
Shuma	**3,947,625**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b. d, Kreu III. pika 36,

Aneksi 1, pika 2, Klasa 2; si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 30-35, Kreu IV pika 75, ku përcaktohet që:

Pika 26. Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.
Pika 35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:
a) Dokumente autorizuese, janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.,;
b) Dokumente vërtetuese, vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi;
c) Dokumente të kontabilitetit janë dokumentet përmbledhëse, ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitikë, kartelat e aktiveve, etj.,) të çdo lloj forme, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
Pika 36. Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- **Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 140,249,952 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 140,249,952 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

210	Toka, Troje, Terrene	140,249,952	140,249,952

Tabela nr.45, *llog 210* Në lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	140,249,952
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	140,249,952
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	140,249,952
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	140,249,952

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Konstatim:

A. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë (210) "Toka, troje, terrene" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të. Nuk ka informacion mbi shumën prej 140,249,952 të trashëguar në bilancet e ish Komunave ngase përbëhet. Mungesa e informacionit kontabël për këtë llogari ndikon në informacionin që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, me efekt në procesin e inventarizimit fizik të tyre.

B. Në llog. 210 nuk janë përfshirë për të gjithë aktivet ndërtimore /aktive afatgjata materiale (llog.212), vlera e truallit në pronësi të Bashkisë Selenicë. Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Arkivë Protokollit, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të;


a) trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, kopshteve, qendrave shëndetësore, shkollave, Zyrat e Bashkisë Selenicë, si dhe të zyrave të Nj.A-ve, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione";

b) nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Nga auditimi i pasqyrës 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" u konstatua që për vitin 2025 nuk ka as shtesa as pakësime, dhe mbetet vlera e trashëguar nga data 01.01.2025.

Bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për **ZK1022 -3209 Selenicë** në lidhje me pasuritë *Godina e Bashkisë, Shkollat, ambulancat,* vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet duke filluar *me çmim trualli* 384 lek/m2, *e*tj. **384 lekë/m2** për këto zona kadastrale.



Burimi: Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 994 Bashkia Selenicë

Sa më sipër, vepruar jo në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, në mospërputhje me përcaktimet e paragrafit 62, pika 3.3,"Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), Kreu III, të


Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave, që përcakton shprehimisht se,
62.Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.
...
Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë:
-Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;

- Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"

Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" në datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë me vlerë neto. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën zero lekë.

211	Pyje, Plantacione	0	0

Referuar të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë Pyje Kullotave dhe Zhvillimit Rural në Bashkinë Selenicë, konstatohet se, në fondin pyjor dhe kullosor regjistrimet ndër vite paraqiten si më poshtë:



Burimi: Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 995, Bashkia Selenicë

Konstatim:

a.Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" në datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë me vlerë neto. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël sipas kostos historike e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën zero lekë.
b.*Nga auditimi konstatohet se* Bashkisë Selenicë i kanë kaluar sipas:

- ✓ VKM nr. 684, datë 02.09.2020 *"Për transferimin e pyje/kullota të Bashkive",* 485 prona pyje kullota 26,899,56 ha të cilat nuk janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit të Bashkisë.
- ✓ VKM nr. 433, datë 08.06.2016 Bashkisë i kanë kaluar 500 prona pyje dhe kullota në total 24,322.06 ha, të cilat nuk janë inventarizuar dhe kontabilizuar në librat e kontabilitetit të Bashkisë

- Kjo llogari nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara me VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas

listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive", pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Selenicë.

Qarku Vlorë
Bashkia Selenicë

Shtojca 55

Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Selenicë

Nr	Qarku	Bashkia	Kodi Kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra/ Nëngastra	Sipërfaqja HA	Kategoria e përdorimit të territorit	Shënime
1	VLORË	Selenicë	VL41 00 001	E.P.Selenice	1	21.00	pyll	
2			VL41 00 002	E.P.Selenice	2	53.80	pyll	
3			VL41 00 003	E.P.Selenice	3	33.80	pyll	
4			VL41 00 004	E.P.Selenice	4	28.00	pyll	
5			VL41 00 005	E.P.Selenice	5	22.00	pyll	
6			VL41 00 006	E.P.Selenice	6	44.00	pyll	
7			VL41 00 007	E.P.Selenice	7	51.00	pyll	
8			VL41 00 008	E.P.Selenice	8	42.30	pyll	
9			VL41 00 009	E.P.Selenice	9	32.70	pyll	
10			VL41 00 010	E.P.Selenice	10	60.50	pyll	
11			VL41 00 011	E.P.Selenice	11	32.70	pyll	
12			VL41 00 012	E.P.Selenice	12	37.00	pyll	
13			VL41 00 013	E.P.Selenice	13a	6.00	bimesi pyjore	
14			VL41 00 013	E.P.Selenice	13b	36.20	bimesi pyjore	
15			VL41 00 014	E.P.Selenice	14	30.50	bimesi pyjore	
16			VL41 00 015	E.P.Selenice	15	31.80	bimesi pyjore	
17			VL41 00 016	E.P.Selenice	16a	29.00	bimesi pyjore	
18			VL41 00 016	E.P.Selenice	16b	8.50	bimesi pyjore	
19			VL41 00 016	E.P.Selenice	16c	6.50	bimesi pyjore	
20			VL41 00 017	E.P.Selenice	17a	50.50	bimesi pyjore	
21			VL41 00 017	E.P.Selenice	17b	4.00	bimesi pyjore	
22			VL41 00 017	E.P.Selenice	17c	5.00	bimesi pyjore	
23			VL41 00 018	E.P.Selenice	18a	10.00	bimesi pyjore	
24			VL41 00 018	E.P.Selenice	18b	10.50	bimesi pyjore	
25			VL41 00 019	E.P.Selenice	19a	33.80	pyll	

Burimi: Fragment i aneksit të VKM nr. 433, dt. 08.06.2016 ; Fletores Zyrtare nr.187, viti 2017, fq 2041 Bashkia Selenice

Për këto prona nuk është kryer verifikim fizik në lidhje me gjendjen e tyre për vitin 2025. Veprime këto në kundërshtim me, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Konstatim: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se Bashkia Selenicë nuk disponon një regjistër të konsoliduar të aseteve për pronat publike, përfshirë kullotat, pyjet dhe sipërfaqet e tjera, si dhe nuk ka kryer vlerësimin dhe inventarizimin e tyre. Mungesa e certifikatave të pronësisë ka penguar pasqyrimin kontabël të aktiveve, duke ndikuar në saktësinë e bilancit dhe në aftësinë e njësisë për të menaxhuar pasurinë publike në mënyrë të plotë.
Këto veprime bien në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me pikën 1 dhe 2, kreu VI të VKM nr. 510, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"* dhe Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, *"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*.

- Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione" më datë 01.01.2025, referuar të dhënave në pasqyrën 7/a të Bilancit Vjetor, ka qenë me kosto historike në vlerën 301,440,715 lekë, kurse pas zbritjes së amortizimit të akumuluar, me dt. 1.1.2025 teprica neto e llog.212 është 390,726,957 lekë (kolona nr.3 e formatit 7/b). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 109,840,082 lekë, pakësime në vlerën 0 lekë. Amortizimi i akumuluar në fund të periudhës ushtrimore vlerësohet 1,089,453,490 lekë. Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën neto 390,726,957 lekë.

212	Ndërtesa e Konstruksione	390,726,957	301,440,715

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Tabela nr.46, *llog 212* Në lekë

Referenca	Nr.		Llog.212
	1	Kosto historike	467,540,499
	2	Amortizim i akumuluar	166,099,784

Ditari i veprimeve	**3**	**Gjendja në 01.01.2025**	301,440,715
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	109,840,082
	5	Amortizim i shtesës	20,553,840
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike 31.12.25	577,380,581
	5	Amortizim i akumuluar	186,653,624
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	390,726,957

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

- Nga auditimi i pasqyrës formatit 7/a *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)",* dhe krahasimi i pasqyrave të pozicionit financiar të paraqitura për llogarinë 212 "Ndërtesa e konstruksione" me të dhënat e llogarive sipas thesarit në fund të vitit 2025, u konstatua që nuk ka diferenca për ketë llogari.

Tabela nr.47, *llog 212* Në lekë

Ndërtesa e konstruksione (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
	467,540,499			577,380,581
Projekt preventiv dhe preventiv përfundimtar për objektin punime riparimi ne shkollat e bashkisë		494525		
Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetin e varfër dhe te pafavorizuar2023-2024		24,053,036		
Hidroizolim rikonstruksion shkolla 9 vjeçare		11,628,058		
Mbikëqyrje shkolla 9-vjecare		112,028		
Super vizim Rikonstruksion shkolla "H.B"		1,297,151		
Rikonstruksioni I shkollës "H.B"		72,193,286		
Kolaudim riparim shkolle lyerje dyer e dritare		3,655		
Kolaudim merematim shkolla 9- vjeçare		16,132		
Kolaudim rikonstruksion shkolla "H.B"		42,211		
Totali	**467,540,499**	**109,840,082**		**577,380,581**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Konstatim:

1. Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e ***udhëzuesit për mbrojtjen e aktiveve*** dhe të ***Strategjisë së menaxhimit të pronave publike vendore***, si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07. 2010 i ndryshuar; Udhëzimit nr. 30, datë2011, si dhe Kreut II, pika 20, të Udhëzimit të MF nr.35, dt. 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të"*

2.Mungesa e pasqyrimit te vlerave reale të vlerës së disa aseteve të Bashkisë Selenicë, me origjinë që me krijimin e saj, po nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e ish-Komunave *(të tilla si, harta topografike, planimetri të objekteve, koordinata të vendndodhjes së tyre, etj.).* Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj bashkie. Bashkimi i aseteve nga ish-komunat, është realizuar nga bashkimi i vlerave te bilanceve të tyre, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivit dhe pasivit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullta të vlerave të Aktiveve të Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Qarkulluese .

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Selenicë rezultoi se një numër i aktive afatgjata/ pasuri që administrohen nga NJVQV, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të ndryshme kohore dhe kjo tregon për një pasaktësi në

evidentimin e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë të këtyre pasurive.
Në këto kushte, duke qenë se ka mospërputhje apo mungesë të dokumentacionit tekniko-administrativ për çdo objekt të llogarisë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", nga Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara; saktësimi i objekteve, bashkimi i vlerës së projektit, rikonstruksionit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit me atë të aktivit, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizimi fizik i objektit, si dhe rivlerësimi për secilin objekt. *Për sa më sipër*, Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025.
3. Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" (kosto historike) u konstatua se në këtë llogari, referuar analizës në nivel artikulli, vlerat e projekt preventivit, rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit nuk janë shtuar vlerës fillestar të aktivit përkatës pas investimeve të kryera.

Emërtimi i rikonstruksionit	**Vlera**
Projekt preventiv dhe preventiv përfundimtar për objektin punime riparimi ne shkollat e bashkisë	494,525
Hidroizolim rikonstruksion shkolla 9 vjeçare	11,628,058
Mbikëqyrje shkolla 9-vjecare	112,028
Super vizim Rikonstruksion shkolla "H B"	1,297,151
Rikonstruksioni I shkollës "H B"	72,193,286
Kolaudim riparim shkolle lyerje dyer e dritare	3,655
Kolaudim merememetim shkolla 9- vjeçare	16,132
Kolaudim rikonstruksion shkolla "H B"	42,211
Shuma	**85,787,046**

Konstatim:
1.Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" gjatë vitit 2025 rezultoi se janë kontabilizuar dhe kapitalizuar në këtë llogari tre zëra shpenzimesh për investime nga ana e Bashkisë Selenicë në shumën **132,718,570 lekë**, për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilat nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie. Më hollësisht,
- Në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione", Bashkia ka të evidentuar objekt të cilat janë të pa analizuara. Kështu, zëri **"**Përmirësimi i banesave ekzistuese/ndërtimi i ri për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara" për 5 kontratat është në vlerën prej 109,850,069 lekë dhe i pa detajuar.
Nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit janë kryer kontabilizimet për investimet në zërin "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete te varfra dhe të pa favorizuara" në Gr.4, kap 01, llog 231, kod programi 6190 për pjesën e financuar nga transferta *(urdhër shpenzimi nr. 707 datë 24.12.2025 për 8,831,598 lekë* ; *urdhër shpenzimi nr. 740, datë 31.12.2025 për 9,310,000 lekë* etj.,) dhe Gr.17, kap 01, llog 604, kod programi 10910 për pjesën e projektit me bashkëfinancim të mbuluar nga të ardhurat e veta *(urdhër shpenzimi nr. 700, datë 10.12.2025 për 3,842,127 lekë etj).*
Edhe për investimet për zërin "Rikualifikim urban pallateve në hyrje të Selenicës", pagesa e situacioneve dhe faturave të OE është kryer nga llogaria ekonomike 231, kod programi 1110.
Më hollësisht ,

- Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete te varfra dhe të pa favorizuara në shumën 109 850,069 lekë;
- Rikualifikim urban pallateve në hyrje të Selenicës, me vlerën gjithsej 20,469,146 lekë;
- Rikualifikim urban ne sheshin Vajzë në shumën 2,399,351 lekë

Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Selenicë**.** Këto zëra shpenzimesh në 3 (tre) raste janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën 132,718,570 lekë.

Këto regjistrime nuk plotësojnë kërkesat e pikës 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale", i përmirësuar, *"Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që: (a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t"ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël".*

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me paragrafin 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) i përmirësuar dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

2. Nga auditimi konstatohet se, një pjesë e objekteve ndërtimore janë të trashëguara dhe të mbartura nga ish/komunat në periudhat raportuese para vitit 2015 dhe të pa shoqëruara me kartelat përkatëse të objekteve.

- Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk është bërë një pasqyrim real dhe i drejtë në lidhje me vlerën e objekteve dhe gjendjen e tyre, pasi në shumicën e rasteve aty janë pasqyruar vetëm investimet e kryera gjatë viteve të fundit, dhe se në fakt vlerat e tyre janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të shkuara (para vitit 2000) dhe kjo tregon për mospërputhje të gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me dokumentacionin financiar pasi informacioni kontabël nuk pasqyron gjendjen reale të këtyre pasurive.

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** më datën 01.01.2025, janë kontabilizuar në vlerën neto 1,717,432,478 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,717,432,478 lekë, pakësime 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,089,453,490lekë. Më datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet sipas kostos historike 3,101,795,600 lekë dhe sipas vlerës neto 2,012,342,110 lekë

213	Rruge, rrjete, vepra ujore	3,101,795,600	2,701,388,628

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

Analiza e detajuar e llogarisë 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", më datë 31.12.2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.48, *lëvizjet në llog 213* Në lekë

Referenca	**Nr.**		**Llog.213**
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	2,701,388,628
	2	Amortizim i akumuluar	983,956,150
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	1,717,432,478
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	1,717,432,478
	5	Amortizim i shtesës	105,497,340
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike 31.12.25	3,101,795,600

	5	Amortizim i akumuluar	1,089,453,490
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	2,012,342,110

1. ***Aktivet e ujësjellës kanalizimeve, të kontabilizuara në llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellësa", rezultojnë të pa transferuara tek ShRUK Vlorë nga ana e Bashkisë Selenicë.***

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellës", rezulton së nuk janë transferuar për llogari të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime (SHRUK) Vlorë nga ana e Bashkisë Selenicë 17 zëra të lidhura me ujësjellës-kanalizimet, (që i përkasin lëvizjeve të v.2025) që janë regjistruar në kontabilitet me dt. 31.12.2025 në llogarinë 213, me koston historike prej 181,680,672 lekë, si më poshtë:

Tabela nr.49, Aktive të pa transferuara për SHRUK Vlorë

	Rikonstruksion Ujësjellësi Vodicë	6,861,000
1.	Kolaudim rikonstruksion ujësjellësi Vodicë	39,039
2.	Ndërtim Kuz Mesarak	23,891,880
3.	Supervizimi rehabilitimi i kanaleve te ujërave te zeza Mesarak	448,118
4.	Ndërtim Kuz Picar	28,766,000
5.	Mbikëqyrje Kuz Picar	757,430
6.	Kolaudim Kuz Picar dhe Kuz Mesarak	205,494
7.	Rehabilitim i rrjetit sekondar Lubonje, Picar, Armen	97,650,810
8.	Mbikëqyrje Rehabilitim i rrjetit sekondar Lubonje, Picar, Armen	1,598,619
9.	Kolaudim kanale Lubonjë, Picar, Armen	265,905
10.	Rehabilitimi i kanalit Gjorem	18,206,800
11.	Mbikëqyrje rehabilitim kanali Gjorem	333,000
12.	Rehabilitimi i kanalit Mesaplik Lepenice, Drashovice	7,779,120
13.	Supervizim kanali Mesaplik	45,182
14.	Projekt preventiv i kanaleve te dyta Lubonje, Picar, Armen	899,999
15.	Projekt ndërtimi i rrjetit te kanalizimeve te ujërave të zeza në fshatin Mesaplik	270,000
16.	Projekt ndërtimi i rrjetit te ujërave të zeza Picar	240,000
17.	Ndërtimi i rrjetit te kanalizimeve të ujërave te zeza	283,276
	shuma	181,680,672

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice

Në inventarin e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultojnë gjithë lisat e objekteve në vlerën sipas kostos historike 181,680,672 lekë, të cilat janë asete të SHRUK Vlorë. Nga ana e Drejtorisë se Shërbimeve Financiare dhe Arkiv protokollit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale UK Vlorë Sha", në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" Kreu II, pika 14; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, dhe VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat, me vullnet të lirë, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, marrin masa për transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike të shoqërive aksionare ekzistuese te SKP-ja e krijuar me marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe planin kombëtar të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për riorganizimin e shoqërive ujësjellës kanalizime. Transferimi i veprimtarisë së parashikuar në këtë pikë bëhet me akt noterial, sipas formatit të parashikuar në

lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili, pas nënshkrimit nga shoqëritë përkatëse, bëhet pjesë e pasqyrave financiare dhe mbahet nga pala që i ka kaluar transferimi.
dhe lidhjes nr.3, të këtij vendimi, që parashikon "Objektin e kontratës"

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune",** më datë 31.12.2025 pasqyrohet në vlerën neto 5,815,378 lekë ndërsa në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 7,651,813 lekë.

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2025, pasqyrohet në Bilanc me kosto historike 87,868,251 lekë dhe në vlerën neto 39,845,571 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa 9,960,000 lekë dhe 0 pakësime dhe amortizim të akumuluar në vlerën 57,817,794 lekë. Më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 40,010,457 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2025, paraqitet në vlerën neto 18,111,165 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,142,980 lekë, pakësime në vlerën 1,304,970 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 48,597,200 lekë. Nga auditimi, më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet me kosto historike 65,506,543 lekë dhe në vlerën neto 16,909,343 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr.50, *lëvizjet në llog 218* Në lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	63,668,533
	2	Amortizim i akumuluar	45,557,368
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	18,111,165
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	3,142,980
	5	Amortizim i shtesës	4,344,802
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	1,304,970
	7	Amortizim nga pakësimet	1,304,970
	4	Kosto historike	65,506,543
	5	Amortizim i akumuluar	48,597,200
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	16,909,343

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

- **Llogaria 24 "Aktive të dëmtuara"** më datën 01.01.2025, ka rezultuar sipas kostos historike 0 lekë dhe sipas vlerës neto 0 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime.
Konstatim: Nga auditimi i procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve u konstatua se njësia shpenzuese Bashkia Selenicë ka kryer procesin e inventarizimit, *ka kryer procesin e vlerësimit të aktiveve dhe të nxjerrjes jashtë përdorimit e asgjësimin të aktiveve të dëmtuara e që janë jashtë funksionit.* Vlerësimi i gjendjes faktike të aktiveve ka për qëllim arritjen e qëllimeve të pikës 23/d, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011
"Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kritereve të këtij udhëzimi"
si dhe pika 74: *Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.*

Aktivet financiare.

- Llogaritë e aktiveve afatgjata financiare paraqiten në vlerën 0 lekë në fillim dhe në fund të vitit 2025. Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", rezultoi se më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 0 lekë.

Llog	**emërtimi**	**2025**	**2024**
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
25	Huadhënie e Nën huadhënie		
26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0	0

Llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datën 31.12.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë.
a. Nga auditimi rezultoi se në datën 20/09/2023 është krijuar "Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a", e cila është regjistruar me datë 02/10/2023 me 4 aksionerë, 3 prej tyre nga organet e vetëqeverisjes vendore, me Nipt M.....E.
Referuar Statutit të "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a" dhe Akt Marrëveshjes, (protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 1542 prot, datë 13.07.2023), është krijuar Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta (SKP), shoqëri e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkive, aksionarë të saj. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkive është:

a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
d) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
e) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Në nenin 6, "Kontributi i palëve" të kësaj Marrëveshjeje, përcaktohet se Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 10,000,000 lekë dhe është i ndarë në 100.000 aksione me vlerë nominale 100 lekë secili"
Pika nr.2 e Statutit përcakton ndarjen e kuotave të aksioneve, "Aksionet zotërohen nga aksionaret:

- ✓ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zotëron 51.000 copë aksione me vlerë totale prej 5.100.000 lekë, ekuivalent në masën 51% te kapitalit themeltar;
- ✓ Bashkia Vlorë zotëron 41,350 copë aksione, ekuivalent në masën 41.35 % të kapitalit themeltar;
- ✓ Bashkia Himarë zotëron 4,600 copë aksione ekuivalent në masën 4.6 % të kapitalit themeltar
- ✓ Bashkia Selenicë zotëron : 3,050 copë aksione me vlerë totale prej 281,000 ekuivalent në masën në masën 3,05 % të kapitalit themeltar;

Edhe në ekstraktin historik të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a", përqindja e pjesëmarrjes në kapital e kësaj Bashkie është: 3,05 % të kapitalit themeltar
Vlera e aksioneve të Shoqëria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Selenicë, pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë me Nipt me Nipt M ....E. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia sipas Marrëveshjes "Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a është (3.05% * 10,000,000 lekë) = 305,000 lekë).

Konstatim:

- Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të llogaridhënës vjetore, vlera e kësaj llogarie, në fund të vitit 2025 është 0 lekë dhe është nënvlerësuar në shumën 305,000 lekë, e përbërë nga aksionet e Bashkisë në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a" prej 305,000 lekë.

Mos pasqyrimi i aktiveve financiare në kontabilitet, është veprim në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje", pika nr. 17:
Në lidhje me interesin e tij në një aktiv të kontrolluar bashkërisht, një sipërmarrës do të njohë në pasqyrat e tij financiare: (a) pjesën e tij në aktivet e kontrolluara bashkërisht, të klasifikuara sipas natyrës së tyre; (b) të gjitha detyrimet që ai ka krijuar; (c) pjesën e tij në çdo detyrim të krijuar së bashku me sipërmarrësit e tjerë në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët; (d) të ardhurat nga shitja ose përdorimi i pjesës së tij në prodhimin e sipërmarrjes së përbashkët, së bashku me pjesën e tij në çdo shpenzim të bërë nga sipërmarrja e përbashkët; dhe (e) shpenzimet që ai ka kryer në lidhje me interesin e tij në sipërmarrjen e përbashkët.
Kreun I, pika 3.1."Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paragrafi nr. 31, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, ku përcaktohet që:

31. Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, ***njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të analizojnë e të rakordojnë investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike).*** Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar, si më poshtë vijon: a) Në momentin fillestar të pjesëmarrjes me kapitalin e vet (krahas veprimit për konstatimin dhe pagimin e këstit të pjesëmarrjes) të kryhet edhe regjistrimi kontabël, ku: - Debitohet llogaria 26, "Pjesëmarrja me kapitalin e vet"; dhe - Kreditohet llogaria 1011, "Shtesa të fondit bazë".

dhe paragrafi nr.62, Rubrika II e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: - Nënrubrika e aktiveve afatgjata jomateriale, që përfshin studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme; - Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore etj.; *- Nënrubrika e aktiveve afatgjata financiare, që përfshin huadhënie dhe pjesëmarrje në kapitalin e vet;* dhe - Nënrubrika e investimeve, që përfshin aktivet në proces për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

4. Investimet.

Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 "Investime", pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksionim dhe nuk është kapitalizuar.

Llogaria 231 "Investime për aktive afatgjata materiale" më datën 31.12.2025, paraqitet në bilanc në vlerën 217,926,232 lekë.

231	Investime për Aktive Afatgjata materiale	217,926,232	451,809,109

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

230 "Për aktive afatgjata materiale"	
Çelje e vitit 2025	451,809,109
Shtesa (D)	151,242,348
Pakësime (K)	385,125,225
Gjendja debitore në 31.12.2025	**217,926,232**

Tabela nr.50, *lëvizjet në llog 231* Në lekë

Nr	Për aktive afatgjata materiale	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
1.	Përmirësimi I banesave ekzistuese për komunitetin e varfër dhe te pafavorizuar2023-2024	24,053,036		24,053,036	
2.	Përmirësimi i banesave ekzistuese viti 2024-2025	21,774,793	21,968,571		43,743,364
3.	Hidrizolim rikonstruksion shkolla 9 vjeçare	11,628,058		11,628,058	
4.	Mbikëqyrje shkolla 9-vjecare	112,028		112,028	
5.	Rikonstruksion shkolla 9 vjeçare "D e P"	44,909,091	21,052,631		65,961,722
6.	Supervizim Rikonstruksion shkolla "H B"	1,297,151		1,297,151	
7.	Rikonstruksioni I shkollës "H B"	72,193,286		72,193,286	
8.	Kolaudim riparim shkolle lyerje dyer e dritare	3,655		3,655	
9.	Rikualifikim urban ne sheshin Vajze	2,399,351		2,399,351	
10.	Supervizim sheshi vajze	44,641		44,641	
11.	Kolaudim sheshi Vajze	9,672		9,672	
12.	Ndërtim rruge e rrugica me beton	27,324,360		27,324,360	
13.	Rehabilitim rruge te brendshme me beton	3,317,248		3,317,248	
14.	Supervizim rruge me beton	210,208		210,208	
15.	Sistemim asfaltim rruga Kropisht	1,129,921		1,129,921	
16.	Asfaltim rruge te brendshme Kocul	12,500,000		12,500,000	
17.	Mbikëqyrje asfaltim rruge te brendshme Kocul	300,000		300,000	
18.	Rehabilitim rruge te brendshme lagjja Tubo	7,500,000		7,500,000	
19.	Rikonstruksion Ujësjellësi Vodicë	6,861,000		6,861,000	
20.	Kolaudim rikonstruksion ujësjellësi Vodicë	39,039		39,039	
21.	Ndërtim Kuz Mesarak	23,891,880		23,891,880	
22.	Ndërtim Kuz Picar	28,766,000		28,766,000	
23.	Mbikëqyrje Kuz Picar	757,430		757,430	
24.	Kolaudim kuz Picar dhe Kuz Mesarak	205,494		205,494	
25.	Rehabilitim I rrjetit sekondar Lubonje, Picar, Armen	97,650,810		97,650,810	
26.	Mbikëqyrje Rehabilitim i rrjetit sekondar Lubonje, Picar, Armen	1,598,619		1,598,619	
27.	Kolaudim kanale Lubonjë, Picar, Armen	265,905		265,905	
28.	Rehabilitimi i kanalit Gjorem	18,206,800		18,206,800	
29.	Mbikëqyrje rehabilitim kanali Gjorem	333,000		333,000	
30.	Rehabilitimi I kanalit Mesaplik Lepenice, Drashovice	7,779,120		7,779,120	
31.	Supervizim kanali Mesaplik	45,182		45,182	
32.	Trajtim rrëshqitje fshati Peshkëpi	11,913,750		11,913,750	
33.	Mbikëqyrje trajtim rrëshqitje rruga Peshkëpi	141,522		141,522	
34.	Kolaudim trajtim rrëshqitje rruga Peshkëpi	21,177		21,177	
35.	Mirëmbajtje kanale	1,149,100		1,149,100	
36.	Rehabilitim e mbrojtje nga përroi Otim	21,476,782		21,476,782	
37.	Përmirësimi banesave ekzistuese2025-2026		19,096,419		19,096,419
38.	Rikualifikim urban i pallateve në hyrje te Selenicës		20,469,146		20,469,146
39.	Ndërtim Terrene sportive		36,228,480		36,228,480
40.	Rik. I shkollës 9 vjeçare "T.K"		31,456,460		31,456,460
41.	Mbikëqyrje shkolla "T.K"		275,505		275,505
42.	Mbikëqyrje shkolla "Dëshmoret e Peshkëpisë"		695,136		695,136
	Totali	**451,809,109**	**151,242,348**	**385,125,225**	**217,926,232**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice

Konstatim:

Investimet përbëhen nga 231 *"Investime Për aktive afatgjata materiale"* në shumën 217,926,232 lekë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kjo llogari si kundërparti të saj ka llogaritë 105 dhe 106 dhe 115 të fondit të konsoliduar. Nga auditimi konstatohet se llogaria 105 "*Teprica e granteve kapitale të brendshme*"+ llog 106 *"Nga grantet e Jashtme kapitale"* + llog. 115 *"Nga Fondet e veta te investimeve",* në fondin e konsoliduar (Formati F4 Aktivet Neto/Fondet Neto) pasqyrohet përkatësisht, (në shumën 182,646,632 + 0 + 35,279,600) = shumën 217,926,232 lekë, *e kuadruar* me tepricën debitorë të llogaris 231.

Investime në proces janë 46 projekte, për të cilat një pjesë e madhe e tyre e kanë humbur kuptimin e mbajtjes së tyre si investime në proces pasi ato janë të përfunduara dhe në përdorim nga bashkia për të cilat janë edhe akt-marrjet e përkohshme dhe që nuk janë kapitalizuar.

Tabela nr.51, *Lista e aseteve në dorëzim të përkohshëm* Në lekë

Nr.	Objekti	Data e lidhjes se kontratës	Vlera kontratës
1	Përmirësim i shtresave rrugore të Fshatrave të Bashkisë Selenicë (Minikontrata 1)		47,228,616.00
2	Rehabilitim e mbrojtje nga përroi Hotim (fatkeqësi natyrore te menaxhuara)	10/24/2024 12:00:00 AM	48,954,264.45
3	sistemim dhe Asfaltim rruge Karbunar	12/17/2024 12:00:00 AM	34,000,000.00
4	Rehabilitim i Rrugës Lagja 'T Selenice	8/9/2024 12:00:00 AM	15,505,166.00
5	Përmirësimi i rruge dhe rrugicave me beton (ne bashkëpunim me FSHZH)	4/22/2024 12:00:00 AM	16,654,085.60
6	Rikonstruksion i shkollës T.K	2/26/2025 12:00:00 AM	39,125,301.00
	shuma		201,467,433.05

Bashkia Selenicë, Drejtoria e Planifikimit te Territorit, Midisit dhe investimeve

Konstatim:

Këto asete të cilat janë në përdorim por kontabilisht trajtohen si investime në proces, janë përjashtuar nga amortizimi që u ndodh atyre për shkak të përdorimit. Duke i përjashtuar nga amortizimi, vlera e këtyre aseteve nuk është vlera e drejtë e tyre në momentin e kapitalizimit të tyre. Moskapitalizimi i shumës **201,467,433.05 lekë** për efekt të llogaritjes së amortizimit deformon pozicionin financiar të bashkisë dhe nuk jep informacion kontabël të drejtë dhe të saktë. Nga auditimi i llogarisë analitike *"Investime për aktive afatgjata materiale"* konstatohet mos kapitalizimi e investimeve të cilat janë në përdorim dhe me certifikata të përkohshme, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, pika 36 e cila përcakton se:

"Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, deri në daljen e dispozitave ligjore të veçanta për sektorin publik, amortizimi vjetor i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara në legjislacioni fiskal përkatës, si më poshtë vijon: Për aktivet afatgjata materiale si ndërtesat, konstruksionet, ..., duhet të zbatohet norma 5%, duke i llogaritur veçmas me vlerën e mbetur;"

Aneksi 1, Klasa 2 *"Aktivet Afatgjata" (Përbërja dhe trajtimi kontabël) ...*

"Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto bëhen funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 e 21 të aktiveve të përfunduara".

Efektet e konstatimeve të mësipërme në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i mosaplikimit të normës së saktë të amortizimit dhe kontabilizimeve të gabuara japin pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të pozicionit financiar. Në kuadër të Raportimit Financiar nuk ka gjetur zbatim paragrafi 15 i SNK 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*, paragrafi 27 i SNKSP 1 *"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"*. Gjithashtu paraqitja në këtë mënyrë e veprimeve kontabël nuk mbështetet në parimet bazë të kontabilitetit publik sipas Udhëzimi të MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Selenicë më datën 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.

Tabela nr.51 Të dhënat mbi llogaritë e pasiveve afatshkurtër në lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/ Ndryshimi
	I. Pasivet Afat shkurtra	**418,195,211**	**409,738,242**	**8,456,969**
	1. Llogari te Pagueshme	**111,784,776**	**103,327,807**	
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	8,490,548	3,917,445	
42	Detyrime ndaj personelit	17,482,096	15,092,574	
16,17,18	Hua Afat shkurtra			
460	Huadhënës			
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,178,867	1,498,845	
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal			
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore			
435	Sigurime Shoqërore	4,974,682	4,550,068	
436	Sigurime Shëndetësore	687,689	628,080	
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore			
44	Institucione te tjera publike			
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike			
464	Det. Për tu paguar për bl.letrave me vlere			
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	47,110,885	34,220,216	
467	Kreditore te ndryshëm	30,860,009	43,420,579	

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** më datë 31.12.2025, është në vlerën 8,490,548 lekë, e cila paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Selenicë, ku janë përfshirë detyrimet pe pa paguara për blerje gazoili, balestër kamioni, vlera e situacioneve apo projekt preventivave dhe mbikëqyrjes etj.

Lekë

Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"	
Çelje e vitit 2025	3,917,445
Shtesa (K)	4,573,103
Pakësime (D)	
Gjendja në 31.12.2025	**8,490,548**

Tabela nr.52 Të dhënat mbi llogaritë e pasiveve afatshkurtër në lekë

Nr.	Subjekti	Emërtimi i mallrave	Numri i faturës	Datë	Vlera
1	P.B	Blerje balestër kamioni	97	20,000	20,000
4	E. Z	Blerje materiale	13	54,500	17,006
8	D. G	Blerje vaj motori	28	5,129	5,129
10	A G	Diference fature		600	600
21	F.Shpk	Blerje gazoil	3	834	834
28	S A	Blerje gazoili	90	860,799	860,799
29	S A	Blerje gazoili	135	1,243,040	1,243,040
30	S A	Blerje gazoili	170	1,527,336	1,527,336
33	T.M	Blerje gazoil		300	300
62	C.G	Studim projektim I ujësjellësit Peshkëpi Kocul	45	24.02.2020	98,400
67	B.	Rehabilitimi i kanali Gjorem	23	24.04.2023	1
69	C.G	Hartim projekti shkolla 9-vjecare T. Koceli	43	20.12.2023	144,000
73	I-E	Shërbim inxhinierie kolaudim rehabilitim i rrugës lagjja Tubo	2	03.04.2025	29,717
74	R 95	Mbikëqyrje shkolla Dëshmoret e Peshkëpisë	93	23.12.2025	173,784
75	C.hpk	Rikualifikim urban ne hyrje te qytetit Selenice	40	19.12.2025	4,000,000

76		Mbikëqyrje ndërtim terrene sportive	45	29.12.2025	369,602
Totali					**8,490,548**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenicë

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 17,482,096 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2025 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	**15,092,574**
Shtesa (K)	193,848,673
Pakësime (D)	191,459,151
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**17,482,096**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026, konstatohet se janë kryer këto likuidime të detyrimeve për personelin:

Tabela nr.53 Të dhënat mbi kalimet në thesar 2026 llog.42 në lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	**Datë**	**Vlera**
17	06.01.2026	97,361
18	06.01.2026	211,774
19	06.01.2026	119,874
20	06.01.2026	1,522,884
21	06.01.2026	233,174
22	06.01.2026	552,848
23	06.01.2026	124,126
24	06.01.2026	429,776
25	06.01.2026	50,612
28	06.01.2026	12,471,921
150	27.03.2026	1,667,746
Totali		**17,482,096**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice, Banka Janar 2026

- **Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa",** paraqitet në vlerën lekë 2,178,867dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor.

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	1,498,845
Shtesa (K)	19,233,720
Pakësime (D)	18,553,698
Gjendja në 31.12.2025	2,178,867

Konkretisht, sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se janë kryer këto pagesa për këtë kategori detyrimesh:

Tabela nr.54, Të dhënat mbi kalimet në thesar 2026 llog.431 në lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	**Datë**	**Vlera**
52	06.02.2026	1,398,724
53	06.02.2026	147,953
Totali		**1,546,677**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice

- **Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit 2026 dhe janë përkatësisht në vlerat 4,974,682 lekë

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	4,550,068
Shtesa (K)	57,840,931
Pakësime (D)	57,416,317
Gjendja në 31.12.2025,	**4,974,682**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Tabela nr.55, Të dhënat mbi kalimet në thesar 2026 llog.435 në lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	**Datë**	**Vlera**
1	06.01.2026	147,706
2	06.01.2026	325,587
3	06.01.2026	20,296
4	06.01.2026	98,337
5	06.01.2026	13,012
6	06.01.2026	297,714
7	06.01.2026	197,160
8	06.01.2026	93,295
9	06.01.2026	75,950
10	06.01.2026	395,019
11	06.01.2026	619,618
12	06.01.2026	200,768
13	06.01.2026	2,284,230
14	06.01.2026	107,744
15	06.01.2026	98,246
Totali		**4,974,682**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice, Banka Janar 2026

- **Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 687,689 lekë.

Lekë

Llogaria 436 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	628,080
Shtesa (K)	7,998,824
Pakësime (D)	7,939,215
Gjendja në 31.12.2025	**687,689**

Konkretisht, sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Tabela nr.55 Të dhënat mbi kalimet në thesar 2026 llog.436 në lekë

Urdhër shpenzimi		
Nr.	**Datë**	**Vlera**
1	06.01.2026	20,498
2	06.01.2026	45,182
3	06.01.2026	2,816
4	06.01.2026	13,646
5	06.01.2026	1,806
6	06.01.2026	34,312
7	06.01.2026	27,362
8	06.01.2026	12,948
9	06.01.2026	10,542
10	06.01.2026	54,814
11	06.01.2026	85,986
12	06.01.2026	27,862
13	06.01.2026	321,325
14	06.01.2026	14,954

15	06.01.2026	13,636
Totali		**687,689**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice, Banka Janar 2026

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Selenicë në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 47,110,885 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2025	34,220,215
Shtesa (K)	14,015,211
Pakësime (D)	1,124,541
Gjendja debitore në 31.12.2025	**47,110,885**

Tabela nr.56 Llogaria 466 "Kreditor për mjete në ruajtje", dt 31.12.2025 në lekë

Nr.	Objekti	Subjekti	Vlera	Ka kaluar afati (Po / Jo)
1	B		568,499	
2	Rehabilitimi i qendrës B	J.Shpk	1	
3	Rik Ujësjellësi Romes	E&d	158,552	
4	Rik Rruga Romes Karbunar	Xh.K	599,533	
5	Q. Shëndetësore Sevaster	R.Shpk	118,976	
6	Ujësjellësi Golimbas	B.Shpk	334,937	
7	Rruga Ploce Amonice	P. Shpk	413	
8	Ujësjellësi Sevaster Amonice	B.K	899	
9	Pa Origjin		80,222	
10	Ndërtimi Rruga Vajze	C	19,775	
11	Qendra Shëndetësore Kote	T	49,494	
12	Ndërtim Ura Vodice	S	1	
13	KUZ Drashovice	2z.K	57,099	
14	Pa origjin		15,750	
15	Ndërtim & Konstruksion Rr Vllahin	B. K	338,229	
16	Sistemim I Qendrës Vllahinë	Bi. K	1,499,944	
17	Ambiente çlodhës Peshkepi Vllahin	A. Shpk	72,120	
18	Rik Shkollës 9 Vjeçare Vllahin	A.Shpk	363,210	
19	Biznese te mbyllura te pa likuiduara	Mbyllura	492,727	
20	Rik Rruga Danaj & Perroi	GJ.P.	37,343	
21	Furnizim & Vendosje pompe	M.G.	83,880	
22	Blerje Auto veturë	Hy	50,000	
23	Blerje projekti	N.Shpk	138,005	
24	Rehabilitimi i sistemit te ujitjes	A	1	
25	Mirëmbajtja e rrugëve me rrere bituminoze	SH 07	441,000	
26	Blerje ekskavator me zinxhirë	Ministria	452,760	
27	Studim projektim i rrugës Treblove - Peshkepi	C.G	108,000	
28	Blerje automjet C.Shpk	C.	83,700	
29	Riparim pompa Lubonjë	S.	61,480	
30	Riparim pompa Mavrovë	M.G	95,940	
31	Blerje automjet me zinxhirë & goma	C.Shpk	527,950	
32	Rrjet shpërndarës furnizimi me ujë fshati Kote	S	-	
33	Riparim i stacionit te ujit te pijshëm Armen	A	22,350	
34	Mirëmbajtje e rrugëve te fshatrave	B-93	90,410	
35	Rehabilitimi I kanalit vaditës Dushkarak & pompa Shkoze I.C.C G	ICC.G	-	
36	Sistemim asfaltim i rrugës Treblov -Peshkepi	B-93.S.	91,859	
37	Rrjet shpërndarës njësia Kote, Sevaster, Brataj	S	-	
38	Rehabilitimi i rrjetit ujitës Pete dega Drashovice	S	300,000	
39	Rehabilitim i kanalit Vaditës & pompa Dushkarak	ICC.G	-	
40	Sistemim asfaltim shkolla e mesme qendër	B.II	-	
41	Rehabilitim i rrjetit ujitës rezervuari Pete-Mavrove	Sh	925,456	
42	Ndërtim ure ne Fshatin Mallkeq	A 2CO	142,155	
43	Rikonstruksion i sistemit te pompimit Selenice	M.G.Shpk	94,100	
44	Rehabilitimi i qendrës Brataj	J	140,350	
45	Blerje ekskavator	C.shpk	18,050	
46	Rikonstruksion rrjet shpërndarës Selenice, Kote, Armen	B-93.S.	-	

47	Rehabilitimi i rrjetit ujitës Fushe-Shkoze Sevaster, Golimbas	I.G	-	
48	Rehabilitimi I pjese se pare rrjetit ujite Harvala	2.K	-	
49	Riparim ujësjellësi	J	-	
50	Sistemin asfaltim lagjja tubo-Romes	J	-	
51	Rehabilitim Ura Brataj	A2CO	98,400	
52	Riparimi i shkarkuesit te rezervuarit te harvalas	2.K	-	
53	Përmirësimi i kushteve te banimit për komunitetin e pa favorizuar	Jo	747,651	
54	Rehabilitimi i kanalit Hasomat	K	-	
55	Riparim emergjent për kanalin Mesaplik	IccG	388,956	
56	Rikonstruksion rruga fshati Kropisht	A.Shpk	726,496	
57	Rruge te brendshme me beton	Asi 2CO	1,542,642	
58	Rruge te brendshme me beton	Sh	373,576	
59	Kanale vaditëse Lubonje, Picar, Armen	M. G	2,441,271	
60	Kanale vaditëse Lubonje, Picar, Armen	I.G	2,441,271	
61	Rikonstruksion Shkolla "Hajredin Beqari"	B	3,489,365	
62	Ndërtim Kuz Picar	Sh 07	1,438,300	
63	Ndërtim Kuz Mesarak	She	1,194,594	
64	Ndërtimi i kanalit të ujërave te zeza Hastane Kote	ICC.G	-	
65	Riparime te ndryshme ne shkolla	M.K	88,916	
66	Rehabilitimi i kanalit vaditës Gjorem	B.C	905,340	
67	Rikualifikim urban ne sheshin Vajze	R.C	719,806	
68	Përmirësimi I bansave per komunitetin e varfer te pa favorizuar	A.A	-	
69	Merematim hidroizolim shkolla mesme	A.A	-	
70	Trajtim rrëshqitje Peshkepi	C	-	
71	Merematim hidroizolim shkolla 9-vjecare	A.C	581,403	
72	Përmirësimi i banesave per komunitetin e varfer te pa favorizuar	Kth	1,292,359	
73	Asfaltim rruge te brendshme Kocul	Sh 07	1,804,585	
74	Përmirësimi i banesave për komunitetin e varfër te pa favorizuar	AAv	-	
75	Riparim ujësjellësi Vodice	A. Co	28,577	
76	Rikonstruksion shkolle 'Dëshmoret e Peshkepise"	2A Co	3,298,087	
77	Rehabilitim e mbrojtje nga përroi Hotim	A.C	2,937,256	
78	Rehabilitim mirëmbajtje kanale ne njësitë administrative	C	57,445	
79	Përmirësimi I banesave per komunitetin e varfër te pa favorizuar	B	2,389,386	
80	Rehabilitim lagjaj Tubo	A Av	930,310	
81	Përmirësimi I shtresave te rrugëve te fshatrave	RSM	1,016,893	
82	Sistemim asfaltim rruga Karbunar	Sh 07	2,039,966	
83	Rikonstruksion shkolla T.K	I.Shpk	1,572,823	
84	Përmirësimi I banesave ekzistuese 2025-2026	C.K	954,821	
85	Ndërtimi i terreneve sportive Armen ,Sevaster,Vllahine	G	1,811,424	
86	Rikualifikim urban i pallateve ne hyrje	C	1,023,457	
			100,339	
Totali			**47,110,885**	

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice

- Për 86 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Selenicë janë ngurtësuar fonde në vlerën 47,110,885 lekë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Vlorë

Konstatim: Në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025, gjendja e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", është për vlerën kontabël 47,110,885 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 86 raste ngurtësimesh. Deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është bërë çlirimi i garancive për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Selenicë në vlerën **28,978,678 lekë** për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës**.** nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Vlorë. *Në tre raste shumat e kontabilizuara në këtë llogari janë pa origjinë***.**

Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare Arkiv Protokollit, si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Investimeve. nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 6 dhe 10:
Sa më sipër, analiza e llogarisë 466 "Kreditorë për mjetet në ruajtje" evidenton shuma të ngurtësuara që nga viti 2016 e në vijim, pa ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore në fuq. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 6:
"6. Zhbllokimi i garancisë së kontratës 10 për qind të bëhet pasi të jetë përfunduar plotësisht kolaudimi i punimeve, ndërsa 5 për qind i garancisë së punimeve për periudhën pas kolaudimit zhbllokohet pas përfundimit të garancisë së objektit".
si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kapitulli III, pika 3.3, pikat 29, 30, 39, 50 dhe ku përcaktohet që:

Pika 29. Më pas, bëhen rakordimet përkatëse të aktiveve dhe të detyrimeve në të dhënat e sistemit të thesarit, duke u mbështetur në dokumentacionin kontabël të prodhuar dhe evidentuar çdo transaksion financiar apo ngjarje të ndodhur për periudhën raportuese.
Pika 30. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjorë, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet.
Pika 39. Këto pasqyra i'u dërgohen njësive të qeverisjes së përgjithshme të juridiksionit përkatës të degëve të thesarit, me qëllim përgatitjen dhe rakordimin e pasqyrave financiare të 10 njësisë me informacionin që gjendet në SIFQ. Në këtë mënyrë, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, rakordojnë të dhënat e tyre në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit ushtrimor që kanë përgatitur me pasqyrat e mësipërme të gjeneruara nga SIFQ-i.

- **Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm"** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2025, janë në vlerën në vlerën 30,860,009 lekë dhe me po të njëjtën vlerë është më datë 31.12.2025

Aktivet neto/fondet neto

- *Rakordimi Grupi "Aktivet neto/ fondet neto", në formatin F4 "Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto", me grupin C dhe D te formatit F1 "Pasqyra e pozicionit financiar" të llogaridhënies vjetore 2025:*

F1: "Pasqyra e pozicionit financiar":

C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**3,073,973,563**	**2,911,522,553**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**3,073,973,563**	**2,911,522,553**
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,628,406,427	2,254,584,317
12	Rezultatet e mbartura		
85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	227,640,904	205,129,127
111	Rezerva		

115	Nga Fondet e veta te investimeve	35,279,600	
15	Shuma te parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime		
105	Teprica e Grandeve kapitale Te Brendshme	182,646,632	451,809,109
106	Teprica e Grandeve kapitale Te Huaja		
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim		
109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata		
	Te Tjera		

Burimi: Bashkia Selenicë

F4 : "Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto"

Reference	E M E R T I M I	Grante Kapitale	Rezerva	Tjera te veta	Teprioce /Deficit e Mbartura	Teprioce/Deficit	Fonde/ Neto Aktive/neto
B	**c**	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**
101	**I.AKTIVET NETO/FONDET NETO**	**2,254,584,317**				**373,822,110**	**2,628,406,427**
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	**656,938,236**	**0**	**139,939,233**	**0**	**-351,310,333**	**445,567,136**
	1.NGA BURIME TE BRENDSHME	**656,938,236**	**0**	**139,939,233**	**0**	**-351,310,333**	**445,567,136**
105,	Nga garantët e brendshme kapitale(+)	451,809,109		203,230,395		-472,392,872	**182,646,632**
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)			2,027,160		-2,027,160	**0**
1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0					**0**
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	0			205,129,127	-205,129,127	**0**
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	205,129,127			-205,129,127	227,640,904	**227,640,904**
111	Nga Rezervat (+.-)	0					**0**
115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)			76,114,473		-40,834,873	**35,279,600**
15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvlerësime(+,-)						**0**
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)			-139828514		139,828,514	**0**
1015	Nga nxjerrjet jashteperdorimit dhe demtimet(-)			-1,604,281		1,604,281	**0**
107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne perdorim(+.-)						
109	Diferenca nga Rivleresimi I AAGJ(+,-)	0					**0**
	2.NGA BURIME TE JASHTME	0	0	0	0	0	0
106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	0					**0**
1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					**0**
	TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	**2,911,522,553**	**0**	**139,939,233**	**0**	**22,511,777**	**3,073,973,563**

Burimi i të dhënave: Bashkia Selenice

Nga auditimi i ndryshimeve që kanë ndodhur në aktivet neto gjatë periudhës ushtrimore 2025 nuk u konstatohen mosrakordime sipas llogarive:

- Për llogarinë 105 *"Nga grantet e brendshme kapitale (+)"* në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto/ aktiveve neto (formati F4) në fund të periudhës ushtrimore mbyllet me tepricë në shumën 182,646,632 lekë, si dhe në fondin e konsoliduar në pasqyrën e pozicionit financiar (formati F1) pasqyrohet në shumën 182,646,632 lekë, e rakorduar.
- Për llogarinë 101 *"*Teprica (Fondi i akumuluar) / Deficiti i akumuluar*"* në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto (formati F4) në fund të periudhës ushtrimore mbyllet me tepricë në shumën 2,628,406,427 lekë, ndërsa në fondin e konsoliduar në pasqyrën e pozicionit pasqyrohet në shumën 2,628,406,427 lekë, e rakorduar.
- Për llogarinë 85 *"Nga rezultatet e vitit ushtrimor"* në pasqyrën e ndryshimeve në fondet neto në fund të periudhës ushtrimore mbyllet me tepricë në shumën 227,640,904 lekë, ndërsa në fondin e konsoliduar në pasqyrën e pozicionit pasqyrohet në shumën 227,640,904 lekë, e rakorduar.

Veprimet e mësipërme janë në pajtueshmëri me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar, Aneksi 1.

Formati nr. 2, Pasqyra e performancës financiare:

Pasqyra e performancës financiare pasqyron në mënyrë të klasifikuar dhe strukturuar informacionin për të ardhurat, shpenzimet, transfertat dhe operacionet që lidhen me rezultatin financiar të periudhës ushtrimore të mbyllur të krahasuar me periudhën e vitit të mëparshëm.

Nga auditimi i gjendjes së llogarive në pasqyrën e performancës rezultoi se, konstatimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konform rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike ashtu edhe për ato analitike.

Totali i të ardhurave në Pasqyrën e Performancës Financiare është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit. Për vitin 2025 pasqyra paraqitet si më poshtë:

a- Të ardhurat (grupi A) = **757,462,125** lekë
b- Shpenzimet (grupi B) = **529,821,221** lekë
c- Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 227,640,904 lekë

Llogaria 85 *"Teprica ose deficiti i periudhës" në Pasqyrën e Pozicionit Financiar rakordon me vlerën e kësaj llogarie të shënuar në kolonën nr. 132 të Formatit nr. 2 "Pasqyra e Performancës Financiare"*.

Ndryshimi i gjendjes së llogarive të klasës 3 në Pasqyrën e pozicionit financiar në formatin F1 (diferenca midis tepricës më 31.12.2025 me 31.12.2024, përkatësisht 21,424,995 minus 29,047,769 lekë konstatohet vlera prej 7,622,774 lekë. Kjo vlerë konstatohet e barabartë me tepricën e llogarisë 63 *"Ndryshim i gjendjeve të inventarit"* në Pasqyrën nr. 2, *"Pasqyra performancës financiare"*.

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet",** në datën 31.12.2024, është regjistruar në vlerën **679,171,603** lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është **757,462,125** lekë, ose me një rritje në vlerën 78,290 mijë lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
A	**TE ARDHURAT**	**757,462,125**	**679,171,603**
70	***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET***	**79,000,734**	**76,719,433**
700	**1.Tatimi mbi te Ardhurat**	**73,847**	**250,000**
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		0
7001	Tatim mbi Fitimin		210,000
7002	Tatim mbi Biznesin e vogël	73,847	40,000
7009	*Te tjera Tatime mbi te ardhurat*		0
702	**2.Tatimi mbi Pasurinë**	**31,711,191**	**31,534,568**
7020	Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme	31,711,191	31,534,568
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë se paluajtshme		
7029	Te tjera tatime mbi Pasurinë		0
703	**3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**47,215,696**	**44,934,865**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		0
7031	Akciza		0
7032	Takse mbi shërbimet specifike		0
7033	Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		0
7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	47,215,696	44,934,865
704	**4.Takse mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Takse doganore për mallrat e importit		
7041	Takse doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarife shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Te tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	**5.Taksë e rrugës**		
708	**6.Te tjera Tatime e Taksa kombëtare**		
709	**7.Gjoba e Kamat vonesa**		

Burimi: Bashkia Selenicë

2. Të ardhurat jo tatimore:

- Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, janë regjistruar në vlerën 19,384,119 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë **24,295,542** lekë, ose me një shtim në vlerën + 4,911 mijë lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	***III.TE ARDHURA JO TATIMORE***	**24,295,542**	**19,384,119**
710	**1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**4,582,838**	**4,539,107**
7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare		0
7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	4,582,838	4,539,107
711	**2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare**	**19,712,704**	**14,845,012**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatorë	8,460,016	8,467,722
7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	10,653,028	3,396,356
7112	Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	310,000	1,604,680
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	289,660	1,376,254
7116	Te ardhura nga transferimi pronës, Legalizimi i ndërtimeve pa leje		
719	**3.Te tjera te ardhura jo tatimore**		

Burimi: Bashkia Selenicë

3. Grante korente:

- Llogaria 72 "Grante korente", në datën 31.12.2024, paraqitet në pasqyrën e performancës financiare për 583,068,051 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 525,151,194 lekë ose me një pakësim në vlerën -57,916 mijë lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	***V.GRANTE KORENTE***	**525,151,194**	**583,068,051**
720	**1.Grant korent i Brendshëm**	**525,151,194**	**583,068,051**
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)		
7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)	441,917,245	508,772,275
7202	Nga Buxheti për pagesa te posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	18,560,058	22,073,404
7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		0
7206	Financim I pritshëm nga buxheti	64,673,891	52,222,372
7207	Sponsorizojmë te brendshme(nga te trete)		0
7209	Te tjera grante korente te brendshme		
721	**2.Grant Korent i Huaj**	**0**	**6,209,249**
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	6,209,249

Burimi: Bashkia Selenicë

Konstatim: **Llogaria 721** ***"Grant korent i huaj"*** (planifikuar 5,209,249 lekë dhe realizuar në shumën 4,193,527 lekë, përfaqëson fonde nga organizatat e huaja për projektin "Iniciativat e Qëndrueshme për Selenicën – E C–K, me emërtim të llogarisë speciale "*P2R –Resilient Selenicë Initiative"*. Nga auditimi i pasqyrës së performancës financiare / seksionit të të ardhurave ***konstatohet se fondet nga "Grant korrent i huaj"*** **në shumën 4,193,527 lekë nuk është mbledhur me totalin e të ardhurave.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave me nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe*

raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, paragrafi 68:

"Të ardhurat paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së performancës financiare:
Totali i të ardhurave është i barabartë me shumën e totalit të të ardhurave nga taksat dhe tatimet, totalit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, totalit të të ardhurave jotatimore, totalit të të ardhurave financiare, totalit të granteve korrente, totali të të ardhurave të tjera si dhe ndryshimit të gjendjes së inventarit të produkteve."

Efekti në pasqyrën e performancës financiare në datën e mbylljes së pasqyrave financiare si rezultat i *mospasqyrimit të saktë të "Të Ardhurave" tregon një pasqyrim jo të drejtë dhe të saktë të "Të ardhurave të periudhës për njësinë",* duke i nënvlerësuar ato në shumën 4,193,527 lekë duke dhënë një rezultat periudhe të pa saktë.

4. Të ardhura të tjera:

- **Të ardhura të tjera** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 129,014,655 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2024
	VI. Të ardhura të tjera	129,014,655	**0**
	Tërheqje nga seksioni i investimeve	129,014,655	0

Burimi: Bashkia Selenicë

SHPENZIMET

Shpenzimet si pjesë e Pasqyrës së Performancës Financiare (F2)

Për artikujt buxhetorë të cilët kanë pasur nivel më të lartë mos realizimi *është bërë dhe një analizë më e detajuar në të cilën është identifikuar dhe përcaktuar devijimi në llogaritë përkatëse*, qoftë ky material nga ana cilësore apo nga ana sasiore. Auditimi është drejtuar edhe në përcaktimin e saktësisë së klasifikimit të zërave buxhetorë sipas realizimit dhe kryerja e testeve u orientua në krahasimin e situacionit faktik të realizimit të buxhetit të konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarin dhe databazës së publikuar të shpenzimeve të thesarit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nga të cilat nuk rezultuan devijime materiale. Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar akt-rakordimeve me thesarin .

Tabela nr. ..... Shpenzimet vjetore sipas zërave 2025 Në lekë

llog	Përshkrimi	31.12.2025	31.12.2024
B	**SHPENZIMET**	**529,821,221**	**474,042,476**
600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**233,127,307**	**187,062,325**
6001	Paga, personel I përhershëm	233,127,307	187,062,325
6002	Paga personel I Përkohshëm		
6003	Shpërblime		
6009	Shpenzime te tjera për personelin		
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**38,363,433**	**30,927,636**
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	34,458,173	27,779,212
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	3,905,260	3,148,424
602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**101,450,963**	**86,317,686**
602	Mallra dhe shërbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	2,911,600	5,707,819
6021	Materiale dhe shërbime speciale		
6022	Shërbime nga te trete	17,731,023	12,925,896

6023	Shpenzime transporti	26,215,267	21,847,848
6024	Shpenzime udhëtimi	362,706	58,580
6025	Shpenzime per mirëmbajtje te zakonshme	24,037,975	24,851,256
6026	Shpenzime per qiramarrje	844,100	882,000
6027	Shpenzime per detyrime per kompensime legale	3,589,522	2,967,988
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	25,758,770	17,076,299
603	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
6030	Subvecione për diference çmimi		
6031	Subvecione për te nxitur punësimin		
6032	Subvecione për te mbuluar humbjet		
6033	Subvecione për sipërmarrjet individuale		
6039	Subvecione te tjera		
	V.TRANSFERIME KORENTE	**156,879,518**	**183,667,640**
604	**1.Transferime korente te brendshme**	**4,738,573**	**9,195,050**
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	4,738,573	9,195,050
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurëse		
605	**2.Transferime korente me jashtë**	**0**	**1,000,000**
6051	Transferime Per Organizatat Ndërkombëtare		
6052	Transferime Per Qeveritë e Huaja		
6053	Transferime Per institucionet jo fitimprurese te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		1,000,000
606	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe**	**152,140,945**	**173,472,590**
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	152,140,945	173,472,590
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	**0**	**0**
65	**1.Shpenzime Financiare te brendshme**	**0**	**0**
650	Interesa per bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa per huamarrje te tj. Brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenz.nga kembimet valutore		0
66	**2.Shpenzime Financiare te jashtme**	**0**	**0**
660	Interesa per huamarrje nga Qeveri.te Huaja		
661	Interesa per financime nga Institucionet.nderkomb		
662	Interesa per huamarrje te tjera jashtme		
	VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA	**0**	**0**
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytezimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashtë përdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytëzimit		
686	Shuma te parashikuara per aktivet financiare		
63	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**7,622,774**	**-13,932,811**
	IX.SHPENZIME TE TJERA	**-7,622,774**	

Burimi: Bashkia Selenicë

- ***Shpenzimet e vitit 2025 analizuar kundrejt realizimit të tyre në v.2024:***

Duke iu referuar totalit të shpenzimeve në tabelë:

Shpenzimet totale, në vitin ushtrimor 2025 janë realizuar në vlerën 529,821,221 lekë, kundrejt vlerës 474,042,476 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 55,778,745 lekë ose 11.77%.

Për zërat kryesorë:

- ***Llogaria 600 – Pagat dhe përfitimet e punonjësve***, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 233,127,307 lekë, kundrejt vlerës 187,062,325 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 46,064,982 lekë ose 24.63%.
- ***Llogaria 601 – Kontributet e sigurimeve***, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 38,363,433 lekë, kundrejt vlerës 30,927,636 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 7,435,797 lekë ose 24.04%.
- ***Llogaria 602 – Blerje mallra dhe shërbime***, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 101,450,963 lekë, kundrejt vlerës 86,317,686 lekë në vitin 2024, me një rritje prej 15,133,277 lekë ose 17.53%.

- Llogaria 603 – Subvencione, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 0 lekë, njësoj si në vitin 2024, pa ndryshim.
- ***Llogaria 604 – Transfertime korente të brendshme***, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 4,738,573 lekë, kundrejt vlerës 9,195,050 lekë në vitin 2024, me një ulje prej 4,456,477 lekë ose 48.47%.
- ***Llogaria 605 – Transfertime korente me jashtë***, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 0 lekë, kundrejt vlerës 1,000,000 lekë në vitin 2024, me një ulje prej 1,000,000 lekë ose 100.00%.
- ***Llogaria 606 – Transfertime për buxhetet familjare dhe individë***, në vitin ushtrimor 2025 është realizuar në vlerën 152,140,945 lekë, kundrejt vlerës 173,472,590 lekë në vitin 2024, me një ulje prej 21,331,645 lekë ose 12.30%.

➢ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Nga verifikimi i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

➢ **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por ***nuk është mbajtur një libër si pjesë e dokumentacionit kontabël të mirëfilltë me të gjitha të dhënat historike të aktiveve afatgjata materiale, sipas modelit klasik të trajtuar më lart,*** domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik/ DBF të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Mbajtja e regjistrit të aktiveve.

U auditua evidenca kontabël dhe mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet afatgjata materiale e jomateriale, si dhe ato afatshkurtra rezultoi se, nga ana e Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit ishte hartuar dhe depozituar në dosjen e PFV të v.2025. Në këtë dokument janë regjistruar të dhënat mbi emërtimin e aktivit, vitin e hyrjes së aktivit (në shumicën e rasteve është vendosur shënimi para vitit 2015, pa saktësuar vitin e hyrjes së aktivit) , koston fillestare dhe amortizimin vjetor e progresiv, vlerën e mbetur të aktivit me dt. 31.12.2025, normën dhe masën e amortizimit vjetor si dhe vlerën e mbetur të aktivit.

Konstatim:

Bashkia Selenicë nuk ka një regjistër aktivesh të konsoliduar. Regjistri i aktiveve nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra (vlerën e plotë të tokës, mungon inventari i llogarisë 211 *"Pyje, kullota dhe plantacione",* apo llogaritë e pjesëmarrjes në kapital) dhe nuk është i plotësuar me sipas kërkesave të Paragrafit nr.30, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.*2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* i ndryshuar.

Në regjistrin e aktiveve *mungojnë të dhënat mbi vlerën e aktivit dhe data e hyrjes në përdorim,(në shumë raste mungojnë të dhënat për datën e hyrjes së aktivit vendor), vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës etj*.

Nga DSHFAP, është hartuar vetëm regjistri elektronik i cili nuk përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81, të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar.

Inventarizimi i pronës shtetërore

Procesi i inventarizimit:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74, parashikojnë se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina, etj.,

Me Urdhrin nr. 164 prot, datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë "*Për krijimin e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2025"* është urdhëruar ngritja e komisionit për inventarizimin e aktiveve të Bashkisë, me këtë përbërje:

- ✶ *Për Bashkinë Selenicë*, znj.A.M kryetar i komisionit, znj. M. B, anëtar dhe znj. D. N- antarë të komisionit.

- ✶ *Për Njësinë Administrative Armen*, z. E. P - Kryetar komisioni, z. V. S dhe znj. H. H, anëtarë komisioni.
- ✶ *Për Njësinë administrative Vllahinë*, z. P. Sh- Kryetar komisioni, znj. D. M dhe z. X. M, anëtarë të komisionit.
- ✶ *Për Njësinë administrative Kote*, z. F. M - Kryetar komisioni, znj. E. Xh dhe znj. D.C anëtarë të komisionit.
- ✶ *Për Njësinë Administrative Brataj*, z. K. B- Kryetar komisioni, znj. S. S dhe znj. F. H- anëtarë të komisionit.
- ✶ *Për Njësinë Administrative Sevaster*, z. B. P - Kryetar komisioni, z. Z. K dhe z. V. T, anëtarë të komisionit.

Me Urdhrin nr. 160 prot., datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë "*Për krijimin e komisionit të vlerësimit të aktiveve për vitin 2025"* është urdhëruar ngritja e komisionit të vlerësimit të aktiveve afatgjata të Bashkisë *"*me përbërje:

✶ Znj.S. D me detyrë Kryetar i Komisionit, znj. A.M-anëtare dhe znj. M. B - anëtarë komisioni.

Me Urdhrin nr. 159 prot, datë 17.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë *"Për krijimin e komisionit të nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve për vitin 2025"* është urdhëruar krijimi i komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve afatgjata të Bashkisë me përbërje:

✶ Z.D.L, me detyrë Kryetar Komisioni, z.D.D, znj. E.P, znj. M.B, znj. O.M, z. E. F dhe z. M. H - anëtarë komisioni.

Mbështetur mbi Urdhrat e mësipërm është kryer procesi i inventarizimit, dhe hartuar një relacion vlerësimi nga ana e Drejtorit të Shërbimeve Financiare dhe Akivë Protokollit znj.S. D, pa nr prot dhe pa datë është hartuar relacioni mbi kryerjen e vlerësimit të Aktiveve, e nënshkruar sipas përcaktimeve të paragrafit 106, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 nga Drejtori DSHFAP. Nga ana e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi janë hartuar procesverbalet përkatëse.

Bazuar në procesverbalet e mbajtura dhe veprimet e kontabilizimit të pasqyruara në formatin 7/a të PFV 2025, rezultoi se janë hequr nga kontabiliteti shuma 2,414,297 lekë e përbërë nga:

- Inventar Qarkullues, nga llogaria 327 *"Inventar i imët"* në shumën 810,016 lekë
- AAGJM nga llogaria 214 *" Instalime teknike, makineri paisje"* në shumën 299,311 lekë
- AAGJM nga llogaria 218 *" Inventar ekonomik"* në shumën 1,304,970 lekë

Konstatim:

Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, ka evidentuar disa mangësi në zbatimin e procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

1.Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Arkiv Protokollit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nuk i janë nënshtruar inventarizimit zërat "*Ndërtesa" dhe "Rrugë, rrjete e ujësjellës"*, por vetëm janë përfshirë si një zë i vetëm në përmbledhësen e inventarëve të vitit 2025, pa u zbërthyer analitikisht në zëra të veçantë. Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, *(llogaria 202 "studime e projektime")*, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 14,211,882 lekë në fillim të vitit 2025 dhe vlere neto 927,235 në fund të kësaj periudhe. Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale.

2.Nuk është kryer vlerësimi i aktiveve dhe nxjerrja nga përdorimi i aktiveve të dëmtuara të llogarisë 215 "Mjete transporti"

3. Përbërja e komisioneve është e pa ndryshuar nga viti 2024, veprime këto në kundërshtim me *paragrafin* nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar:

"Inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me rradhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision".

Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të jenë finalizuar me një raport përmbledhës që bëhet objekt miratimi (paragrafi 85/c) dhe *nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit të lartë (Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak) mbi rezultatet e inventarizimit. Sa më sipër,* nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 54/e "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" dhe neni 64 "Për detyrat dhe kompetencat e Kryetarit të Bashkisë"; ligjin nr. 68, dt.27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Kreu X, neni 52, pika nr.2; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 9, dhe neni 11, pika 4", neni 12 pika 3, dhe *paragrafi* nr. 120, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar

"Për efektet ekonomike dhe financiare të nxjerrjes nga përdorimi, njësitë e qeverisjes vendore duhet të informojnë këshillat e njësive vendore"

4.Nga shqyrtimi dhe auditimi i fletëve të inventarizimit të pasurisë, konstatohen parregullsi nga ana e komisioneve të inventarizimit të NJ-ve , në mospërmbushje të këtij detyrimi ligjor, si më poshtë:

- ✶ *NJA Brataj e Bashkisë Selenicë*, rezultojnë të pa inventarizuara dhe të pa nënshkruara nga komisioni i caktuar sipas Urdhrit nr. 164 prot, datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, me përbërje z.K.B- Kryetar komisioni, znj. S.S dhe znj. F.H anëtarë të komisionit, të fletëve të inventarizimit të aktiveve e mallrave dhe materialeve (llog 218, dhe 32), për Ambulancën Brataj, Spital Maternitet Brataj, Ambulanca Gjorm, Ambulanca Ramicë, Ambulanca Bashaj, Ambulanca Mesaplik, Ambulanca Qafa e Kaminave, etj.
- ✶ *NJA Sevaster e Bashkisë Selenicë*, rezultojnë të pa inventarizuara dhe të pa nënshkruara nga komisioni i caktuar sipas Urdhrit nr. 164 prot, datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, me përbërje z. B.P - Kryetar komisioni, z. Z.K dhe z. V.T, anëtarë të komisionit, të fletëve të inventarizimit të aktiveve e mallrave dhe materialeve (llog 218, dhe 32), kostume të grupit polifonik copë 11, me vlerën 180,014 lekë; automjet (makinë fuoristradë) copë 1 x 1,390,000 lekë (fletë e inventarizimit janë të pa nënshkruara).
- ✶ *NJA Vllahinë e Bashkisë Selenicë*, rezultojnë të pa inventarizuara dhe të pa nënshkruara nga komisioni i caktuar sipas Urdhrit nr. 164 prot, datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, me përbërje z.P.Sh- Kryetar komisioni, znj.D.M dhe z. Xh.M., anëtarë të komisionit, të fletëve të inventarizimit të aktiveve e mallrave dhe materialeve (llog. 218, dhe 32), për Shkollën Kropisht, Gërnec, Rexhepaj, është vendosur shënimi nga komisioni se nuk është kryer inventarizimi se janë mbyllur dhe se të dhënat janë të vitit 2019. Gjithashtu, nuk janë kryer procedurat e inventarizimit për ujësjellësin e kësaj NJA (llog. 218 dhe 32) që sipas vlerës kontabile është 5,928,320 lekë.

5.- Nuk është miratuar "Rregullore për menaxhimin e aktiveve" dhe Strategjia për mbrojtjen dhe menaxhimin e aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, pika 8/ c dhe /ç dhe pika 119:

6. Nuk janë kërkuar dhe administruar të dhënat brenda muajit Qershor të vitit 2025, nga shoqëritë tregtare në të cilat Bashkia Selenicë zotëron kuota apo të drejta (SHRUK Vlorë), si kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme

për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu III, pika 32 dhe 33.

Përfundime:

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Selenicë sipas kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe atij financiar e të kontrollit dhe kontabilitetit, etj. ka rezultuar se përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në këtë njësi shpenzuese buxhetore, është realizuar sipas afateve ligjore. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).

Nga ana tjetër, krahas punës së bërë kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi në lidhje me mos kontabilizimin e vlerës së truallit, mangësi në regjistrimin e gjithë të drejtave për arkëtim dhe riskun e parashkrimit të të drejtave për arkëtim nga debitorët; mangësi në hartimin e regjistrit të aktiveve si dhe kryerjen e procedurave të inventarizimit të pasurisë, etj., që duhet të jenë në vëmendjen e strukturave menaxheriale të institucionit për përmirësimet e nevojshme në të ardhmen. *Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. N. B, Kryetar i Bashkisë Selenicë, në cilësinë e Titullarit/ Nëpunësit Autorizues dhe znj.S. D me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare, si dhe Komisionet e ngarkuara me inventarizimin e pasurisë dhe Nxjerrjen nga Përdorimi të Aktiveve.*

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i buxhetit të Bashkisë Selenicë u evidentuan dobësi në *nivelin e realizimit të shpenzimeve*, të cilat ndikojnë në eficiencën e përdorimit të burimeve financiare dhe performancën buxhetore. Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2025 është në vlerën 712,990 mijë lekë, ndërsa pas rishikimeve në vlerën 792,155 mijë lekë, me një rritje prej 79,165 mijë lekë. Niveli i realizimit faktik është në vlerën 509,300 mijë lekë ose 71.4% ndaj planit fillestar dhe 64.2% ndaj buxhetit të rishikuar. Raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj shpenzimeve gjithsej rezulton 3.64 %. Fondet rezervë/ kontigjencë janë përdorur minimalisht. U konstatuan devijime të konsiderueshme ndërmjet planifikimit dhe realizimit, veçanërisht në zërat e investimeve, gjë që tregon se planifikimi buxhetor nuk është bazuar plotësisht në kapacitetet reale të zbatimit, duke mos garantuar një përdorim efektiv të fondeve.

-Për vitin 2025, planifikimi i *të ardhurave nga taksat dhe tarifat* vendore është në vlerën 177,070 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 121,856 mijë lekë. Mosrealizimi kundrejt planifikimit i të ardhurave buxhetore vendore rezultoi në vlerën -55,214 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2024, realizimi i vitit 2025 rezultoi me një rritje prej 3,662 mijë lekë, ose 3.1 % më shumë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç"; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"* i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, *"Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të*

vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, *"Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"* dhe VKB përkatëse.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën. 2.1, faqe 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, të marrë masa për përmirësimin e planifikimit, monitorimit dhe menaxhimit buxhetor, duke bazuar planifikimin e të ardhurave në analiza reale dhe kapacitetin faktik të arkëtimit, si dhe duke analizuar në mënyrë periodike devijimet ndërmjet planifikimit dhe realizimit të buxhetit, me qëllim rritjen e efektivitetit në përdorimin e burimeve financiare.

Menjëherë dhe në vijim

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive financiare të detyrimeve të prapambetura rezultoi se, Bashkia Selenicë ka ulur stokun e detyrimeve të prapambetura nga vlera 21,805,931 lekë në fillim të vitit 2025 në vlerën 18,649,124 lekë në fund të vitit, megjithatë vijojnë të mbeten të papaguara detyrime për vendime gjyqësore në vlerën 4,993,760 lekë, për investime në vlerën 4,309,794 lekë dhe për mallra e shërbime në vlerën 9,345,570 lekë. Bashkia Selenicë për vitin 2025 ka programuar fonde në buxhet, por nuk ka parashikuar një grafik të detajuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të mbartura nga viti 2024. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura"* pikat 20-22 dhe 27-29; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 186; Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, *"Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", pikat 106-110. (Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën. 2.1, faqe 24-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, të marrin masa për evidentimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të prapambetura, për llogaritjen dhe monitorimin periodik të stokut të tyre në raport me shpenzimet faktike, si dhe hartimin dhe zbatimin e një plani të qartë për likuidimin e tyre. Gjatë planifikimit dhe miratimit të fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, të mbahet në vëmendje shlyerja e detyrimeve të papaguara të viteve të mëparshme, me qëllim shmangien e akumulimit të detyrimeve, reduktimin e riskut për buxhetin e vitit në vazhdim dhe garantimin që fondet publike të jenë të disponueshme për financimin e nevojave, investimeve dhe shërbimeve në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të regjistrimit/çregjistrimit, planifikimit, njoftimit të detyrimeve dhe arkëtimeve për tatimpaguesit familjarë dhe të biznesit, rezultoi se:
- Nuk është miratuar Rregullorja e brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Selenicë, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 13, datë 25.06.2025 *"Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së regjistrit të personave fizik dhe juridik që kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore ..."* , dhe rrjedhimisht nuk janë parashikuar aspektet e gjenerimit /printimit dhe arkivimit të të dhënave periodike e vjetore mbi tatimpaguesit e Bashkisë.
-Procesi i popullimit të regjistrit elektronik dhe përpunimi i të dhënave kryhet nga i njëjti personel, pa ndarje funksionesh dhe kontrolle të brendshme të mjaftueshme. Mungojnë evidenca të monitorimit të procesit të përpunimit të të dhënave dhe raportimit të tyre në formë elektronike dhe shkresore për drejtuesit dhe Kryetarin e Bashkisë.

-Nuk është dokumentuar me procesverbal niveli i detyrimeve të papaguara për taksat dhe tarifat vendore sipas kategorive, në datën 31.12.2025. Nuk është kryer protokollimi dhe arkivimi i kopjes së printuar dhe elektronike të regjistrit vjetor të detyrimeve, në momentin e mbylljes së vitit ushtrimor dhe para hapjes së regjistrit të vitit pasardhës. Sa më sipër, në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5/iv, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën. 2.2, faqe 34-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa për miratimin e rregullores së brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve, si dhe zbatimin e procedurave për mbylljen, dokumentimin dhe arkivimin e regjistrit vjetor të tatimpaguesve; sigurimin e ndarjes së detyrave midis personave që kryejnë popullimin e regjistrit dhe atyre që përgatisin raportet dhe njoftimet e detyrimeve; vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të procesit të administrimit të regjistrit elektronik të tatimpaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore rezultoi se:

- Nuk janë mbajtur rakordime të dokumentuara periodike dhe vjetore midis Drejtorisë së të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtorisë së Shërbimeve Financiare e Arkiv Protokollit, por vetëm komunikim shkresor mbi nivelin e realizimit të të ardhurave.
- Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit përdor evidenca të gjeneruara nga programi *Microsoft Excel*, të përpunuara manualisht mbi bazën e informacionit të regjistrit elektronik dhe të dhënave të dërguara nga sektorët përkatës, që mbart riskun e pasaktësive në raportimin financiar dhe të besueshmërisë së informacionit të përdorur për vendimmarrje dhe raportim buxhetor.
-Raportet e monitorimit dhe raportet vjetore nuk shoqërohen me gjurmë dokumentare që të lidhin të dhënat e regjistrit elektronik me tabelat e përpunuara.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore"* i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendor*e" i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën. 2.2, faqe 34-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit në koordinim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrin masa për kryerjen e rakordimeve periodike e vjetore të detyrueshme dhe të dokumentuara midis të dhënave të regjistrit elektronik dhe kontabilitetit; formalizimin e procedurave të gjurmimit dhe dokumentimit të të dhënave financiare, si dhe minimizimin e përpunimit manual të të dhënave dhe përmirësimin e integrimit të sistemeve të raportimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave tatimore deri më datë 31.12.2025, u konstatua se nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë mbajtur akt-rakordime periodike për identifikimin e nivelit të të ardhurave të arkëtuara për llogari të kësaj Bashkie me Drejtorinë Vendore të ASHK-së,

Drejtorinë Rajonale të Doganave dhe AKBN-në. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar neni 117; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, etj. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën. 2.2, faqe 34-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrin masat për të kryer rakordimet periodike me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave; evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/ tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për aplikimin e gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë, sipas legjislacioni mbi procedurat tatimore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Selenicë, për vitin 2025, ky sistem vlerësohet pjesërisht efektiv dhe se komponentët e menaxhimit financiar nuk kanë funksionuar në mënyrë të plotë. *Më konkretisht:*

- Kryetari i bashkisë Selenicë nuk kishte ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b" dhe nenin 27 si dhe me Manualin e MFK-së, pika 2.2.6.
- Nuk është kryer vlerësimi 6 mujor i punonjësve, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, "*Për nëpunësin civil"* i ndryshuar, neni 1, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë"*, kreu II, pika 2, si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës"* i ndryshuar.
- Drejtoritë dhe Sektorët në Bashkinë Selenicë, nuk rezultojnë të kenë hartuar planet mujore dhe vjetore të punës si dhe raportet e analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak, lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve, në kundërshtim me paragrafin 3.1 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.4, datë 26.10.2024.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Selenicë, nuk ka hartuar një plan trajnimesh për personelin e institucionit, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1;
- Kryetari i Bashkisë Selenicë nuk rezultoi të ketë ngritur Ekipin për Menaxhimin e Programeve, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 23, datë 30.7.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", pika 29, si dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", pika 2.5 dhe 2.6.
- Nuk ishte hartuar dhe miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut dhe Regjistri i Riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", neni 11, pika 2, neni 8, pika 8, germa a dhe neni 21;
- Kryetari i Bashkisë nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit të Riskut, në kundërshtim me pikën 2.4.4 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
- Nuk është miratuar gjurma e auditimit, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e auditimit, në kundërshtim me Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar, neni 16, pika 2 dhe 3;

- Bashkia Selenicë nuk kishte rishikuar dhe përditësuar Rregulloren e Brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk është miratuar rregullorja e re e përditësuar për organizimin dhe funksionimin e bashkisë, në kundërshtim me Manualin e MFK-së, pika 3.3.
- Mungon një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave dhe nuk ka sistem rezervë *(back-up)* për ruajtjen e të dhënave të menaxhimit financiar për njësinë. Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT-së. Aktualisht nuk ka një manual për sigurinë e IT, në kundërshtim me VKM nr. 710/2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimeve" si dhe me Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve, hartuar nga AKSHI. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën. 2.2, faqe 34-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në bashki të marrin masa për të ngritur një sistem efektiv mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke hartuar e zbatuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Strukturat drejtuese të ndjekin nivelin e implementimit të parimeve respektive sipas komponentëve të MFK-së për plotësimin e mangësive të konstatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përgatitjes së pasqyrave financiar të llogaridhënës vjetore për vitin 2025 në Bashkinë Selenicë, ka rezultuar se:
-Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit operon me mbajtjen manualisht të disa librave/ditarëve të kontabilitetit dhe jo sipas një programi kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe mos mbajtje të librave të kontabilitetit (centralizatorit të veprimeve), niveli i riskut për të gabuar është i lartë.
-Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin *Microsoft Excel*, gjë që tregon se niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.
Sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; UMF nr. 16, datë 31.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimit të MFK dhe funksionimin e GMR në njësitë publike*"; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.1.2024; UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar Kreut 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika nr. 6, Kreu I dhe 28 dhe Kreu III. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 1, faqe 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masat për të siguruar automatizimin dhe integrimin e proceseve të kontabilitetit dhe administrimit të të ardhurave, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. *Për këtë,* Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të implementojë dhe përdorë një sistem të certifikuar / program kontabiliteti për regjistrimin e veprimeve financiare, për të siguruar përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe programe informatike të pamanipulueshme e të printueshme në çdo kohë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e procesit të rakordimit dhe përputhjes së të dhënave të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënës Vjetore (PFV) të hartuara nga ana e njësisë

shpenzuese Bashkia Selenicë e të dorëzuara në Degën e Thesarit, me të dhënat e Pasqyrave Financiare të gjeneruara nga Ministria e Financave në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), kanë rezultuar disa mospërputhje, sa vijon:

- ✓ Shuma e aktiveve neto sipas PFV të Bashkisë Selenicë për vitin 2025 është në vlerën 3,073,973,563 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezultoi në vlerën 2,938,129,166 lekë. Diferenca e pa kuadruar, pasi hiqet vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" është në vlerën 138,987,992 lekë.
- ✓ Nga krahasimi i të dhënave të pasqyrave financiare të ngarkuara në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) rezultoi se janë 8 zëra të llogarive kontabile, ku ekzistojnë mospërputhje të tepricës së llogarive pjesë e PFV të dorëzuara zyrtarisht nga ana e Bashkisë Selenicë në Degën e Thesarit Vlorë, për një diferencë prej 134,193,125 lekë.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim me përcaktimet e pikës 14, Seksioni 3.1, të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar si dhe pikën 10, të UMF nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025*".*(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të marrë masa për zbatimin e një procesi të detyrueshëm rakordimi dhe verifikimi paraprak të Pasqyrave Financiare Vjetore me të dhënat e gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, duke siguruar që të dhënat e raportuara të jenë të njëjta, si dhe analizimin, dokumentimin dhe korrigjimin e të gjitha diferencave të konstatuara para protokollimit dhe depozitimit të tyre në Degën e Thesarit, krahas pasqyrimit të këtyre diferencave nëse ato ekzistojnë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë *4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"* u konstatua se totali i kësaj llogarie sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në Llogaridhënien Vjetore në fund të vitit 2025, kuadron për vitin 2025, mirëpo nuk kuadron me tepricën e llogarinë 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit*" në mbylljen e vitit 2024. Llogaria 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* më datë 31.12.2024 në vlerën 69,107,591 lekë nuk kuadron me llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit" në atë datë, për tepricën e kësaj llogarie 52,222,372 lekë, me një mosrakordim prej -16,885,219 lekë, me efekt në bilancin e çeljes 2025, duke mos mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është paraqitje jo e drejtë e pozicionit financiar, në kundërshtim me trajtimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar.

-Llogaria 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)", më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë. Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 janë në shumën prej 306,329,835 lekë, ku përfshihet vlerat e llogarisë 423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" dhe llog. 468 "Debitorë të ndryshëm". *Sa më sipër,* rezultojnë mospërputhje dhe nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë 4341, veprime në kundërshtim me trajtimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48 dhe Kreu III, paragrafi 32.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të marrë masa që të kryejë analizimin, sistemimin dhe rakordimin e tepricave të llogarive 4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)", me qëllim eliminimin e

mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

10. Gjetje nga audimi: Nga auditimi i llogarisë 423, 429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba",* u konstatua se kjo llogari mbyllet me tepricën e pasqyruar në pasqyrat financiare në shumën 70,005,368 lekë. Kjo tepricë përfaqëson:

- detyrime të lëna nga konkluzionet përfundimtare të auditimeve të ushtruara nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në shumën 34,787,268 lekë;
- detyrime të konstatuara nga vjedhjet e mjeteve monetare në shumën 1,207,510 lekë të mbartura nga vitet e mëparshme nga bilancet e ish-komunave;
- detyrime nga debitorët e ndihmës ekonomike në shumën 1,112,974 lekë dhe
- detyrime nga debitorë të ndryshëm, në shumën 32,897,616 lekë.

Nga verifikimi u konstatua se detyrimet e lëna për zhdëmtim nga përfundimet e auditimeve të ushtruara nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në shumën 34,787,268 lekë, detyrimet nga debitorët e ndihmës ekonomike në shumën 1,112,974 si dhe detyrimet nga debitorë të ndryshëm në shumën 32,897,616 lekë janë keqklasifikuar në llogarinë 423, 429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba",* veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar. Kreu III, paragrafi 3.3 *"Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve" (klasa 4),* ku përcaktohet se në llog. 429 regjistrohen gjobat dhe deficitet e personelit. Efekti në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e mbylljes së pasqyrave financiare është paraqitje jo e drejtë e pozicionit financiar. Veprime e mosveprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5 dhe Aneksi 1, Kapitulli III, paragrafi 3.3.

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, të marrë masat për sistemimin/riklasifikimin në kontabilitet të detyrimeve në shumën 70,005,368 lekë, të lidhura me detyrimet nga rekomandimet e lëna nga auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, detyrimeve nga debitorët e ndihmës ekonomike, si dhe detyrimeve nga debitorë të ndryshëm, të cilat janë keqklasifikuar në llogarinë 423, 429 *"Personeli, paradhënie, deficite, gjoba"* në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", me qëllim pasqyrimin e saktë të gjendjes së detyrimeve të personelit në pasqyrat financiare.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime",* rezultoi se në fund të vitit 2025, teprica e kësaj llogarie paraqitet në kontabilitet me vlerën neto 927,235 lekë. Nga inventarizimi i pasurisë i kryer për vitin 2025, sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me nr.164 prot, datë 18.11.2025 nuk është përfshirë verifikimi i ekzistencës fizike të studimeve dhe projektimeve. Pra, nuk është testuar ekzistenca e dokumentuar e këtyre studime-projektimeve dhe mungon nënshkrimi nga personi përgjegjës që i ka në ngarkim/ arkivuar këto aktive afatgjata jomateriale,

-Nga analiza e tepricës së llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* në fund të vitit 2025, u konstatua se në vlerën totale të llogarisë prej 6,116,753 lekë sipas kostos historike, është përfshirë shuma prej 3,947,625 lekë që i përket vlerës së disa projekt-studime për investime, e pa shpërndarë sipas

llojit të aktiveve afatgjata materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.
Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu II pika 16/b, d, Kreu III, pika 36, Aneksi 1, pika 2; si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pikat 26, 30-35, Kreu IV pika 75.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit fizik të studim-projektimeve gjendje e llog. 202*"Studime dhe Kërkime",* nëse është e mundur të bëjë shpërndarjen e vlerës së tyre, si vlerë e shtuar sipas llojit të aktivit të kapitalizuar, të përllogarisë amortizimin për to sipas normës dhe metodës së miratuar, duke i kryer veprimet sistemuese kontabël në llogaritë përkatëse.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së e llogarisë 210 *"Toka, troje, terrene",* rezultoi se nuk është përfshirë vlera e truallit të aktiveve afatgjata materiale (llog.212) në pronësi të Bashkisë Selenicë. Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë (210) *"Toka, troje, terrene"* dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në Pasqyrat Financiare është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të. Nuk ka informacion mbi shumën prej 140,249,952 lekë të trashëguar në bilancet e ish Komunave ngase përbëhet. Mungesa e informacionit kontabël për këtë llogari ndikon në informacionin që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, me efekt në procesin e inventarizimit fizik të tyre.
- Në llog. 210 nuk është përfshirë për të gjithë aktivet ndërtimore /aktive afatgjata materiale (llog.212), vlera e truallit në pronësi të Bashkisë Selenicë.
Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, të marrë masa për evidentimin, inventarizimin, klasifikimin dhe pasqyrimin e plotë e të saktë të aktiveve afatgjata materiale, duke sistemuar llogarinë 210 "*Toka, troje, terrene*" dhe llogarinë 212 "*Ndërtime e konstruksione",* përfshirë regjistrimin e vlerës së truallit për asetet në administrim dhe kryerjen e rakordimeve me regjistrin e aktiveve të Bashkisë Selenicë.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 211*"Pyje, kullota, plantacione"* u konstatua se gjendja kontabël sipas kostos historike në datën 01.01.2025 është 0 lekë dhe gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime. Nga auditimi rezultoi se Bashkisë Selenicë i kanë kaluar sipas:

- ✓ VKM nr. 684, datë 02.09.2020 *"Për transferimin e pyje/kullota të Bashkive",* 485 prona pyje kullota 26,899,56 ha të cilat nuk janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit të Bashkisë, dhe

- ✓ VKM nr. 433, datë 08.06.2016 Bashkisë i kanë kaluar 500 prona pyje dhe kullota në total 24,322.06 ha, të cilat nuk janë inventarizuar dhe kontabilizuar në librat e kontabilitetit të Bashkisë.

Rezultoi se këto pyje dhe kullota janë të pavlerësuara dhe nuk janë evidentuar në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Selenicë për vitin 2025.

- *Sa më sipër,* kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara në pronësi të kësaj Bashkie sipas VKM-ve respektive, transferuar në pronësi të Bashkisë Selenicë. Këto veprime bien në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, me pikën 1 dhe 2, kreu VI të VKM nr. 510, datë 14.08.2001, *"Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme"*; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001,*"Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i* ndryshuar, pikat 26, 27, 30; si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për administrimin e pronave dhe menaxhimin e fondit pyjor e kullosor, të marrë masa për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe pasqyrimin e plotë e të saktë në llogarinë 211 "*Pyje, kullota, plantacione*" të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të transferuara në pronësi të Bashkisë Selenicë, si dhe rakordimin e tyre me dokumentacionin e pronësisë dhe regjistrat përkatës, me qëllim paraqitjen e drejtë të aktiveve në pasqyrat financiare të këtij institucioni.

Menjëherë e në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" gjatë vitit 2025 rezultoi se janë kontabilizuar në llogari tre zëra shpenzimesh për investime nga ana e Bashkisë Selenicë në shumën **132,718,566 lekë**, për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilat nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie. *Më hollësisht*;

- ✓ Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete te varfra dhe të pa favorizuara në shumën 109,850,069 lekë.
- ✓ Rikualifikim urban pallateve në hyrje të Selenicës, me vlerën gjithsej 20,469,146 lekë;
- ✓ Rikualifikim urban ne sheshin Vajzë në shumën 2,399,351 lekë

Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Selenicë. Këto zëra shpenzimesh në 3 (tre) raste janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën 132,718,570 lekë. Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me UMF nr.8 datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"*, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit e Bashkisë Selenicë të marrë masa për sistemimin e trajtimit kontabël të 3 (tre) investimeve, të regjistruara gabimisht në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione". Për këtë qëllim, të kryhet çregjistrimi i shumës

132,718,566 lekë nga llogaria 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" dhe sistemimi i saj në përputhje me trajtimin kontabël të parashikuar për grantet kapitale për pjesëmarrje në investime për të tretë**,** sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, prezantimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 *"Ndërtesa dhe Konstruksione*" gjatë vitit 2025 rezultoi se pjesë e objekteve ndërtimore janë të trashëguara dhe të mbartura nga ish/komunat në periudhat raportuese para vitit 2015 dhe janë të pa shoqëruara me kartelat përkatëse të objekteve.

- Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk është bërë një pasqyrim real dhe i drejtë në lidhje me vlerën e objekteve dhe gjendjen e tyre, pasi në shumicën e rasteve të audituara janë pasqyruar vetëm investimet e kryera gjatë viteve të fundit, dhe se në fakt vlerat e tyre janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të shkuara (para vitit 2000), në mospërputhje të gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive.

-Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "*Ndërtesa Konstruksione*" (kosto historike) u konstatua se në këtë llogari, referuar analizës në nivel artikulli, vlerat e projekt preventivit, rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit nuk i janë shtuar vlerës fillestar të aktivit përkatës pas investimeve të kryera, për 8 (tetë) raste me vlerë **85,787,046 lekë.**

Sa më sipër, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme"* i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1pika 2, klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik.

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1.Rekomandimi: Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të kryhet një proces i rishikimit dhe sistemimit të evidencës së llogarisë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione",* duke siguruar plotësimin e dokumentacionit teknik dhe kontabël të aktiveve të trashëguara, evidentuar dhe regjistruar asetet e papasqyruara; përditësuar vlerat e aktiveve në përputhje me investimet e kryera ndër vite, si dhe rakorduar regjistrin e aktiveve me dokumentacionin e pronësisë dhe gjendjen faktike, me qëllim garantimin e paraqitjes së plotë, të saktë dhe të besueshme të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare dhe siguruar gjurmueshmërinë e tyre administrative, teknike dhe kontabël.

Në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore*", rezultoi se nga Bashkia Selenicë nuk janë transferuar në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime (SHRUK) Vlorë, 17 zëra të aktiveve të lidhura me sistemet e ujësjellës-kanalizimeve. Këto aktive, të cilat i përkasin lëvizjeve të vitit 2025, janë regjistruar në kontabilitet më datë 31.12.2025 në llogarinë 213, me një kosto historike totale prej 181,680,672 lekë.

Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv-Protokollit nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për përfundimin e procedurave të transferimit të këtyre aktiveve në "Shoqërinë Rajonale UK Vlorë SHA". Si rrjedhojë, aktivet vijojnë të rezultojnë të regjistruara në kontabilitetin

e Bashkisë Selenicë, pavarësisht se lidhen me veprimtarinë dhe funksionet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve.
Për sa sipër, vjen në kundërshtim me VKM nr. 302, datë 11.05.2022, "*Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura*", Kreu II, pika 14; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85; si dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", i ndryshuar, Kreu II, pikat 5 dhe 36, si dhe Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë, të marrin masa për transferimin në mënyrë të dokumentuar të aktiveve sipas vlerës kontabël, ku vlera e regjistruar është **181,680,672 lekë** dhe pasi Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.a të ketë marrë në dorëzim këto aktive, Bashkia Selenicë të pasqyrojë në kontabilitet efektet e këtij transferimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 26*"Pjesëmarrje në kapitalet e veta",* u konstatua se në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të llogaridhënës vjetore, vlera e kësaj llogarie, në fund të vitit 2025 është 0 dhe është nënvlerësuar në shumën **305,000 lekë**. Referuar Statutit të "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a" dhe Akt Marrëveshjes, (protokolluar në Bashkinë Selenicë me nr. 1542 prot, datë 13.07.2023), është krijuar Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta (SKP), shoqëri e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkive, aksionarë të saj, e krijuar në datën 20/09/2023 dhe e regjistruar me datë 02/10/2023,me Nipt M.....E. Mos pasqyrimi i aktiveve financiare në kontabilitet, është veprim në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
17.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të kryejë veprimet sistemuese kontabël për paraqitjen e drejtë të pjesës së kapitaleve të Bashkisë Selenicë në "Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a", pasi llogaria është nënvleftësuar në shumën **305,000 lekë**, duke kryer sistemimet në llogaritë 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet*" dhe në llog. 1011*"Shtesa të fondit bazë".*

Deri në mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2026

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 231 *"Investime për aktive afatgjata materiale"* me tepricën në vlerën 217,926,232 lekë, rezultoi se në këtë llogari vazhdojnë të evidentohen investime të përfunduara, të cilat janë marrë në përdorim dhe disponojnë certifikata të përkohshme, por nuk janë kapitalizuar si aktive afatgjata materiale. Si pasojë e moskapitalizimit, këto aktive vijojnë të trajtohen kontabilisht si investime në proces, duke mos u transferuar në llogaritë përkatëse të aktiveve afatgjata materiale dhe, për rrjedhojë, nuk i nënshtrohen llogaritjes së amortizimit sipas normave në fuqi. Përjashtimi i tyre nga amortizimi bën që vlera kontabël e aktiveve të mos pasqyrojë vlerën e tyre reale në momentin e vënies në përdorim, si dhe të mos reflektojë konsumimin ekonomik të tyre gjatë periudhës së shfrytëzimit. Moskapitalizimi i investimeve në shumën **217,926,232 lekë** sjell mbivlerësimin e llogarisë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", nënvlerësimin e llogarive të aktiveve afatgjata materiale dhe të shpenzimeve

të amortizimit, duke deformuar pozicionin financiar dhe rezultatin kontabël të Bashkisë. Për pasojë, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme gjendjen e aktiveve dhe informacionin financiar të njësisë. Sa më sipër, vepruar në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"*, i ndryshuar pika 5. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për kapitalizimin dhe riklasifikimin e investimeve të përfunduara dhe të vëna në përdorim, për të cilat disponohet dokumentacioni përkatës, përfshirë certifikatat e përkohshme, por që vijojnë të evidentohen në llogarinë 231 "Investime për aktive afatgjata materiale", ku të kryhen regjistrimet kontabël dhe llogaritja e amortizimit në përputhje me legjislacionin dhe standardet kontabël në fuqi, me qëllim paraqitjen e drejtë dhe të saktë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionit financiar të Bashkisë Selenicë.

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje",* rezultoi se për 86 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim janë ngurtësuar fonde në vlerën 47,110,885 lekë. Deri në momentin e kryerjes së auditimit nuk është bërë çlirimi i garancive për 75 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim në vlerën **28,978,678 lekë** për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës**,** nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në Degën e Thesarit Vlorë. Në tre raste shumat e kontabilizuara në këtë llogari janë pa origjinë. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare Arkiv Protokollit, si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Investimeve nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me Subjektet Sipërmarrëse pa ndërmarrë veprimet e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Këto veprime janë në kundërshtim me UKM nr. 3, datë 15.02.2011 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kap. II, pika 6 dhe 10; UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", Kap. III, pikat 30, 39, 50.

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare Arkiv Protokollit, si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Investimeve në koordinim me strukturat përgjegjëse në Bashkinë Selenicë të marrin masa duke ndjekur të gjitha hapat e nevojshme që, për punimet e përfunduara dhe të marra në dorëzim konformë përcaktimeve në kontratës, të bëjnë njoftimet e subjekteve për tërheqjen e garancive të punimeve. Në rast mos plotësimi të kushteve ose refuzimit nga subjektet në zbatim të dispozitave ligjore, të bashkëpunohet me Degën e Thesarit për kalimin e këtyre fondeve në favor të autoritetit kontraktor, si e ardhur për mospërmbushje të rregullt të kushteve të kontratës.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizmin dhe mbajtjen e evidencës kontabile, rezultoi se Regjistri i Aktiveve i vitit 2025 nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale, jomateriale, llogaritë e pjesëmarrjes në kapital dhe aktivet afatshkurtra, si dhe nuk është i plotësuar sipas kërkesave të paragrafit nr.30 dhe nr.109, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për*

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Nga Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit ishte hartuar vetëm regjistri elektronik i aktiveve, i cili nuk përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore. Në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën fillestare të aktivit në momentin e blerjes, data e hyrjes në përdorim, (në shumë raste vendosur shënimi para vitit 2015), vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, vendndodhja, personi përgjegjës etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualin e MFK-së, Udhëzimin nr. 30, datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6, Kreu III, paragrafi 28, Kreu I, paragrafi 4/c, Kreu II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
20.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Selenicë, të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e punës në mbajtjen e Regjistri të Aktiveve të institucionit, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vend ndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.
Regjistri të Aktiveve të përfshijë aktivet afatgjata dhe afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e më eficiencë të tyre, janë konstatuar disa mangësi në lidhje me zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm. *Konkretisht,*
-Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Arkiv Protokollit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar. Nuk është kryer vlerësimi i aktiveve dhe nxjerrja nga përdorimi i aktiveve të dëmtuara të llogarisë 215 "*Mjete transporti*"
-Përbërja e komisioneve të inventarizimit është e pa ndryshuar nga viti 2024, në kundërshtim me paragrafin nr. 84, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. Procedurat e inventarizimit nuk rezultojnë të jenë finalizuar me një raport përmbledhës që bëhet objekt miratimi (paragrafi 85/c) dhe nuk ka një vendimmarrje nga ana e menaxhimit të lartë (Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak) mbi rezultatet e inventarizimit**.**
-Nga shqyrtimi dhe auditimi i fletëve të inventarizimit të pasurisë, konstatohen parregullsi nga ana e komisioneve të inventarizimit të NJ-ve , në mospërmbushje të këtij detyrimi ligjor, si më poshtë:

- ✓ <u>*NJA Brataj*</u>, rezultojnë të pa inventarizuara dhe të pa nënshkruara nga komisioni i caktuar sipas Urdhrit nr. 164 prot, datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, të fletëve të inventarizimit të aktiveve e mallrave dhe materialeve *(llog 218, dhe 32),* për Ambulancën Brataj, Maternitetin Brataj, Ambulancën Gjorm, Ambulancën Ramicë, Ambulancën Bashaj, Ambulancën Mesaplik, Ambulancën Qafa e Kaminave, etj.

- ✓ *NJA Sevaster*, rezultojnë fletët e inventarizimit të pa nënshkruara dhe të pa inventarizuara nga komisioni i caktuar sipas Urdhrit nr. 164 prot, datë 18.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Selenicë, të fletëve të inventarizimit të aktiveve e mallrave dhe materialeve (llog 218, dhe 32), kostume të grupit polifonik copë 11, me vlerën 180,014 lekë; automjet (makinë fuoristradë) copë 1 x 1,390,000 lekë, etj.
- ✓ *NJA Vllahinë*, rezultojnë të pa inventarizuara dhe të pa nënshkruara nga komisioni i caktuar, të fletëve të inventarizimit të aktiveve e mallrave dhe materialeve *(llog. 218, dhe 32),* për Shkollën Kropisht, Gërnec, Rexhepaj, ku është vendosur shënimi nga komisioni se nuk është kryer inventarizimi se janë mbyllur dhe se të dhënat janë të vitit 2019. Gjithashtu, nuk janë kryer procedurat e inventarizimit për ujësjellësin e kësaj NJA *(llog. 218 dhe 32)* që sipas vlerës kontabile është 5,928,320 lekë.

Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e ligjit nr.139/2015, *"Për Vetëqeverisjen Vendore",* neni 54/e dhe neni 64; ligjin nr. 68, dt.27.04.2017 "*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore",* Kreu X, neni 52, pika nr.2; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",* i ndryshuar, neni 9, dhe neni 11 pika 4, neni 12 pika 3, dhe *paragrafi* nr. 120, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, në cilësinë e titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të marrë masa për përfundimin e procesit të inventarizimit fizik të të gjitha aktiveve, veçanërisht të Aktiveve Afatgjata Materiale të regjistruara në llogaritë 210, 211, 212, 213 dhe 214, si dhe të aktiveve të llogarisë 215 "Mjete transporti", në të gjitha Njësitë Administrative, veçanërisht në NJA Brataj, NJA Sevaster dhe NJA Vllahinë, duke përfshirë edhe aktivet, mallrat dhe materialet e evidentuara në llogaritë 218 dhe 32, si dhe aktivet e ujësjellësit.
Gjithashtu, të merren masa për ngritjen dhe funksionimin efektiv të komisioneve të inventarizimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për përbërjen e tyre, si dhe për dokumentimin e plotë, të saktë dhe të gjurmueshëm të procesit të inventarizimit, duke përfshirë hartimin e raportit përmbledhës, ku të evidentohen rezultatet e inventarizimit dhe diferencat ndërmjet gjendjes fizike dhe asaj kontabël.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa që, mbi bazën e rezultateve të inventarizimit, aktivet e dëmtuara, të amortizuara ose jashtë përdorimit të evidentohen dhe të trajtohen në përputhje me kërkesat dhe procedurat ligjore, për sistemimin, transferimin, nxjerrjen nga përdorimi apo çregjistrimin e tyre, sipas rastit, duke reflektuar ndryshimet përkatëse në regjistrat e aktiveve dhe në kontabilitet. Përfundimet dhe masat e ndërmarra në vijim të procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi të dokumentohen dhe të paraqiten për miratim strukturave përgjegjëse, me qëllim që gjendja fizike e aktiveve të përputhet me evidencën kontabël dhe regjistrat e aktiveve.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të pronave publike vendore dhe të Rregullores për miradministrimin e aktiveve, si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 8, pika 8/ç; Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar; Kreun IV, të Manualit të MFK-së miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.4, datë 26.1.2024*;* Udhëzimit

nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *dhe* Kreu II, pika 17-25. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të marrë masat për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Menaxhimin e Aktiveve, si dokumente bazë për administrimin, mbrojtjen, inventarizimin, vlerësimin dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këto dokumente të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Selenicë në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e një menaxhimi efektiv, ekonomik dhe transparent të aktiveve vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së sistemit të tatimeve dhe taksave vendore u konstatua se, Drejtori i Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.12, datë 29.01.2025, është caktuar Kryetar i Komisionit të Apelimit Tatimor të Bashkisë Selenicë. Ky veprim është në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V *"Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm",* neni 17 "Kufizimet në veprimtarinë e audituesve të brendshëm" dhe neni 14 "Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm", të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* i ndryshuar si dhe me parimet e pavarësisë dhe objektivitetit të parashikuara nga Standardet Globale të IIA, pasi ky funksion përbën një përgjegjësi operative dhe vendimmarrëse që mund të dëmtojë pavarësinë e funksionit të auditimit të brendshëm. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.1, faqe 34-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa për shfuqizimin e Urdhrit nr. 12, datë 29.01.2025, në pjesën që cakton Drejtorin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm si Kryetar të Komisionit të Apelimit Tatimor, si dhe të sigurojë që audituesit e brendshëm, përfshirë drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm, të mos ngarkohen me funksione operative, administrative apo vendimmarrëse jashtë veprimtarisë së auditimit të brendshëm, në mënyrë që garantohet pavarësia dhe objektiviteti i funksionit të auditimit të brendshëm.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të Bashkisë Selenicë rezultoi se nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 12, pika b, e Ligjit nr. 114/2015 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar.* Nuk janë audituar Sektorët dhe Drejtoritë që paraqesin risk të lartë për sa i përket gabimeve, parregullsive dhe shkeljeve ligjore, si p.sh "Prokurimet Publike", në mospërputhje me përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm Publik, që ka parashikuar se për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani i angazhimeve duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë të shpeshtë gjatë vitit. Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se audituesit e brendshëm nuk kanë krijuar dosjet e përhershme të auditimit, në mos përputhje me përcaktimet e Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 134, datë 17.10.2025. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 1, faqe 13-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1.Rekomandimi: Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit mbi bazën e vlerësimit të riskut, duke

planifikuar auditimin me frekuencën e kërkuar të strukturave dhe proceseve me risk të lartë, si dhe për krijimin, administrimin dhe ruajtjen e dosjeve të përhershme të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

24.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit, si një hallkë që i kontribuon përmirësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm.

Në vijimësi

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit rezultoi një nivel i lartë detyrimeve debitorë *(llogaria 468)* në Bashkinë Selenicë në fund të vitit 2025, prej **236,324,467 lekë**, me të njëjtën vlerë sa në vitin 2024.

- Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së të Ardhurave, Pronës Publike, Lejeve e Licencave, vlera totale e detyrimeve debitore në fund të vitit 2025 është në shumën prej **443,464,090 lekë,** kurse në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të vitit 2025 shuma e kontabilizuar në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm"* është 236,324,467 lekë. Për rrjedhojë, rezultoi se nuk janë njohur dhe kontabilizuar detyrimet debitor në shumën **207,139,623 lekë**, duke sjellë nënvlerësimin e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe të llogarive të të ardhurave përkatëse të klasës 7-të.
- Gjithashtu në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", nuk janë pasqyruar në kontabilitet vlerat e gjobave të IMTV-së për ndërtime pa leje gjatë periudhës 2024 dhe 2025 në vlerën **70,000 lekë**, duke nënvlerësuar llogarinë 486 "*Debitorë të ndryshëm"* dhe llogarinë 7115, për të njëjtën shumë. *Sa më sipër*, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar; Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore",* i ndryshuar; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kapitulli II, pika 6. *Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 55-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronës Publike, Lejeve e Licencave, të marrë masa për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve/borxhit progresiv tatimor në vlerën **443,464,090 lekë**, duke i dhënë prioritet debitorëve të trashëguar.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit të marrë masa për regjistrimin dhe klasifikimin në llogaritë përkatëse kontabël të detyrimeve debitore të pakontabilizuara, të evidentuara në shumën **207,209,623 lekë**, si diferencë ndërmjet detyrimeve debitore të kontabilizuara në llogarinë 468, sipas evidencave të sektorit të kontabilitetit, dhe detyrimeve tatimore progresive, sipas evidencave të sektorit të të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Bashkisë Selenicë rezultoi se,

-Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ka regjistruar detyrimet progresive deri me datën 31.12.2024 në shumën prej **446,057,353** lekë, të cilat analitikisht

detajohen sipas Njësive Administrative dhe kategorive të taksave e tatimeve vendore.
-Detyrimet e krijuara gjatë vitit 2025 prej **40,967,737 lekë**, *përbëhen nga,*

- Detyrimi që subjektet fizikë/juridikë kanë ndaj Bashkisë Selenicë për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 në shumën **8,286,971** lekë.
- Detyrimi që subjektet familjare kanë ndaj Bashkisë Selenicë për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 në shumën **32,680,766** lekë.

-Detyrimet e likuiduara gjatë vitit 2025 për taksa e tarifa vendore janë **43,561,000** lekë. Nga këto:

- Shuma e detyrimeve të likuiduara nga ana e subjektet fizikë/juridikë gjatë vitit 2025 është në shumën **8,846,420** lekë.
- Shuma e detyrimeve të likuiduara nga ana e subjekteve familjare gjatë vitit 2025 është në shumën **34,714,580** lekë.

-Në total ***borxhi tatimor progresiv*** për taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Selenicë në datën 31.12.2025 është në vlerën **443,464,090 lekë,** që përbëjnë të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Selenicë dhe përfshin:

- Gjendjen e detyrimeve për taksa e tarifa, që në trajtë progresive në fund të vitit 2025 për subjektet e biznesit është **117,779,573 lekë.**
- Gjendjen e detyrimeve për taksa e tarifa, që në trajtë progresive në fund të vitit për abonentët familjarë është **325,684,517 lekë.**

-Nuk janë llogaritur kamatëvonesat për detyrimet tatimore të papaguara në afat për çdo ditë vonesë, si dhe nuk rezulton të jetë regjistruar si një zë me vete pagesa për detyrimet e viteve të mëparshme, duke justifikuar me mungesën e një programi kompjuterik për administrimin e të ardhurave tatimore. Për të gjithë subjektet debitore nga ana e Bashkisë Selenicë nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", neni 114. Bazuar në të dhënat e administruara nga ky institucion, janë aplikuar sanksione ndaj subjekteve të biznesit për mos pagimin e detyrimeve në afat *(sipas regjistrit themelor), vetëm në 6 raste dhe në vlerën 3,097,409 lekë dhe 8,300 Euro është pjesa e sanksioneve të aplikuara për vitin 2025,* kurse për periudhën dy vjeçare 2024-2025 sanksionet janë në shumën 16,701,124 lekë dhe 8,300 euro. Sa më sipër vepruar në kundërshtim me pikën 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe pikën 1 të nenit 114.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006*, "Për sistemin e taksave vendore"*, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, nenet 89, 90, 91 dhe 93.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.1, faqe 34-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Selenicë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e debisë prej **75,243,082** lekë të debitorëve të kategorisë "*biznesi i madh"* dhe **42,536,491 lekë** debitorëve të kategorisë *"biznesi i vogël".*

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë, GMS Drejtoria e Shërbimeve Financiare dhe Arkiv Protokollit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të marrin masat për verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish- komunat për saktësimin e numrit dhe të debitorëve, kontabilizimin e saj të plotë si dhe arkëtimin e vlerës debitore të regjistruar në librat e kontabilitetit.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Selenicë, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT